



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 24 DHE 25 MAJ 2012**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
24. I 25. MAJA 2012. GODINE**

**MAJ - MAJA
2012**

Rendi i ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e këmbimit të Notave Diplomatieke për statusin e forcave të huaja mes Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e Financave publike dhe përgjegjësitë,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën kontestimore,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Teatrot,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbeturina,
13. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për vitin 2011,
14. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, për vitin 2011,
15. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji, për vitin 2011,
16. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2011,
17. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, për vitin 2011,
18. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, për vitin 2011,
19. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2011,
20. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2011,
21. Shqyrtimi i Propozimit të Qeverisë së Kosovës, lidhur me “Listën për Rentat Minerare”,
22. Shqyrtimi i Propozimit të Institutit Gjyqësor të Kosovës për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës,
23. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me Mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Usvajanje Zapisnika sa prethodne sednice,
4. Razmatranje Nacrta zakona o ratifikaciji razmene diplomatskih nota o statusu stranih snaga između Republike Kosova i Sjedinjenih američkih država.
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o menadžiranju javnih finansija i odgovornostima,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o parničnoj proceduri,
7. Prvo razmatra nje Nacrta zakona o izmenama i dopunama Zakona o štrajku,
8. Prvo razmatra nje Nacrta zakona o putnoj i ekološkoj taksi vozila,
9. Drugo razmatranje Nacrta zakona o osnivanju Agencije za usluge vazdušne navigacije,
10. Drugo razmatranje Nacrta zakona o pozorištima,
11. Drugo razmatranje Nacrta zakona o Kosovskoj agenciji za zaštitu od zračenja i nuklearnoj bezbednosti,
12. Drugo razmatranje Nacrta zakona o otpacima,
13. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Državne agencije za zaštitu ličnih podataka, za 2011. godinu,
14. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Regulatora za vode i otpatke, za 2011. godinu,
15. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Kancelarije Regulatora za energiju, za 2011. godinu,
16. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Kosovske agencije za imovinu za 2011. godinu,
17. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Autoriteta civilne avijacije Kosova, za 2011. godinu,
18. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Regulatornog autoriteta železnica, za 2011. godinu,
19. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Nezavisnog nadzornog saveta za Civilnu službu Kosova, za 2011. godinu,
20. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Nezavisne komisije za rudnike i minerale, za 2011. godinu,
21. Razmatranje Predloga Vlade Kosova, u vezi sa „Listom za mineralne rente“,
22. Razmatranje Predloga Sudskog instituta Kosova o imenovanju članova Upravnog odbora Sudskog instituta Kosova,
23. Razmatranje Izveštaja Komisije za ekonomski razvoj, infrastrukturu, trgovinu i industriju u vezi sa nadgledanjem Zakona o zaštiti konkurencije.

E enjte, 24. 5. 2012, ora 10:00

Seancën e drejton kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë!

I nderuar kryeministër,

Ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare.

Në sallë janë të pranishëm 61 deputetë. Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta, diskutimi në emër të grupeve parlamentare 5 minuta, në emër të deputetit 3 minuta.

Prandaj, fillojmë sipas paraqitjes.

Falemnderit! Para se të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, pasi është seanca e parë pas tragjedisë së komunikacionit që ka ndodhur në Himarë të Shqipërisë, ju ftoj për një minutë heshtje! Nderime u qoftë!

Vazhdojmë punën me pikën e parë të rendit të ditës. Fjalën e ka kërkuar deputetja Xhevahire Izmaku.

XHEVAHIRE IZMAKU: Falemnderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot do të ngre një shqetësim që lidhet me historinë e mbi 70 familjeve në fshatin Lumë të Madh të komunës së Vushtrrisë, kryesisht familjeve të dëshmorëve apo ish-ushtarëve, invalidë të luftës edhe kategori tjera sociale që nga lufta dhe agresioni serb, përpos fatkeqësive të humbjes së familjarëve, mbetën edhe pa kulm mbi krye.

77 shtëpitë në fshatin Lumë të Madh, në komunën e Vushtrrisë, të gjithë ju, të nderuar kolegë deputetë, keni mundur t'i shihni vetëm nëse njëherë keni kaluar nëpër magjistralen Prishtinë-Mitrovicë, shtëpitë e ndërtuara në vitet e '90-ta nga Komisariati për Refugjatë i Republikës së Serbisë, ku vërehen qartë se janë ndërtuar buzë asfaltit, midis tokave bujqësore komunale - shtëpi për qëllime politike. Duke sjellë serbët e Kninit me dhunë aty, e më pastaj, pas ikjes së tyre nga ato shtëpi, Agjencia Kosovare e Pronës, duke kryer mandatin e vet, siç thotë, e bëri një menaxhim aspak të drejtë dhe aspak human të këtyre pronave. Po flas konkretisht për një rast të njohur për publikun sot e 12 vjet, dhe po ashtu të pazgjidhur sot e 12 vjet.

Agjencia Kosovare e Pronës, 22 familje në këto shtëpi, i detyron të paguajnë qira sipas një skeme nga kjo agjenci, mjete të cilat u dërgohen serbëve të Kninit, edhe pse këto familje shqiptare këtu janë vendosur me kërkesë të ish- TMK-së dhe me vendim të HABITAT-it. Objektet në fjalë, të ndërtuara në territorin e komunës së Vushtrrisë, në përputhje me ligjin në fuqi, Komuna ka tentuar t'i përfshijë brenda juridiksionit në pronësinë e vet, e kjo u bë e mundur për 55 shtëpi, ndërsa e kundërta ka ndodhur për 22 të tjera, ku këta ish-banorë në mënyrë të parregullt i kanë bërë prona të përjetshme. Agjencia Kosovare e Pronës, me selinë e vet edhe në Mitrovicë, nuk ka vepruar njëjtë edhe me banorët serbë, që i kanë uzurpuar shtëpitë e shqiptarëve në veri dhe skema e qiradhënies kurrë nuk u realizua për shtëpitë e uzurpuara të shqiptarëve atje.

Si deputete e këtij Kuvendi dhe si bashkëqytetare e atyre njerëzve që dhanë gjithçka për këtë liri, unë e ftoj Agjencinë Kosovare të Pronës t'i kryejë punët e veta sipas mandatit të marrë, po ashtu donatorët që e ndihmojnë të funksionojë këtë agjenci t'i rishikojnë fondet e veta në raportet reale që dalin nga aktiviteti i përgjithshëm i kësaj agjencie. Standardet e dyfishta nuk janë një model i mirë që po na sjell në asnjë sferë të jetës dhe këto përpjekje secili institucion duhet t'i bëjë që të zhduken, aq më pak t'i përdorë një model agjencitë e tilla, që punojnë e bashkëpunojnë fuqishëm me institucione ndërkombëtare, model nga shtetet me demokraci të kultivuar me dekada. Tekefundit, qasja në aspektin social mund të jetë shumë e balancuar dhe jo me kritere të dyfishta edhe në programet sociale në vend.

Si deputete e këtij Kuvendi, unë kërkoj nga Agjencia Kosovare e Pronave ta rishikojë vendimin e Kolegjit të komisionit të vendimit grupor të datës 16 prill 2004 lidhur me të cilin disa ish-shfrytëzuesve të objekteve të banimit, në fshatin Lumë Madh të komunës së Vushtrrisë, refugjatë të vendosur nga Republika e Bosnjës dhe Kroacisë, u është vazhduar e drejta e shfrytëzimit për 23 raste të tilla...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Falemnderit! Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Falemnderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar ta përgëzoj Federatën e Futbollit të Kosovës dhe njëkohësisht ta falënderoj edhe FIFA-n për vendimin e fundit që reprezentacionit ose përfaqësueses të Republikës së Kosovës t'i lejohet të zhvillojë ndeshje miqësore.

Pa dyshim, kjo është për ta përshëndetur dhe për ta përkrahur, njëkohësisht ky vendim i obligon edhe më shumë institucionet e Kosovës, të gjithë neve, që ta përmirësojmë infrastrukturën sportive, duke e ditur rolin e jashtëzakonshëm të sportit, përkatësisht sportistëve si ambasadorë, mund të thuhet lirisht të pazëvendësueshëm edhe të vendit tonë, në një mision i cili mund ta ndihmojë shumë edhe Kosovën. Pa dyshim, merita për këtë vendim u shkon shumë gjeneratave, edhe gjeneratave të viteve të rënda të të '90-tave, kur në Kosovë është zhvilluar sporti ose janë bërë gara, janë luajtur lojërat e futbollit edhe nëpër fusha, edhe nën represion, në një mënyrë a tjetër të regjimit serb dhe

vërtet është për ta përshëndetur punën e Federatës, veçmas kryetarit të saj, zotit Fadil Vokrri, sikur që një falënderim i veçantë për zotin Blater, për këtë përkrahje që pa dyshim është një dritare që po i hapet Kosovës dhe zhvillimi të sportit, në këtë rast, futbollit.

Pa dyshim se kjo ngjarje, edhe njëherë po them, na obligon të bëjmë shumë më tepër për komunitetin e madh të sportistëve dhe dashamirëve dhe përkrahësve dhe të qytetarëve, në përgjithësi, sportit. Fundi i fundit, kemi dëshmi të shumta se sa është e rëndësishme të jesh ose ta kesh një sportist. E kemi rastin edhe të Majlindës, edhe të shumë sportistëve të tjerë. Prandaj, edhe njëherë një përgëzim dhe një urim futbollistëve dhe gjithë atyre që kanë bërë të mundur që kjo të ndodhë si një ngjarje e rëndësishme të veçantë. Falemnderit, kryetar!

KRYETARI: Falemnderit! Edhe ne i urojmë. Fjalën e ka kryetari i Grupit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Falemnderit, zoti kryetar!

Unë sot do ta ngre një çështje për të cilën jam lutur nga disa punëtorë të disa ndërmarrjeve të privatizuara në Kosovë.

Pas kërkesës tyre që ta ngre këtë çështjen, unë kam kontaktuar joformalisht me udhëheqës të Agjencisë të Privatizimit dhe ata me shumë korrektësi më kanë treguar se e kanë kryer pjesën e vet të obligimit, të 20% ndaj punëtorëve. Sidoqoftë, punëtorët nuk e kanë realizuar ende të drejtën e vet për t'i trashëguar në njëfarë forme drejtpërdrejt mjetet e 20%, të cilat janë pronë e tyre dhe në bazë të ligjeve në Kosovë këto mjete u takojnë atyre. Ato nuk janë të ardhura personale, nuk janë të ardhura mujore, po janë pronë, janë pjesë e pronës tyre që u takon me ligj.

Thashë edhe njëherë, këta punëtorë nuk i kanë realizuar këto të ardhura dhe ata mendojnë se të hollat e tyre mbahen nëpër banka dhe dikush nga ato krijon edhe interes. Ajo që kam marrë vesh se ka ndodhur është se Agjencia e Privatizimit i derdhë mjetet në konto të sindikatave, e sindikatat nuk i lëshojnë, që do të thotë nuk i lëshojnë më tutje nëpër kontot e punëtorëve. Mendoj se kjo është çështje të cilën Kosova duhet ta zgjidhë, duhet ta zgjidhë Agjencia e Privatizimit, duhet ta zgjidhë Qeveria e Kosovës, por edhe Kuvendi. Mendimi im është se këto mjete nuk i takojnë Sindikatës për shkak se Sindikata nuk merr mjete nga prona e njerëzve, merr mjete nga të ardhurat personale.

Aspekti tjetër interesant është se këto mjete, e thashë më përpara, duke qenë pronë, domethënë janë të tyre. Dhe e fundit është se në Kosovë, me ligjet në fuqi, organizimi sindikal është vullnetar dhe Kosova nuk guxon të lejojë që sindikatat t'i detyrojnë punëtorët të paguajnë nëse ata me vullnetin e vet nuk e bëjnë një gjë të tillë. Mendoj se çështja e privatizimit në Kosovë ka zgjatur shumë gjatë, shumë njerëz janë dëmtuar. Ne kemi edhe dilema rreth asaj se cili ka qenë çmimi i privatizimit. Kemi dilema se çka ka ndodhur me punëtorët dhe mendoj se punëtori i Kosovës nuk e ka luksin, e as Kosova, të vijë në një situatë që tani të mos realizohen të drejtat e tyre që i kanë, e të cilat u garantohen me ligj. Edhe njëherë, e ftoj Agjencinë Kosovare të Pronës që të merret me

këtë temë, edhe Qeverinë, edhe Kuvendin, në mënyrë që punëtorët t'i realizojnë të drejtat e tyre sa më shpejt që të jetë e mundur. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Deputeti Afrim Kasolli e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: Falemnderit, kryetar!

Në emrin tim personal, jo në emër të Grupit.

Të nderuar deputetë,

Me anë të kësaj pike parlamentare, dëshiroj të ngre për diskutim njërin nga shqetësimet kryesore, i cili është duke i munduar që një kohë të gjatë banorët e fshatrave Zym dhe Karashëngjergj, në zonën e Hasit.

Në këto dy fshatra aktualisht jetojnë përafërsisht 1 000 banorë. Sidoqoftë ky rajon në mënyrë të vazhdueshme është duke u braktisur nga banorët dhe duke lënë djerrina në atë rajon panoramik. E kjo zhvendosje e popullsisë është duke ndodhur kryesisht nga shkaku i kushteve infrastrukturore të rrënuara dhe të shkatërruara gjatë viteve të fundit, mirëpo ajo që e paraqet si njërin nga problemet themelore për qytetarët e kësaj ane, pa dyshim se mbetet mungesa e ujit të pijes. Kështu, në këto fshatra, edhe pse është i instaluar sistemi i ujësjiellësit që nga viti 1985, si pjesë e sistemit të Radoniqit, që nga paslufta e këndej, edhe atë kryesisht nga viti 2002, mungesa e ujit të pijes për pjesën më të madhe të kohës, me disa përjashtime të rralla, thuhet se është shndërruar në dukuri të përhershme për banorët e zonës.

Madje, gjatë gjithë muajve të verës uji mungon plotësisht. Në rrëfimet e tyre për këtë problem, ata tregojnë se si jeta e tyre varet plotësisht nga mëshira e kushteve meteorologjike dhe kështu jeta e tyre është bërë e padurueshme nga mungesa e burimit kryesor të jetës njerëzore. Ndërkaq, në këto rrëfime ata tregojnë se si janë të detyruar të udhëtojnë madje edhe deri në 15 km çdo ditë, vetëm e vetëm për ta siguruar këtë element të domosdoshëm të ekzistencës për t'i plotësuar nevojat jetike. Në këtë kontest, banorët e kësaj zone në vazhdimësi janë ankuar për këtë problem në organet kompetente, të cilat merren me menaxhimin e këtij sistemi, madje edhe në trajtën e revoltave dhe protestave qytetare, por përsëri këto ankesa deri më tani kanë hasur në vesh të shurdhër. Ndërkaq, arsyetimi formal i zyrtarëve të kësaj kompanie deri më tani ka qenë se mungesa e ujit për këtë zonë është rrjedhojë e faktit se fshatrat e tjera e përdorin ujin e këtij sistemi për ujitje të tokës punuese dhe kështu pakësohet vëllimi i ujit brenda sistemit.

Mirëpo, pavarësisht këtyre arsyetimeve formale, banorët e këtyre fshatrave u bëjnë thirrje autoriteteve përgjegjëse që urgjentisht të intervenojnë për ta tejkaluar këtë krizë, në qoftë se është nevoja, tek e fundit, edhe me një menaxhim më racional para se të jetë vonë, me ç'rast ata do të jenë të detyruar që të zhvendosen kolektivisht si pasojë e mungesës së kushteve për ekzistencë. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Fjalën e ka kryetari i Grupit të SLS, Sasha Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIČ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Uvaženi članovi Vlade,

Kolege poslanici,

Sigurno svi znate da su prekuće u selu Drenovac, opština Klina, spaljene dve povratničke kuće. U proteklih pet godina, uloženi su veliki napor i trud i od strane Ministarstva Zajednice i Povratak, i od strane Međunarodne Zajednice, da se osiguraju svi uslovi za bezbednost i održiv povratak.

U 2011. godini sagrađeno je sedam kuća za povratnike, i dve kuće za primajuću zajednicu, albansku zajednicu. Takođe je u ovoj godini, započeta izgradnja još 12 kuća za povratnike, i još tri kuće za primajuću zajednicu. Veoma je bitno da se napomene da je ovo zajednički projekat Ministarstva za Zajednice i Povratak i Evropske Komisije, i zato želimo da kažemo da ovakva dešavanja šalju negativnu poruku povratnicima, Evropskoj Uniji i celoj Međunarodnoj Zajednici, i veoma loše utiču na čitav proces povratka.

Zahtevamo od sve nadležne organe da hitno preduzmu sve zakonske mere i da počinioce izvedu pred lice pravde, i da preduzmu sve mere da se ovakve stvari više nikada ne dese. Hvala!

KRYETARI: Falemnderit! Fjalën e ka deputetja Valbona Dibra.

VALBONA DIBRA: Falemnderit!

I nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Nga të dhënat preliminare të Entit Statistikor të Kosovës për numrin e banorëve të kryeqyteti, pas regjistrimit të popullsisë, të vitit 2011, del se komuna e Prishtinës i ka 180.000 banorë.

Drejtuesit e Komunës i kanë kontestuar rezultatet preliminare që Enti i Statistikave pritët t'i publikojë në muajin shtator të këtij viti, me deklaratën se numri i banorëve të Prishtinës është jo më i vogël se 450.000 deri në 500.000. Edhe ne kemi dëshirë që Prishtina, si kryeqytet i shtetit të Kosovës, të ketë jo 450.000 ose 500.000, por edhe 1.000.000 e më shumë banorë, por të dhënat e Entit Statistikor vështirë se mund të kontestohen me deklaratimet të llojit, si kjo e nënkryetarit të Prishtinës.

Nënkryetari i Komunës së Prishtinës deklaroi se e kanë bërë një vlerësim të numrit të banorëve në kryeqytet, sipas të cilit në Prishtinë jetojnë dhe i shfrytëzojnë të mirat publike rreth 450 deri 500.000 qytetarë. Deri te kjo shifër kanë ardhur pas analizës së disa burimeve të të dhënave, me të cilat është qesharake të flitet në ndonjë forum ndërkombëtar dhe të cilat pakkush mund t'i cilësojë si burime të të dhënave. I pari, sipas tij, ka qenë fotografimi satelitor i datës 19 gusht 2010, siç thotë ai, në atë datë, në orën 10:20 të mëngjesit, në Prishtinë janë regjistruar rreth 120.000 makina të parkuara dhe në qarkullim, duke mos i përfshirë ato të cilat gjendeshin nëpër garazhe, që s'kanë mundur të identifikohen nga fotografimi satelitor.

Ju lutem, kjo është me të vërtetë qesharake. Paramendojeni, në një takim ndërkombëtar, çfarëdo qoftë ai: financiar, ekonomik, politik apo demografik dhe të prezantohemi me këso të dhënash. Ky është absurd i llojit të vet.

Burimi i dytë sipas tyre, kanë theksuar se bazohen në numrin e shfrytëzuesve të shërbimeve publike si: uji, energjia elektrike dhe volumi i mbeturinave urbane që prodhohen në Prishtinë, duke hedhur dyshime rreth procesit të regjistrimit të popullsisë që është pranuar nga institucioni përkatës evropian e që për krerët e kryeqytetit nuk vlejnë. Huqja e tyre është huqje që shkakton me shumë dëme se sa era e keqe e mbeturinave, papastërtive, rrugëve me baltë, gropa e gjëra e gjëra të këqija e të ngarkuara në kurrizin e qytetarëve të kryeqendrës sonë, e krijuar nga mos efikasiteti i shërbimeve komunale.

Ju lutem, qytetari i Prishtinës e meriton një jetë më të denjë, më njerëzore, më qytetëruese. Institucionet komunale janë ato që i kanë të pafalshme huqet e tyre, andaj këto dështime janë të dhimbshme dhe nuk e rëndojnë vetëm kurrizin e qytetarëve me taksën e të cilëve ne të gjithë paguhemi, por tentojnë që mos efikasitetin e tyre ta justifikojnë me gjoja rezultate jo korrekte të një procesi të rëndësishëm, siç është ai i regjistrimit të popullsisë i bërë me shumë kompetencë nga Komisioni Shtetëror i Regjistrimit. Pastaj, komisionet komunale të regjistrimit, në rastin konkret sipas ligjit, vetë kryetari i Komunës është edhe kryetar...

(Ndërprerje nga regjia)

(Pjesë diskutimi, i dorëzuar me shkrim)

... ose e emëron kryetarin e këtij komisioni. Është jo e ndershme tentativa e mohimit të këtyre rezultateve, edhe pse preliminare, kur komuna përkatëse ka qenë pjesë direkte në regjistrimin e popullsisë.

Qeverisja komunale duhet të jetë shumë më korrekte ndaj të gjithë atyre njerëzve që kanë punuar me përkushtim në këtë proces: regjistruessve, kontrollorëve, anëtarëve të komisioneve komunale të regjistrimit, e domosdoshmërisht Komisionit shtetëror të regjistrimit të popullsisë.

Institucionet përkatëse, të cilat janë marrë me regjistrimin e popullsisë, kanë dalë me rezultate preliminare se Prishtina i ka 180.000 banorë, e jo 450.000, as 500.000, sado të ishte mirë t'i ketë, por këto janë të dhënat pothuajse zyrtare të Entit Statistikor të Kosovës. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Fjalën e ka deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Në emër të grupit.

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Çështja që dua të sjell sot në vëmendjen tuaj dhe gjithë opinionit publik ka të bëjë me një nga tri pushtetet, e që në të vërtetë është garanti i vetëm i funksionimit të një shteti.

E kam fjalën për pushtetin gjyqësor. Natyrisht që ai është një pushtet i pavarur dhe ne si politikanë nuk kemi të drejtë të ndërhyjmë në pavarësinë e tij, mirëpo ne nuk mund të heshtim përballë drejtësisë apo padrejtësisë selektive që ndahet në Kosovë nga gjyqtarë dhe prokurorë. Këta të fundit duhet të jenë të pavarur nga politika, por jo nga ligji. Pak ditë më parë, objekt i drejtësisë selektive ka qenë redaktorja e gazetës “Zëri”, Arbana Xharra, e cila është paditur nga një kompani e afërt me pushtetin, që ka përfituar për shkak të këtij raporti jo më pak se 75 milionë euro, nëpërmjet tenderëve njëburimorë.

Institucionet e drejtësisë do të duhej t’i ishin mirënjohëse kësaj gazetareje, e cila e ka përmbushur misionin e vet, duke bërë rolin e “watchdog”-ut të institucioneve nëpërmjet sjelljes së fakteve se si shkelet ligji në këtë vend, e pas falënderimit do të duhej të nisin hetimet nga organet kompetente, por në vend të kësaj zgjidhet të ndëshkohet messengeri. I menjëhershëm ka qenë reagimi i Gjykatës Komunale të Prishtinës për t’u marrë me rastin, duke shënuar në një kohë rekord nisjen e procesit gjyqësor prej vetëm 5 ditësh. Nuk dua të futem në përmbajtjen e mëtutjeshme të procesit gjyqësor pikërisht për shkak të pavarësisë së tij, por ajo që bie dukshëm në sy është nxitimi i Gjyqësorit për t’u marrë me një lëndë të tillë me kaq urgjencë, ndërkohë që më shumë se 200 mijë lëndë janë bërë kapicë nëpër dollapë, e ku palët presin me vite që t’u vijë radha për gjykim.

Midis tyre ka lëndë edhe për krime të rënda. Në rast se mbetemi tek fusha e medias mjaftojmë të bëjmë një krahasim të thjeshtë. Procesi gjyqësor që e ka hapur TV Rrokum, për shembull zgjat prej 3 vjetësh, zvarritet e zvarritet, sepse nuk i shkon për shtati pushtetit. Pra, pse gjithë ky nxitim për ta hapur procesin ndaj një gazetareje, e cila raporton për një nga çështjet më brengosëse në Kosovë, për politikën korruptive. Ky nxitim madje bie në kundërshtim edhe me strategjinë për reduktimin e lëndëve të vjetra gjyqësore që e ka aprovuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës, më 18 nëntor 2010.

Standarde të dyfishta në drejtësi, drejtësi selektive, drejtësi e vonuar, politizim i sistemit gjyqësor, korruptimi i tij, janë temat e përditshme të mediave në Kosovë, ashtu sikur është e përditshme tentativa për t’i vënë nën kontroll të gjitha mediat, siç u tentua edhe në këtë Kuvend, nëpërmjet miratimit të nenit 37 dhe 38 të Kodit Penal. Dua t’ju kujtoj se mbyllja e gojës së gazetarëve është karakteristikë e regjimeve jodemokratike...

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Sabri Hamiti)

Nënkryetari i Kuvendit, SABRI HAMITI: Flet për Grupin, i ka 5 minuta.

ALMA LAMA: Janë organet e posaçme që duhet ta kontrollojnë punën dhe performansën e gjyqtarëve, mirëpo ne nuk mund t’i mbyllim sytë as përballë fakteve skandaloze, siç janë ato të lirimit me kusht të të dënuarve për krimet e rënda, të cilët, duke qenë të lirë, kanë kryer krime të tjera.

Edhe këto i kemi marrë vesh nëpërmjet mediave. Raporti i Progresit i vitit 2011 theksonte se sistemi gjyqësor mbetet i dobët, ndërsa efikasiteti i tij duhet avancuar. Ende ka

raportime të kërcënimeve dhe frikësimit të gjyqtarëve, sidomos në rastet e ndjeshme, thuhet në këtë raport. Mbase edhe rasti i gjyqimit të nxituar të redaktores së gazetës “Zëri” mund të vijë si shkak i frikësimit të gjyqtarit të lëndës, mirëpo pyetja është se kush qëndron pas këtij frikësimi? Sa është brengosës frikësimi dhe kërcënimi i gjyqtarëve, po kaq është brengosëse edhe ndërhyrja politike në punën e tyre, ka konstatuar Raporti i Progresit. Cilado qoftë arsyeja, rezultati është se drejtësia nuk po funksionon dhe mungesa e drejtësisë së Gjyqësorit, së bashku me mungesën e drejtësisë institucionale dhe shoqërore e bën të padobishme edhe vetë lirinë për të cilën dikush e ka dhënë jetën në këtë vend. Falemnderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Falemnderit!

I nderuar zoti nënkryetar,

Kryeministër dhe

Kolegë deputetë,

Unë sot këtu do ta ngre një çështje në lidhje me një strategji, e është hera e dytë ose e tretë që e shtroj këtë çështje. Strategjia për integrimin e komunitetit rom, egjiptian dhe shkallë, që është hartuar nga Këshilli i Evropës e nuk ka kaluar nëpër këtë Kuvend, është miratuar nga Qeveria, pa i pyetur edhe vetë komunitetet.

Në këtë javë e kemi në agjendë të ashtuquajturin Festival i kulturës romë, ashkalike dhe egjiptiane, i cili organizohet për herë të dytë në Kosovë dhe që ka filluar më 21 maj 2012, është edhe një shkelje e drejtave të komunitetit egjiptian të Kosovës. Ky festival, që nga organizatorët është vlerësuar si Javë e kulturës romë, ashkalike dhe egjiptiane, është festival vetëm i kulturës romë, e s’ka të bëjë asgjë me komunitetin egjiptian të Kosovës. Nuk ka dyshim se me këto veprime të sponsoruara nga BE-ja po bëhet përpjekje për arritjen e qëllimeve të lobeve të caktuara që veprojnë në Evropë, e të cilat janë në kundërshtim me interesat e egjiptianëve të Kosovës. Pjesë e këtyre veprimeve po bëhen edhe disa organizata joqeveritare të shumicës, por edhe një pjesë e Qeverisë, sidomos Zyra e Kabinetit për Qeverisje të Mirë dhe disa përfaqësues të shoqatave të komunitetit egjiptian, të cilët si prioritet e kanë që vetëm të përfitojnë materialisht, sepse ata nuk janë përfaqësues të komunitetit egjiptian, por janë matrapazë dhe analfabetë që i realizojnë interesat e tyre në këto projekte.

IRDK-ja, si përfaqësuese legjitime e egjiptianëve të Kosovës, e cila i është nënshtruar disa herë votimit dhe është kualifikuar që t’i përfaqësojë politikisht egjiptianët e Kosovës, e kundërshton ashpër këtë festival që quhet Festival i romëve, ashkalijve dhe egjiptianëve, e asgjë nga kultura egjiptianëve të Kosovës nuk përfaqësohet në të. Unë do të kisha thënë që Qeveria me këtë akt është duke na ndihmuar shumë dhe do t’i kisha cituar fjalët e asaj lokes që ia thotë ministrit të Punëve të Brendshme në YouTube. Falemnderit!

(Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi)

KRYETARI JAKUP KRASNIQI: Falemnderit! Fjalën e ka deputeti Goran Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsedniče!

Poštovani poslanici,
Poštovani ministri,
Poštovani premijeru,

Srpski poslanici u kosovskom Parlamentu su do sad koristili Skupštinsku govornicu kao jedno od najdemokratskih mesta sa kojeg su mogli da iznesu svoje mišljenje i da najrealniji prikazuju sliku koja najvernije odslikava stanje srpske zajednice danas na Kosovu.

Moram priznati da u ovom trenutku ta realnost nije neka koja daje suviše nade srpskom narodu na Kosovu. I pored ustavljanje retorike vladavine prava, poštovanju prava manjinskih zajednica, integracija istih u kosovski društvo, usvajanje najdemokratskih evropskih zakona, ne daje realno sliku društva u kojem danas živi srpska zajednica na Kosovu.

Da sve ovo što govorim nije samo prazna priča vidi se na svakom koraku, u svakom segmentu našeg društva. Svaki novi dan donosi srpskom narodu novo neprijatno iznenađenje. Na srpskim manastirima se ispisuju grafiti preteće sadržine, topografski znaci, kao i putokazi na srpskom jeziku su prefarbani crnom bojom. Deklaracija na prehrambenim proizvodima su samo na albanskom jeziku. Imena nekih mesta su promenjena, a na pojedinim objektima koje predstavlja institucije Kosova, obeležje su samo na jednom jeziku. Kao upozorenje počeli su da nam pišu letke koje nedvosmisleno govore šta će da se zadesi ako i dalje ostanemo na svojim vekovnim ognjištima. A to se gospodo poslanici pokazalo kao tačno, pretnje su obestinile, juče su povratnicima koje su vratili u selo Drenoc, opština Klina, zapaljane kuće.

Poštovani kolege poslanici, poštovani predsedniče, poštovani ministri, sa ove govornice sada postaviću neka pitanja za koje ne tražim odgovor danas, a ni sutra, ne tražim da mi vi odgovorite, već samo da saslušate:

Šta je sa Ustavom Kosova, sa članom 3 koje kaže da je Kosovo multietničko društvo?

Šta je sa članom 5 koje nedvosmisleno kaže da su službeni jezici na Kosovu albanski - srpski?

Poštovani gospodo poslanice,
Poštovani gospodo poslanici,

Ja sada ne bih više citirao Ustav, u kome vrlo jasno piše koje su zagarantovana prava zajednica na Kosovu. Sada bih vas isto pitao: Da li je ovo što sada kažem dokaz, dokaz multietničnosti, da li je to put u Evropskoj uniji, da li je to put za zajednički suživot svih zajednica na Kosovu? Da li vi tako vidite budućnost ove zemlje, ili želite budućnost u monoetničkoj državi gde postoji jedan jezik, jedno pismo, jedan narod?

Kao što sam upravo rekao, ne tražim odgovor od Vas, nego od vas tražim i molim kao predstavnici svog naroda, kojeg zastupate u ovom Parlamentu, razmislite kakvo društvo želite na Kosovu? Hvala!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Kjo fjalë e aprovuar në Grupin Parlamentar ka qenë e përgatitur për seancën e fillimit majit, e motivuar nga zhvillimet e fundit të prillit. Për arsye të kohës së kufizuar të kësaj pike në rendin e ditës, në seancën e kaluar nuk arrita të merrja fjalën, sot po e lexoj një pjesë të shkurtër të saj.

E përcolla me vëmendje fjalën e kolegut parafolës edhe e dëgjova me shqetësim. E ftoj ta dëgjoj me vëmendje edhe fjalën time.

Para tmerreve tragjike të fundshekullit të kaluar në Ballkan, Holokausti është kapitulli më trishtues i kujtesës njerëzore. Prej shumë manifestimeve me rastin e përvjetorit të Holokaustit, në Kanada është përmendur shembulli i shqiptarëve që i morën në mbrojtje hebrenjtë. Jo vetëm ata që jetonin në trojet tona, por edhe ata që erdhën këtu për të gjetur strehë e mbrojtje, pa pasur ndonjë lidhje besimi apo gjuhe, pa pasur aleancë politike, as ndonjë interes tjetër, në vete e kishin të përbashkët qenësinë njerëzore. Nga ky Kuvend e falënderoj kryeministrin kanadez, i cili e rizgjoi kujtesën tonë.

Kur në Kanada flitet për vlerat e popullit tonë dhe çmoheshin vlerat e tij, në Serbi ndodhin: ndjekje, burgosje, gjykime të shqiptarëve, arrestime, madje edhe me kamera. Para kësaj vale arrestimesh, në Luginën e Preshevës janë dënuar pa argumente me 200 vjet burg të rinjtë shqiptarë. Për fat të keq: bastisjet, burgosjet, përdhosjet gjatë arrestimeve dhe dënimet bëhen vetëm pse janë shqiptarë. Me situatën e fundit, pushteti aktual në Beograd vërtetoi se është vazhdimësi e politikës së Milosheviqit, fatkeqësisht edhe pushteti në Shkup i burgos shqiptarët dhunshëm dhe me motive të paqarta. Kjo ndodhi në vigjiljen e përvjetorit të Holokaustit, kur shqiptarët ishin pjesë shkëlqyese e këtij kujtimi në përmasa globale. Kjo ndodhi në vendlindjen e Nënë Terezës dhe në përvjetorin e saj, që mori paqe, dashuri nga populli i vet dhe i shpërndau gjithë njerëzimit. Kjo ndodhi në Maqedoni, që secili nga fqinjët e saj i mohon nga diçka qenësore, vetëm nga shqiptarët nuk mohohet asgjë.

Në Norvegji ndodhi një krim i paparë. Pa u ndalur te autori i krimit, motivuesi dhe nxitësi me origjinë nga Beogradi, këtij nuk iu burgos asnjë nga familjarët, si në Shkup e në Preshevë. Në Republikën e Kosovës shqiptarët shpërngulen nga veriu, sepse janë të rrezikuar, madje vriten në periudha ciklike dhe vrasësit mbeten të lirë. Duke qenë të motivuar për të vrarë përsëri, ne deputetët jemi pa imunitet, por siç duket serbët e veriut kanë imunitet dhe kur i mbyllin rrugët, edhe kur kontrabandojnë mallra, edhe kur nuk i njohin ligjet, edhe kur nuk e respektojnë rendin kushtetues, edhe kur i ndjekin fqinjët e tyre shqiptarë, edhe kur i vrasin.

Për ironi, këto zhvillime në dëm të shqiptarëve ndodhin në përvjetorin e Holokaustit, kur shqiptarë çmohen nga popujt e largët, por nga fqinjët ndiqen dhe dënohen. Kjo ndodh edhe në përvjetorin e Nënë Terezës dhe në vendlindjen e saj, që Zoti e përzgjedhi nga mesi ynë për të qenë përmasë e mirësisë.

Kolegë deputetë dhe deputete,

Kjo gjendje në regjion duhet ta rrisë shkallën e ndërgjegjes së përgjegjësisë qytetare, ligjvënies së lidershit në gjithë etninë tonë, duke e rritur bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet vete dhe me qendrat tjera atlantike.

KRYETARI: Koha për këtë pikë të rendit të ditës ka përfunduar. Për shkak të një reagimi një nga mediat, unë dua ta sqaroj çështjen e votimit të rekomandimeve në Kuvendin e Kosovës.

Unë e kam këtu një fjalor të shprehjeve parlamentare dhe ligjore, i botuar me ndihmën e misionit të OSBE-së në Kosovë, i cili e sqaron fjalën “rekomandim” sipas standardeve të BE-së. Sikur edhe mendimet e BE-së nuk janë akte me obligueshmëri juridike, për më tepër janë udhëzime të përgjithshme se si duhet zbatuar politika e caktuar e BE-së në një fushë të caktuar. Rekomandimet i nxjerr edhe Komisioni Evropian.

Në një fjalor tjetër juridik, gjithashtu për termat juridike evropiane për “rekomandimin” shkruan: “Rekomandimi është akt njëpalësh, i miratuar nga institucionet e Bashkimit Evropian, në kuadrin e traktatit themelues të komunitetit evropian, i cili i ka veçorinë të mos jetë detyrues, domethënë të krijojë efekte juridike detyruese. Rekomandimi mund të jetë një ftesë për ta ndjekur një linjë të veçantë që i drejtohet këshillit ose shteteve anëtare, në kuadrin e traktatit themelues”.

Edhe në fjalorin e gjuhës shqipe, fjala “rekomandim” është “këshillë, porosi” ose “mendim”, që jepet në mënyrë se si duhet vepruar e si bëhet diçka. Rekomandimet e mjekut, rekomandimet e mbledhjes, të komisioneve etj. Prandaj, ne, me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e miratojmë Kushtetutën, miratojmë ligje, akte nënligjore, vendime dhe rezoluta e deklarata. Rekomandimet zakonisht i bëjnë komisionet. Ne në seancën, për të cilën po flas, i kemi miratuar rekomandimet dhe rekomandimet nuk e kanë fuqinë ligjore. Vetëm një mocion është detyrues për Qeverinë, mocioni i mosbesimit, mocionet tjera, lexojini në Rregulloren e Punës së Kuvendit, nuk janë.

Po e ngre këtë çështje se unë jam i bindur që opinioni e di qëndrimin tim për çështjen e bisedimeve, për çështjen e të pagjeturve, por në asnjë fazë të jetës time unë s’dua të ngrihem mbi fatkeqësitë e askujt, e më pak të ngrihem mbi fatkeqësinë e fatit të të pagjeturve, për të cilët dihet se ku është fajtori, edhe si është ai.

Gjithashtu, për opinionet tuaja, të nderuar deputetë, u është i njohur qëndrimi im për bisedimet, dhe atë nuk e kam ndryshuar, por si kryetar i Kuvendit nuk mund ta fuqizoj një dokument që nuk e ka fuqinë, që nuk ia jep Kuvendi, por nuk mund as ta shfuqizoj. Dokumentet mund fuqizohen dhe të shfuqizohen nga Kuvendi, por jo nga kryetari i Kuvendit. E pashë të arsyeshme ta sqaroj më tepër opinionin publik, për shkak se e ka shtruar këtë çështje dhe i ka dhënë dimensione, që nuk i ka pasur. Nëse Kuvendi sigurisht do të marrë akte me fuqi ekzekutive dhe të domosdoshme për Qeverinë, duhet t’i marrë ato që i ka në Kushtetutë dhe në Rregulloren e punës së Kuvendit. Falemnderit për vëmendje!

Jo, fjala ime ishte jashtë rendit të ditës. Unë fola për opinionin, nuk thashë për deputetët. Vazhdojmë:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me nenin 45, pika 1 e Rregullores së Kuvendit, koha për pyetjet e deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta. Deputetët në një mbledhje mund të parashtrojnë më së shumti dy pyetje parlamentare.

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Nuk është deputetja, e as kryeministri.

Deputetja Nazane Breca, pyetje për ministrin Ferid Agani. Deputete, mund ta shtroni pyetjen, ministri është këtu.

NAZANE BRECA: Falemnderit!

I nderuari kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

I nderuari ministër Agani,

Para një kohe, në QKUK u hap një konkurs për zgjedhjen e drejtorit në Klinikën Interne në Prishtinë. U bë përzgjedhja e kandidatëve, por pas një kohe, për arsye të disa problemeve, konkursi u anulua.

Para disa ditëve, për personin i cili u përzgjodh në konkursin për drejtor të Klinikës Interne u hap hetimi nga Inspektorati Shëndetësor për keqpërdorim të detyrës, pra dërgimi i pacientëve nga spitali publik në ordinancën e tij private, për hulumtime gastroenterologjike, hulumtime këto që mund të kryhen edhe në klinikë, e që paraprakisht edhe ishin kryer, domethënë ky hulumtim ishte kryer te pacienti.

Pyetja ime është: Gjer ku është arritur me hetime nga Inspektorati Shëndetësor dhe çfarë keni ndërmarrë ju, si ministër, në lidhje me këtë çështje?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

FERID AGANI, MINISTËR I MINISTRISË SË SHËNDETËSISË: I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

E nderuara zonja deputete,

Inspektorati Shëndetësor i Ministrisë së Shëndetësisë ka marrë informata, sipas të cilave në klinikën e sëmundjeve të brendshme në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës nuk është ofruar niveli i duhur dhe i mundur i kujdesit shëndetësor për një pacient.

Në lidhje me këtë është zhvilluar inspektimi, gjatë të cilit janë intervistuar punëtorët shëndetësorë, të cilët kanë qenë në kontakt me pacientin. Është kontaktuar edhe pacienti për ta dhënë versionin e vet të ngjarjes dhe është grumbulluar dokumentacioni shëndetësor relevant.

Në këtë fazë ka përfunduar shqyrtimi i të dhënave të mbledhura, në krahasim me legjislacionin shëndetësor përkatës, dhe po merret vendimi nëse ka nevojë për masa korigjuese ose për masë ndëshkuese në lidhje me rastin.

Deri në përfundim të rastit, çdo informatë tjetër në lidhje me të do të ishte e nxituar dhe paragjykuese. Pra, kjo është ajo që unë kam ndërmarrë. Inspektorati Shëndetësor është nën autorizimin tim dhe ai është duke e përfunduar procesin. Sipas informatave të fundit, lënda është para vendimit dhe sigurisht që organet e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, e po ashtu edhe Ministria e Shëndetësisë, do të veprojnë në pajtim me vendimin që do të merret përkitazi me këtë rast.

KRYETARI: Falemnderit, ministër! Deputete, ke pyetje shtesë? Fjalën e ka deputetja Nazane Breca.

NAZANE BRECA: Ministër Agani, pyetja ime do të ishte se a mos kjo e vërteton edhe një herë problemin se në Ligjin bazë të shëndetësisë duhet të rregullohen disa gjëra, që të bëhet një vijë strikte, e ndarë nga ofrimi i shërbimeve shëndetësore në institucione publike dhe në ato private? Sepse, po shihet se në shumicën e rasteve po vjen deri te keqpërdorimi i pozitës, i detyrës së punëtorëve shëndetësorë që punojnë në institucione publike, në favor të institucioneve të veta private.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

FERID AGANI, MINISTËR I MINISTRISË SË SHËNDETËSISË: Zonja deputete, Në mbledhjen e radhës së Qeverisë do ta miratojmë Projektligjin e shëndetësisë, të dakorduar në tërësi me organet vendore profesionale, me Bankën Botërore dhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar, e po ashtu edhe me Ministrinë e Financave. Dhe, në mesin e shumë dispozitave reformuese të këtij Projektligji parashihet edhe dispozita, e cila e ndalon punësimin e njëkohshëm në sektorin publik dhe privat të shëndetësisë, në funksion të parandalimit të konfliktit të qartë të interesit, në këtë aspekt.

KRYETARI: Falemnderit, ministër!

Deputetja Aurora Bakalli, pyetje për ministrin Ferid Agani. Deputete e ke fjalën.

AURORA BAKALLI: Falemnderit, kryetar!

Zoti ministër,

Sipas vendimit 74/2011 të datës 2.12.2011 lidhur me barasvlerësimin e përvojës profesionale shëndetësore, të dalë nga ministria që drejtoni ju, ditëve të fundit janë pajisur me vendime subspecialistike një varg profesionistësh mjekësorë, duke lënë të pakënaqur një numër të konsiderueshëm të profesionistëve tjerë, të cilët nuk kanë arritur të jenë pjesë e kësaj liste.

Kriter i vetëm ka qenë përvoja e punës mbi 10-vjeçare në atë lëmi, ndërkohë që fare nuk janë marrë parasysh kriteret e tjera, si: shkathhtësitë profesionale nga lëmi përkatës, trajnimet jashtë vendit nga ajo fushë përkatëse e subspecializimit, shkollimi pasdiplomik nga lëmi përkatës, publikimet ndërkombëtare në atë fushë, e të tjera.

Sa për sqarim, për ata që nuk janë në dijeni, subspecializimi i rregullt zgjat dy vjet, do të thotë pesëfish më pak se koha e paraparë e përvojës profesionale për barasvlerësim dhe, për atë që më tepër, subspecializantët e rregullt marrin njohuri gjatë stazhit të tyre edhe nga këta specialistë, që nuk arrijnë t'i plotësojnë kriteret tuaja.

Pyetja ime është: Në çfarë praktikash jeni bazuar për ta marrë këtë vendim dhe a keni pasur konsultime lidhur me këtë çështje në takimet zyrtare, ku kanë qenë të ftuara edhe palët e interesit?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

FERID AGANI, MINISTËR I MINISTRISË SË SHËNDETËSISË: Falemnderit, zoti kryetar!

E nderuara zonja deputete,

Fillimisht dua t'ju përkujtoj se me legjislacionin në fuqi, në Republikën e Kosovës nuk ka subspecializime. Pra, nuk ka shkollim subspecialistik, por vetëm shkollim specialistik.

Pra, bëhet fjalë për barasvlerësimin e përvojës profesionale mbi dhjetëvjeçare në thirrjen specialistike, që i përgjigjet profilit të shërbimeve specialistike, të ushtruara nga profesionistët shëndetësorë, që punojnë në institucionet publike, të nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor, respektivisht në njësi të specializuara spitalore dhe klinike me shtretër.

Ky vendim ka për qëllim t'i legalizojë profilizimet ekzistuese, të cilat ekzistojnë që më shumë se dhjetë vjet në sistemin shëndetësor të vendit. Ka shumë specialistë, që kanë punuar mbi dhjetë vjet si kardiologë, nefrologë, endokrinologë, gastroenterologë, e tjerë, por të cilët për shkak të sistemit të mëparshëm të shkollimit specialistik nuk kanë qenë të profilizuar përbrenda një fushe specialistike, për shembull përbrenda fushës së sëmundjeve të brendshme ose interne. Dhe, ata janë përfshirë, pra ndonëse kanë punuar në reparte të specializuara me vite të tëra si kardiologë, reumatologë, gastroenterologë, vetëm me licencën e specialistit të sëmundjeve të brendshme.

Pra, ky ka qenë qëllimi, sepse këta profesionistë kanë pasur probleme të jashtëzakonshme gjatë realizimit të të drejtave të tyre, të cilat kanë dalë nga ushtrimi i veprimtarisë së tyre profesionale.

Ky është një problem, të cilin unë e kam trashëguar, problem i cili është tentuar të zgjidhet në Ministrinë e Shëndetësisë pesë vjetët e fundit. Dhe, unë jam shumë i kënaqur që kemi arritur ta përfundojmë këtë. Ndërsa, në procesin e nxjerrjes së këtij vendimi, unë jam mbështetur në nenin 11 të Udhëzimit Administrativ 10/2011 për regjistrimin dhe licencimin e punëtorëve shëndetësorë dhe janë bërë të gjitha konsultimet e nevojshme me

Bordin për shkollimin specialistik, Bordin për regjistrimin dhe licencimin e punëtorëve shëndetësor, komitetet specialistike, përfaqësuesit e specializantëve dhe drejtorët e institucioneve shëndetësore të nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor. Përndryshe, po e theksoj edhe këtë se kjo është një mënyrë, e cila është përdorur edhe në shumë shtete të rajonit.

KRYETARI: Falemnderit! Deputetja Aurora Bakalli e ka fjalën.

AURORA BAKALLI: Zoti ministër,

E di si fakt që komuniteti specialistik i Klinikës Interne ju ka dhënë tjera sugjerime nga këto, çfarë i keni marrë ju para sysh. Atë e di për fakt. Dhe, nuk keni bërë gabim që e keni bërë këtë vendim. Por, pyetja ime është: Çfarë mendoni të bëni me specialistët, që do të mbeten me status të padefinuar? Ata po mbeten viktimat të tranzicioneve në sistemin edukativ shëndetësor. Vendet e rajonit kanë bërë zgjidhje në këtë drejtim, duke e përcaktuar kriterin kohor shumë më të shkurtër të përvojës profesionale dhe duke u fokusuar në profesionalizëm.

Kështu, nëse një profesionist e kryen një procedurë, të cilën shumica apo asnjë nga kolegët tjerë nuk e performojnë, në disa vende kanë marrë titullin subspecialistik ende pa i përmbushur vitet e parapara të përvojës. Raste të profesionistëve të tillë ka edhe te ne, por që nuk kanë arritur ta marrin titullin, ngase për pak kohë nuk kanë arritur ta plotësojnë dhjetëvjetëshin tuaj. A keni menduar për ta? A do të shkojnë huq investimet e tyre profesionale, por edhe të Ministrisë së Shëndetësisë, që ka investuar...?

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Ministër, ke përgjigje?

MINSITRI FERID AGANI: E kuptoj shqetësimin tuaj. Jam i vetëdijshëm për peshën e problemit dhe specifikat e tij. Kjo është në çështje, me të cilën duhet të merren organet profesionale. Por, për fat të keq, meqenëse në Kosovë ende nuk janë themeluar odat e profesionistëve shëndetësorë, me këtë problem duhet të merret Ministria e Shëndetësisë, por unë shpresoj që gjatë dy-tre muajve të ardhshëm do ta keni në Kuvend ligjin për odat e profesionistëve shëndetësorë. Drafti i parë veç është përfunduar dhe ky organ do ta marrë këtë çështje, ta zgjidhë deri në fund, ashtu siç duhet.

Por, sa i përket rastit konkret, edhe kësaj periudhe, unë jam plotësisht i hapur ndaj propozimeve që do të më vijnë nga komitetet specialistike, të cilat janë kompetente në bazë të ligjit për të dhënë propozime të tilla, për barasvlerësimin e përvojave individuale, pra të përvojës profesionale për barasvlerësimin me ndonjë fushë të caktuar specialistike, që nuk është në pajtim me licencën e punëtorit shëndetësor. Pra, pres propozimet nga komitetet specialistike dhe do të veprojme në pajtim me sugjerimet e tyre.

KRYETARI: Falemnderit! Deputeti Agim Kuleta, pyetje për ministrin Dardan Gashi. Ministri nuk është këtu. Deputet, doni ta lexoni pyetjen? Jo. Falemnderit!

Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Ibrahim Makolli. Ministri është këtu. Deputete, mund ta bëni pyetjen.

TIME KADRIJAJ: Falemnderit, zoti kryetar!

Ministër, Ministria juaj ka ndërmarrë një iniciativë shumë të mirë për furnizim me lektura shkollore në shkollat shqipe në diasporë dhe bibliotekat e qyteteve ku ka shumë shqiptarë.

Me sa e kam kuptuar, këto lektura janë dërguar në Gjermani, në Austri dhe në Zvicër.

Sa është numri i librave të dërguar? Sa ka kushtuar botimi dhe transporti dhe a kanë arritur librat në destinacionin e caktuar?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI IBRAHIM MAKOLLI: I nderuari, zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

E nderuara zonja Kadrijaj,

Ministria e Diasporës, në bazë të përgjegjësisë të saj dhe sipas planit të veprimit, që ka të bëjë me mësimin plotësues në diasporë, ka për objektiv edhe pajisjen e bibliotekave, ku ka përqendrim të nxënësve mërgimtarë dhe koncentrim më të madh të mërgatës sonë.

Në këtë kuadër, në fillim të këtij viti, i kemi pajisur disa biblioteka të shkollave ku ka numër më të madh të nxënësve tanë, si dhe disa biblioteka publike, me literaturë në gjuhën shqipe.

Në Austri, në Zvicër dhe në Gjermani, në 23 biblioteka janë dërguar komplete me lekturë shkollore, të parapara me planprogramin e Ministrisë së Arsimit, secili komplet me nga 310 ekzemplarë, pra gjithsej: 7.230 ekzemplarë të lekturës shkollore dhe 2 komplete me libra të ndryshëm për të rritur, me nga 270 ekzemplarë, gjithsej: 540 ekzemplarë.

Gjithsej janë dërguar 7.770 libra. Blerja e 23 kompleteve të lekturës shkollore ka kushtuar 6.966,90 euro, kurse e librave për të rritur ka kushtuar 4.713 euro, apo gjithsej këto libra kanë kushtuar 11.680 euro. Shpenzimet e transportit kanë kushtuar 1.244 euro.

Pra, blerja dhe transporti i librave ka kushtuar 12.924 euro.

Ministria e Diasporës po ashtu, këtyre ditë, do të dërgojë edhe 10 komplete të tjera me lektura shkollore me 3.100 ekzemplarë për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Për këtë vit planifikohen të pajisen edhe disa biblioteka në shkollat ku ka mësim plotësues në diasporë. Ndërkaq, kërkesat për libra, qofshin ato për lekturë shkollore, qofshin për të rritur, janë shumë të mëdha nga mërgimtarët tanë, qoftë në Evropë, në Shtete të Bashkuara të Amerikës apo Kanada. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit, ministër! Deputete, ke pyetje shtesë? Fjalën e ka deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Ministër,

Thashë se është iniciativë e mirë dhe e qëlluar, mirëpo, me sa po shoh, ju nuk e keni përcjellë rrugëtimin e librave.

Tash në një vizitë zyrtare, kur isha në Zvicër, librat tuaj që i keni dërguar në Zvicër, mund t'i gjeni në kantonin Argau. Ja disa foto, të cilat vetë i kam bërë, se këta libra nuk kanë arritur në destinacionin e caktuar. Pronari, i cili e ka ofruar depon, është një shqiptar, i cili e ka dhuruar depon pa pagesë, e ka dhuruar edhe transportin, një kombibus, për transportin e librave. Mirëpo, njerëzit përgjegjës dhe kompetentë për Zvicër nuk i kanë destinuar librat në vendet e caktuara.

Librat gjenden në një depo në Zvicër. Mund t'ua jap edhe adresën e personit, edhe depon, edhe vendin, ku gjenden librat e grumbulluar plot 4-5 muaj. Falemnderit!

KRYETARI: Ministër?

IBRAHIM MAKOLLI: Falemnderit!

Unë e kam parasysh, mund të jenë libra të tjerë, por librat e dërguara nga Ministria e Diasporës të gjithë janë në destinacionin e caktuar. Të gjitha librat janë me nënshkrim, me pranim nga mësimdhënësit ose përfaqësuesit, për një pjesë të tyre kam marrë vet pjesë drejtpërdrejt në dërgimin e tyre në vendin e destinacionit.

Unë mund të ju ofroj faktet, listat me nënshkrimet e atyre, të cilët i kanë pranuar këta libra dhe ne po përkujdesemi që në çdo moment librat të jenë në vendin, për ku janë destinuar.

(Ndërhyrje)

Të gjitha librat, të cilët janë dërguar nga Ministria e Diasporës janë të vulosur, janë të nënshkruar dhe dedikohen vetëm për bibliotekat e shkollave ku ka përqendrim të nxënësve tanë dhe në bibliotekat publike të disa prej qyteteve, ku ne i kemi dërguar. Por, nuk janë në duart e asnjë personi privat.

Do të ju lusja, nëse ka çfarëdolloj informate se mund të ketë libra të tillë në duart të njerëzve privatë, do të ishte mirë të na informoni, sepse ne do të ndërmerrem veprime menjëherë.

(Ndërhyrje: Edhe adresën...!)

Ju lutem, zonja deputete, në diasporë ka edhe libra të tjerë, të cilët janë dërguar kaherë nga Ministria e Arsimit, ose nga autoritetet tjera. Por, ju garantoj që librat, të cilët janë dërguar nga Ministria e Diasporës, të gjithë janë të vendosur në vendet ku kanë qenë e parapara për t'u vendosur.

Unë nuk e përjashtoj mundësinë, që librat e dërguara nga autoritetet e tjera...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYTARI: Falemnderit, ministër!

Deputeti Afrim Kasolli, pyetje për ministrin Ramë Buja. Ministri nuk është këtu. Deputet, doni ta bëni pyetjen? Mirë, i ke bërë dy pyetje. Mbeten për javën e ardhshme.

Atëherë, kalojmë në pikën e radhës.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10 maj 2012

Pyes deputetët, nëse keni vërejtje në procesverbal?

Fjalën e ka deputeti Ramiz Lladrovci. Mirë, deputeti Ramiz Lladrovci në kartelën e deputetit Fatmir Xhelili.

RAMIZ LLADROVCI: Falemnderit, kryetar! Kërkoj që në transkript të zbardhet fjala ime lidhur me interpelancën me zëvendëskryeministrin për të pagjeturit, sepse konsideroj se fjala ime nuk është zbardhur e tëra. Prandaj, kërkoj nga Sekretaria që ajo të zbardhet. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Do ta marrim parasysh kërkesën e deputetit. Edhe unë e kam një vërejtje në transkript, jo në procesverbal. Në vazhdimin e seancës, të udhëhequr nga kryesuesi, nënkryetari Xhavit Haliti... Është fjala për një diskutim ose një pjesë të diskutimit të deputetit Arsim Bajrami, në paragrafin 3, kah mesi. Po e lexoj aty ku e kam edhe vërejtjen:

“Proceset e votimit janë procese shumë transparente dhe shumë profesionale dhe angazhohem që udhëheqja e Parlamentit të mos hedhë në votim gjëra kontradiktore, por t’i studiojë mirë, në mënyrë që Parlamenti të mos bjerë në një situatë çfarë kemi qenë”.

Të nderuar deputetë,

Edhe kryetari kur e udhëheq seancën, edhe kryesuesi kur e udhëheq seancën, në një formë është menaxher i seancës, për ta udhëhequr atë mbi bazën e Rregullores së Punës së Kuvendit. Por, as kryesuesi, e as kryetari nuk i studiojnë dokumentet, që përgatiten nga komisionet.

Tjetër, as kryetari, e as kryesuesi nuk kanë të drejtë t’i dirigjojnë deputetët se çka të votojnë e çka të mos votojnë.

Është përgjegjësi e secilit deputet që ta lexojë tekstin, për të cilin do të votojë. Por, po them, kryesuesi nuk e ka të drejtën e ndërhyrjes në dokumentet, që i përgatitin komisionet përkatëse e ku janë të pranishëm të gjithë përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Tash e votojmë procesverbalin! A ka dikush vërejtje të tjera në procesverbal? Nëse nuk ka. Konsideroj se Kuvendi e miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 10 maj 2012.

Falemnderit! Lus deputetët të kthehen në sallë! Për rendin e ditës, fjalën e ka kërkuar ministri i Infrastrukturës, ministri Mujota.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Falemnderit, i nderuari kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Në emër të Qeverisë e të Ministrisë së Infrastrukturës, në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit, neni 56, pika 5, kërkoj, përkatësisht tërheq pikën 9 të rendit të ditës, që ka të bëjë projektligjin me themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror.

Herën e kaluar, kur ligji është tërhequr për një seancë tjetër, i kam dhënë arsyetimet për çfarë është kërkuar shtyrja e shqyrtimit të këtij ligji. Nuk ka ndodhur ai ndryshimi thelbësor, për të cilin është interesimi i Qeverisë, prandaj kërkoj që ligji të tërhiqet dhe të ndodhë harmonizimi i tërësishëm dhe ripunimi i disa neneve thelbësore, që kanë të bëjnë me një çështje kaq të rëndësishme. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit!

Ju e dëgjuat propozimin e ministrit për tërheqjen për në ripunim të ligjit.

Kush është për? Falemnderit! A ka kundër? Abstenim?

Janë 6 abstenime. Falemnderit! Kuvendi e miratoi tërheqjen e ligjit në shqyrtimin e dytë të projektligjit për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror. Do të thotë, ligji i kthehet Qeverisë.

Të pranishëm i kemi 75 deputetë për të votuar, ndërkaq për ta futur në rend dite pikën e 4-të të rendit të ditës duhen 80 vota, d.m.th. dy të tretat.

Atëherë kalojmë në pikën e 5-të.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

E ftoj ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin. Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuari zoti kryetar i Kuvendit,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra,

Deputetë të nderuar,

Ministria e Financave, konform nevojave për të përshtatur legjislacionin, që rregullon menaxhimin e parasë publike, gjithashtu të zotimeve të marra me Fondin Monetar Ndërkombëtar për themelimin e fondit rezervë për likuiditet, por edhe konform nevojës

për t'i larguar kompetencat e përfaqësuesit civil ndërkombëtar nga ligji aktual mbi menaxhimin e financave publike, e që kanë të bëjnë me përzgjedhjen e drejtorit të Thesarit, e ka hartuar projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Bazuar në dispozitat e këtij projektligji, Thesari do ta themelojë fondin special të rezervës për asistencë emergjente të likuiditetit, të sistemit financiar. Ky fond do të mbahet në llogaritë e Bankës Qendrore dhe në pajtim me nenin 14 të Ligjit për bankën qendrore do të qeverisen dhe administrohen nga Banka Qendrore. Këto mjete nga fondi rezervë mund të shfrytëzohen vetëm në pajtim me Bankën Qendrore.

Ky ligj përmban edhe dispozitat, të cilat i japin përparësi këtij ligji në raport me ligjet tjera, kur është në pyetje menaxhimi i parasë publike, me qëllim që të ruhet qëndrueshmëria financiare e Republikës së Kosovës.

Me procesin e hartimit të këtij projektligji për ndryshimin e Ligjit të menaxhimit të financave publike dhe përgjegjësitë, Ministria e Financave është konsultuar me të gjithë aktorët, të cilët kanë të bëjnë me këtë fushë dhe ka përfshirë komentet e tyre në këtë projektligj.

Ky projektligj nuk ka kosto shtesë për Buxhetin e Kosovës dhe me miratimin e tij Kosova do të jetë një hap më afër përmbushjes së obligimeve të marra nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe përfitimit të vazhdueshëm nga programet e tij, si dhe përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur në këtë sektor.

Bazuar në këto vlerësime dhe nevoja për ta miratuar këtë ligj konform afateve kohore të parapara, rekomandoj që Kuvendi ta miratojë këtë projektligj. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Sipas radhës, fjalën e ka kryetarja e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, deputetja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Falemnderit, kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, dhe ka rekomanduar që ky projektligj të miratohet në shqyrtim të parë.

Në këtë projektligj për ndryshim-plotësim të Ligjit për menaxhimin e financave publike rregullohen çështjet, siç janë transferi, apo bartja e kompetencave nga institucionet ndërkombëtare në institucionet vendore dhe njëkohësisht bëhet themelimi i fondit rezervë për asistencë emergjente të likuiditetit financiar, si pjesë e marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Me këtë projektligj, kompetencat e rezervuara për Zyrën Civile Ndërkombëtare dhe për përfaqësuesin civil ndërkombëtar kalojnë në institucionet e Republikës së Kosovës, përkatësisht të Qeverisë, domethënë neni 2 i projektligjit në lidhje me ndryshimin e nenit 4 të ligjit në fuqi.

Këto kompetenca kanë të bëjnë me emërimin e drejtorit të përgjithshëm të Thesarit, për të cilin është dashur të merret edhe pëlqimi nga përfaqësuesi civil ndërkombëtar. Në këtë projektligj, këto kompetenca kalojnë në institucionet vendore, pra në Qeverinë e Kosovës. Me këto ndryshime njëkohësisht specifikohen edhe përgjegjësitë e drejtorit të Thesarit.

Me këtë projektligj themelohet edhe fondi rezervë për asistencë emergjente të likuiditetit financiar si pjesë e marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Fondi rezervë do të mbahet në llogaritë e Bankës Qendrore dhe do të menaxhohet nga Banka Qendrore. Ky fond ka për qëllim ta ruajë stabilitetin dhe qëndrueshmërinë financiare në Kosovë në rast të krizave buxhetore.

Ky projektligj nuk përmban kosto shtesë financiare. Fondi për asistencë emergjente të likuiditetit financiar do të jetë fond rezervë. Me këtë ligj Kosova përfiton nga marrëveshja me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Njëkohësisht, ky projektligj nuk i cenon parimet themelore të legjislacionit të Bashkësisë Evropiane, prandaj Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka pasur parasysh një çështje të tillë dhe e ka përkrahur në parim dhe rekomandon që edhe deputetët ta përkrahin këtë projektligj. Falemnderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputetja Hasime Krasniqi.

HASIME KRASNIQI: Falemnderit, zoti kryetar!

I nderuar, zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar dhe e ka analizuar projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë nr. 03-L/028 dhe konsiderojmë se dispozitat e këtij projektligji e përafrojnë legjislacionin vendor me legjislacionin e aplikueshëm në BE.

Projektligji në fjalë përmban gjithsej pesë nene dhe nuk do të ketë kosto shtesë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, mirëpo me miratimin e tij buxheti do të arrijë të përfitojë nga marrëveshjet me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe institucionet tjera ndërkombëtare.

Po ashtu, qëllimi i projektligjit është ruajtja e qëndrueshmërisë fiskale dhe krijimi i fondit rezervë, që do të ndikojë në ruajtjen e sistemit financiar të Kosovës.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet në parim këtë projektligj dhe kontributin tonë do ta japim në komisionet funksionale.

Ju falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka deputeti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Falemnderit, kryetar!

Të nderuar deputete,

Konsiderojmë se në Kosovë e kemi një ligj jashtëzakonisht të mirë bazik, Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe konsideroj që këto ndryshime, të cilat janë paraparë vetëm do ta rregullojnë edhe më mirë këtë ligj, që të jetë në funksion të rregullimit të çështjeve financiare.

Çështja e parë ka të bëjë më tepër me ndërrimin e kompetencave, që në vend të ICO-s tash të bartet përgjegjësia te institucionet e Kosovës, konsideroj që është një gjë e avancuar, dhe kjo çështja që ka të bëjë me krijimin e fondit rezervë të likuiditetit, për shkak të krizave që janë paraqitur në botë dhe reaksionit zinxhiror, që mund të krijohet për shkak të këmbimeve financiare ndërmjet shteteve, sepse asnjë shtet nuk mund të jetë i mbrojtur, pa i pasur edhe këto rezerva të garantuara të likuiditetit. Dhe, kjo që do të shkojë nëpërmjet Thesarit në Bankën Qendrore do të jetë gjë e mirë, për arsye se për çdo tërheqje do të kërkohet edhe pëlqimi i guvernatorit.

Kisha dëshiruar të tërheq vërejtjen vetëm për dy çështje, që kanë të bëjnë me drejtorin e Thesarit: "...Ministri me pëlqimin e kryeministrit e emëron drejtorin e Thesarit.". Kjo do të ishte domethënë edhe procedurë edhe e shkarkimit. Nëse e japin pëlqimin apo nënshkrimin kryeministri dhe ministri i Financave, ai drejtor i Thesarit më nuk e ka vendin të kthehet aty, edhe nëse e fiton kontestin në gjykatë. Ai mund të kthehet si shërbyes civil, por jo të kthehet drejtor i Thesarit, sepse është i shkarkuar prej dy institucioneve ekzekutive kryesore. Prandaj, kjo duhet të rregullohet.

Edhe te çështja e raportimit, drejtori i Thesarit i jep raport ministrit dhe nëpërmjet ministrit raportohet te kryeministri dhe te Parlamenti, por jo si është këtu drejtpërdrejt t'i raportohet kryeministrit, Parlamentit, ministrit dhe komunave. Vetëm këto dy detaje të rregullohen dhe konsideroj që është në rregull. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Lëvizjes "Vetëvendosje", deputetja Albana Fetoshi.

ALBANA FETOSHI: Falemnderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Me arsyetimin për ndryshimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike thuhet se bëhet sipas marrëveshjes me FMN-në, që ka të bëjë me caktimin e rezervave të likuiditetit, por që ndryshimet këtu kanë të bëjnë kryesisht me përmbylljen e mbikëqyrjes së pavarësisë.

Pra, ligji ndryshohet në 5 nene, e pjesa më e madhe ka të bëjë me caktimin e drejtorit të Thesarit, ku përpara ka qenë detyrë e PCN-së, e që tash zëvendësohet me fjalën "kryeministri". Pra, kjo i jep kompetenca goxha të mëdha kryeministrit në caktimin dhe

shkarkimin e drejtorit të Thesarit. Ministri ka të drejtë ta emërojë drejtorin e Thesarit, por nuk mund ta shkarkojë pa lejen e kryeministrit, përpara kompetencë e PCN-së.

Po ashtu, me ndryshimet e reja, kërkohet që të caktohet një rezervë likuiditeti në Bankën Qendrore, që nuk mund të preket pa lejen e Bankës Qendrore të Kosovës.

Kjo është praktikë e shëndoshë fiskale, për të siguruar që në rast të mbylljes së kufirit apo emergjencave tjera, kur nuk ka të hyra, të ketë së paku para për funksionimin e shtetit.

Grupi Parlamentar i lëvizjes “Vetëvendosje” është “për” këtyre ndryshimeve, mirëpo kërkon që Kuvendi të ketë kompetenca më shumë në caktimin dhe shkarkimin e drejtorit të Thesarit, sepse është personi më i rëndësishëm në Kosovë, sa i përket menaxhimit të parasë publike në Kosovë.

Nuk lejohet asnjë pagesë, as për paga, as për kontraktorë, pa lejen e tij. Përveç kësaj, ky raport i bën edhe raportet financiare të Qeverisë, që shumë shpesh mund të zbukurohen, për ta paraqitur Qeverinë më mirë. Prandaj, do të kërkoja që së paku në debat Kuvendi të ketë rol në këtë proces.

Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit, deputete! Në emër të AAK-së, deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Falemnderit!

I nderuar zoti kryetar!

Kryeministër,

Kolegë deputetë,

Edhe grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah në parim këtë projektligj dhe besojmë se është për një disiplinë më të mirë financiare dhe këtu kanë qenë që e vërejtët edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, por rezervat që i ka Aleanca është që kjo rezervë të mos jetë shumë e madhe, e detyrueshme dhe tepër e madhe, se e ngarkon shumë koston buxhetore. Për arsye se kemi mjaft mjete të mobilizuara jashtë qarkullimit, siç janë mjetet e Trustit, siç janë mjetet e AKP-së dhe rezerva po të jetë e madhe, atëherë do të kemi shumë pak mjete në qarkullim, ndërsa Kosova ka mjaft nevojë për mjete qarkulluese në qarkullim.

Në parim e përkrahim dhe vërejtjet tona do t'i japim në leximin e dytë. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të SLS-së, a do dikush fjalën? Jo. Në emër të Koalicionit “6+”, deputeti Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Falemnderit!

I nderuar kryetar,

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar “6+” konsideron se ndryshimi dhe plotësimi i Projektligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, ka një rëndësi dhe peshë të veçantë dhe ka prioritet të Qeverisë, që të bëjë ruajtjen e qëndrueshmërisë fiskale dhe obligimet që dalin në raport me institucionet financiare ndërkombëtare, si dhe krijimi i fondit rezervë.

Prandaj e përkrahim dhe kontributin tonë to ta japim nëpërmjet Komisionit.
Falemnderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputeti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit.

I nderuar kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Edhe Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re e mbështet tekstin e këtij projektligji në leximin e parë dhe mendon se është në funksion të sigurimit të një qëndrueshmërie më të madhe fiskale dhe makroekonomike në Kosovë.

Gjatë shqyrtimit në komisione, mendojmë se edhe në kuadër të Ministrisë, duhet të shqyrtohet çështja e lartësisë së fondit, rezervës bankare dhe fondit në banka, fondit rezervë të buxhetit në banka.

Ne mendojmë se, në qoftë se ky fond kalon mbi 20% të buxhetit, që mbahet në rezervë, atëherë kjo është diçka e tepruar dhe krijon një sasi mjetesësh që janë të imobilizuara, prandaj duhet të shohim se sa është një rezervë optimale, e cila do të siguronte një baraspeshë midis dy nevojave, nevojës për stabilitet dhe nevojës për përdorim sa më eficient dhe efektiv të mjeteve të cilat i kemi, sepse çdo mjet i bllokuar që nuk qarkullon dhe nuk përdoret, nuk kryen ndonjë funksion ekonomik.

Në këtë drejtim, mendoj se ne sigurisht, shohim, do të diskutojmë edhe kur vjen korniza e shpenzimeve afatmesme, por këto projeksione lidhur me një rezervë të detyrueshme në fondin bankar të Buxhetit të Kosovës, duket se janë të larta. Ndoshta, është mirë që të diskutohet dhe të krijohen ose me ndonjë akt nënligjor, të krijohen disa kritere, që do të siguronin një rezervë optimale.

Gjithashtu, më duket se, ndonëse në këtë tekst nuk ka propozime për ndryshime tjera, pas një periudhe bukur afatgjate të zbatimit të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike, ka ardhur koha që të diskutohet mbi nevojën që në kuadër të Buxhetit të Kosovës, të krijohen edhe fonde që kanë një destinim të posaçëm, sepse në këtë mënyrë ne do të siguronim zbatimin e prioriteteve të zhvillimit afatgjatë. Ne shpeshherë kemi folur për fondet e privatizimit, kemi folur edhe për disa, për shembull akcizat, që janë të destinuara, për shembull kur ishte akciza për duhan, që të shkojnë një pjesë në shëndetësi në mënyrë të destinuar, ose tash kjo taksa për regjistrimin, që e kemi një ligj këtu sot, taksa ekologjike dhe këto mjete mandej, kur hyjnë në fondin e tërësishëm të buxhetit po humbin destinimin e tyre.

Unë e di, se në fillim, kjo ka qenë e arsyeshme, që të gjitha mjetet të mos shkojnë në një vend, në një buxhet dhe të përdoren, të destinohen me Buxhetin e Kosovës, sepse kanë qenë ashtu kapacitetet e menaxhimit të financave publike, por në ndërkohë kapacitetet e menaxhimit janë rritur edhe në Ministrinë e Financave edhe gjetiu janë rritur dhe tash mund të krijohen fonde, që kanë destinime të posaçme dhe të cilat do t'i ndjekin qëllimet afatgjata të zhvillimit të Kosovës, siç mund të jenë: edukimi, arsimi, infrastruktura, sepse vetëm me buxhete vjetore dhe me një, të them ashtu, kornizë të shpenzimeve afatmesme, që shpeshherë ndryshon, po shihet se kapacitetet për ndjekjen e qëllimeve afatgjate të zhvillimit ekonomik, nuk janë ende në nivelin e duhur. Ju faleminderit!

KRYETARI: Falemnderit! Kërkoj nga deputetët që kanë kartelat dhe janë prezentë, të kthehen në sallë, se na duhen pak më vonë për një votim. Fjalën e ka deputeti Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: Falemnderit!

I nderuar kryetar,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Ndonëse ky draftligj ka vetëm 5 nene, pas leximit të vëmendshëm të tij, shihet se i njëjti në vete përmban disa shprehje joprofesionale, të cilat mendoj se nuk duhet të kenë vend në një ligj i cili aprovohet nga ky Kuvend.

Kështu, do të theksoja vërejtjet lidhur me nenin 2, apo më konkretisht me paragrafin 4.5, në të cilin përcaktohen kriteret për emërimin e drejtorit të përgjithshëm të Thesarit.

Mund të thuhet se kriteret e theksuara në këtë nen janë shumë të përgjithshme dhe jo të specifikuar mirë. Janë shprehje jo konkrete, si për shembull haset: “ përvojë të konsiderueshme”, që kërkohet për kandidatin për drejtor, pastaj “ karakter të përshtatshëm moral”, pastaj “ përvojë profesionale”, e të tjera.

Mendoj se këto kritere duhet të jenë më konkrete, më të sakta dhe më të precizuara, sepse sipas këtyre kritereve mund të emërohet edhe dikush që ka të kryer vetëm shkollën e mesme, siç ishte rasti kohë më parë me ambasadorin tonë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Bazuar në një dispozitë të tillë, për t’u emëruar drejtori i Thesarit, me rëndësi është që ndër të tjera, kandidati të jetë me karakter të përshtatshëm moral.

Vërejtja tjetër, ka të bëjë me paragrafin 4.6, respektivisht riemërimin e drejtorit, në të cilën haset shprehja: “riemërohet për një ose më shumë mandate pesëvjeçare”, ku fjala një është më shumë sa për sy e faqe, sepse në të vërtetë ai mund të riemërohet deri në pensionimin e tij, sipas këtij ligji.

Po ashtu, në këtë paragraf haset shprehja: “arsye të mira”, e që në esencë, për arsye të mira, askush nuk duhet shkarkuar, por përkundrazi duhet shpërblyer. Dhe, mendoj se mjafton të ekzistojë shprehja: “arsye të justifikueshme”.

Më tutje, paragrafi 4.7, përmban një varg shprehjesh, që nga aspekti juridik duken të palogjikshme. Konkretisht, sipas këtij paragrafi, të drejtën për shkarkimin e drejtorit, ministri e ushtron përmes dorëzimit të një deklarate me shkrim.

Nuk e di prej nga ideja që ministri të deklarohet, thua se është duke u marrë në pyetje. Ministri, mendoj që në vend të deklaratës me shkrim, duhet të marrë vendimin i cili duhet të përmbajë: pjesën hyrëse, dispozitivin, arsyetimin dhe udhëzimin për mjetin juridik.

Pastaj në pjesën e fundit të po këtij paragrafi, pra paragrafi 4.7, haset formulimi: “Gjykata është e autorizuar që të marrë çfarëdo masa, të cilat konsiderohen të ligjshme dhe adekuate.”. Mendoj se do të ishte mirë të thuhet: “Gjykata vendos konform ligjeve në fuqi.”.

Më tutje thuhet se personi mund t’i drejtohet gjykatës kompetente. Shtrohet pyetja, a thua me çfarë i drejtohet ai gjykatës kompetente: me ankesë, me kërkesë apo me padi? Falemnderit për vëmendje!

KRYETARI: I fundit, deputeti Armend Zemaj fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Falemnderit, kryetar!

Edhe pse qëllimi i ndryshimeve në këtë projektligj e plotëson edhe kërkesën, ndoshta e ka edhe votën time, në parim. Por, me të vërtetë, ndoshta do të ballafaqohemi edhe në të ardhmen me ngutinë për nxjerrjen e këtyre plotësime-ndryshimeve që kanë të bëjnë kryesisht me përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur.

Nuk po i përsëris ato që i tha kolegu im profesor Demolli, se me të vërtetë nenet që kanë të bëjnë me zgjedhjen, emërimin, apo shkarkimin, përgjegjësinë e drejtorit të Thesarit bien ndesh njëra me tjetrën, janë të përgjithësuara dhe janë konflikt apo në kolizion me vetë nenet.

Unë vetëm po e plotësoj, te hyrja në fuqi te neni 5, jo rrallë herë, e kjo është hera e dytë, apo e tretë që na vijnë projektligje nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me të cilat parashikohet apo parafrazohet hyrja në fuqi e ligjit. Edhe këtu thotë se ky ligj do të hyjë në fuqi më 15 qershor 2012, ndërsa sot po shqyrtohet në lexim të parë.

Dhe, pika e dytë, dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me kompetencat e PCN-së do të hyjnë në fuqi me mbarimin e mandatit të Zyrës Civile Ndërkombëtare. Prandaj, kjo duhet të rregullohet nga Komisioni Funkcional, sepse për hyrjen në fuqi janë procedurat ligjore dhe aktet tjera, të cilat e rregullojnë, dhe kjo e dyta u takon dispozitave kalimtare. Falemnderit shumë!

KRYETARI: Falemnderit!

Votojmë. Të pranishëm i kemi 90 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash, veç me kartela!

Konstatohet se me 86 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Kërkohej nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’i paraqesin raportin me rekomandime.

Kthehemi te pika e katërt e rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e këmbimit të Notave Diplomatieke për statusin e forcave të huaja ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Presidentja e Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 18 të Kushtetutës, e ka proceduar në Kuvend Projektligjin për ratifikimin e këmbimit të Notave Diplomatieke për statusin e forcave të huaja ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar vlerësimin e ndikimit financiar të këtij projektligji dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Në emër të Qeverisë, kryeministër e doni fjalën Ju, apo ministri i Punëve të Jashtme? Fjalën e ka ministri i Punëve të Jashtme, zoti Enver Hoxhaj, si propozues i çështjes.

MINISTRI ENVER HOXHAI: I nderuari zoti kryetar,
I nderuar zoti kryeministër, zëvendëskryeministra, kolegë ministra,
Shumë të respektuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
E kam kënaqësinë që sot para jush mund të paraqes dhe njëkohësisht të kërkojmë pëlqimin për ratifikimin e marrëveshjes për privilegjet dhe imunitetet e personelit civil dhe ushtarak të forcave, marrëveshje e cila njihet edhe me shkurtesën SOFA ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila është realizuar nëpërmjet këmbimit të Notave Diplomatieke nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës dhe Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë.

Këmbimi i notave është një përmbajtje e natyrës ligjore, e cila përcakton dhe rregullon dhënien e privilegjeve dhe imuniteteve për personelin civil dhe ushtarak të forcave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në pajtim me Konventën e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike.

Në këtë kontekst, Ministria e Punëve të Jashtme i ka kërkuar rekomandimet dhe pëlqimet paraprake të institucioneve kompetente të Republikës së Kosovës lidhur me propozimin e palës amerikane, si të Zyrës së Presidentes, të Këshillit të Sigurisë, të Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës, të Doganave të Kosovës, Autoritetit të Aviacionit Civil, Administratës Tatimore dhe Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit.

Para këmbimit të notës, nisma për lidhjen e kësaj marrëveshjeje është miratuar në Qeveri më 15 shkurt 2012.

Pas pëlqimit të të gjitha institucioneve kompetente të lartcekura, si dhe të këmbimit të notave ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, më 18 shkurt 2012, duke e marrë për bazë interesin strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në fushën e sigurisë, rekomandojmë fuqishëm ratifikimin e kësaj marrëveshjeje për dhënien e privilegjeve dhe imuniteteve personelit civil dhe ushtarak të forcave.

Marrëveshja për statusin e forcave siguron kornizën ligjore, brenda së cilës personeli civil i ushtrisë amerikane dhe Departamentit të Mbrojtjes së SHBA-ve, e që nuk janë pjesë e misionit të NATO-s, mund të veprojnë në Kosovë. Në bazë të kësaj, ky personel do të punojë me pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës për ta zhvilluar tutje aftësinë në kryerjen e katër misionëve të saj thelbësore: zjarrfikjen, kërkim-shpëtimin, largimin e materialeve të rrezikshme dhe largimin e mjeteve eksplozive.

Të nderuar deputetë,

Me miratimin e marrëveshjes SOFA, ju kontribuoni në forcimin e marrëdhënieve të veçanta ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Republikës së Kosovës. Një marrëveshje e tillë është po ashtu dëshmia më e mirë që Republika e Kosovës është pjesë e përkushtimit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Bashkimit Evropian dhe shteteve të rajonit për paqe, siguri dhe stabilitet në Ballkan.

Marrëveshje të tillë me SHBA-të tashmë kanë nënshkruar pothuajse të gjitha vendet e rajonit. Prandaj, me miratimin tuaj sot, Republika e Kosovës do të bëhet pjesë e Shteteve të Bashkimit Evropian dhe e rajonit që e ka ratifikuar në marrëveshje të tillë.

Me qëllim që të hyjë në fuqi një marrëveshje e tillë, kam nderin, në emër të Qeverisë, ta kërkoj mbështetjen dhe votën e juaj, dhe kjo marrëveshje të ratifikohet sot në Kuvendin e Kosovës. Ju falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Para se të jua jap fjalën shfave të grupeve parlamentare, në nenin 60 - Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare, në pikën 3 shkruan: “Procedimi i projektligjit për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare është i veçantë dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi”.

Në emër të Partisë Demokratike, e do fjalën dikush? Deputeti Hydajet Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Falemnderit, zoti kryetar!

I nderuar kryeministër, të nderuar ministra,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet unanimsht nismën për ratifikimin e marrëveshjes për statusin, privilegjet dhe imunitetet e forcave, shkurtimisht SOFA, të arritur ndërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe zëvendëssekretarit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Këtë marrëveshje e konsiderojmë si një hap të rëndësishëm në procesin e ndërtimit të bazës juridike e diplomatike për partneritet ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë dhe të funksionimit të forcave civile dhe atyre të armatosura në këtë kontekst.

Me këtë rast u shprehim edhe një herë mirënjohjen e veçantë Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe administratës së saj për rolin prijatar dhe paravajtës në një fushë veçanërisht të rëndësishme për Kosovën dhe paqen e sigurinë në Kosovë dhe regjion.

E ndjej të nevojshme ta theksoj po ashtu edhe nevojën e konsolidimit dhe qartësimin të mëtejshëm të ecurisë dhe procedurës së arritjes dhe ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe, në këtë kuadër, edhe të sigurimit të rolit adekuat të Komisionit për Punë të Jashtme në këtë proces, në pajtim me rregulloren dhe me praktikën parlamentare ndërkombëtare.

Besojmë se në këtë funksion do të jenë edhe ndryshimet vijuese kushtetuese. I ftojme deputetët ta votojnë ratifikimin e marrëveshjes. Ju falemnderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka deputetja Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Falemnderit, kryetar!

Duke pasur parasysh rëndësinë e fuqizimit të subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës, natyrisht mendojmë se çdo marrëveshje dypalëshe, në veçanti ato me shtetet mike, e në veçanti me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, natyrisht që vetëm e fuqizojnë subjektivitetin ndërkombëtar të shtetit tonë. Dhe, LDK gjithsesi do ta përkrahë ratifikimin e kësaj marrëveshjeje.

Megjithatë, i kam disa vërejtje parimore dhe shumë qëllimmira, që shpresoj të merren parasysh.

E para është e natyrës procedurale dhe ka të bëjë me rolin e Ministrisë së Punëve të Jashtme kur vendos se ku dërgohen këto marrëveshje.

Neni 18 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës i parasheh shumë qartë kategoritë e marrëveshjeve ndërkombëtare që duhet të ratifikohen në Kuvend. Një prej këtyre kategorive, të parapara në paragrafi 1.1, janë edhe çështjet ushtarake, që shumë qartë e përfshin edhe këtë marrëveshje. Përkundër kësaj, Ministria e Punëve të Jashtme, në shkurt të këtij viti, ka kërkuar nga Presidentja që ta ratifikojë këtë marrëveshje dhe ka qenë një insistim shumë i madh që kjo marrëveshje të mos vijë fare në Kuvend. Kjo është edhe arsyeja kryesore pse ne po e marrim me tre muaj e gjysmë vonësë këtë marrëveshje.

Unë besoj që Qeveria nuk ka nevojë të ketë frikë se në Kuvend nuk do të arrihen votat për një marrëveshje kaq të rëndësishme, e cila, po e theksoj, se e fuqizon subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës dhe, në veçanti, për një çështje kaq kyçe dhe me një shtet, që është shteti kryesor mik që e ka përkrahur më së shumti Kosovën. Prandaj, shpresoj që në të ardhmen të kihen parasysh procedurat e parapara me Kushtetutë dhe të mos ketë letra,

me të cilat nga Presidentja kërkohet të ratifikohet një marrëveshje, e cila shumë qartë kërkohet të vijë drejtpërdrejt në Kuvend.

E dyta ka të bëjë me gjuhën e përdorur, sidomos në notën verbale të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe kërkoj nga administrata që ky tekst të rregullohet para se ta marrë formën përfundimtare, sepse ky tekst në gjuhën shqipe do të bëhet projektligj, i cili votohet nga këta deputetë. Po e theksoj vetëm një pjesë të këtij dokumenti, që do të bëhet pjesë e projektligjit, i cili thotë: “Aeroplani i Qeverisë së SHBA-ve është i liruar nga hipja në aeroplan”. Po supozoj se nuk ka nevojë që një dokument kaq i rëndësishëm, që kërkon më shumë se 2/3 e deputetëve, ta ketë një gjuhë të tillë banale, prandaj e lus administratën që ta harmonizojnë tekstin me gjuhën angleze, meqë versioni përfundimtar zyrtar do të jetë vetëm në gjuhën shqipe dhe serbe.

E treta, pajtohem plotësisht me deputetin Hyseni dhe shpresoj prapë që administrata ta ketë parasysh që marrëveshjet e tilla të shkojnë në Komisionin për Punë të Jashtme, e në veçanti kur kemi të bëjmë me dhënien e privilegjeve dhe imuniteteve të forcave civile ushtarake. Është shumë e qartë, është pjesë e paraparë në konventat e Vjenës, që domosdoshmërisht duhet të shqyrtohet edhe në Komisionin për Punë të Jashtme.

Përfundimisht, po e theksoj edhe një herë, LDK-ja natyrisht do ta përkrahë këtë marrëveshje dhe do ta japë votën në ratifikimin e saj, me vërejtjet e paraqitura që natyrisht shpresoj të merren parasysh nga Administrata e Kuvendit. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Falemnderit, zoti kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” po ashtu e vlerëson dhe e mbështetë ratifikimin e kësaj marrëveshjeje me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në të njëjtën kohë, edhe ne e vlerësojmë dhe i çmojmë shumë si të rëndësishme raportet dhe marrëdhëniet bilaterale dhe miqësore me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Si të tillë, këtë marrëveshje ne do ta votojmë, që të jetë e ratifikuar në Kuvendin e Kosovës. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të AAK-së, kryetari i grupit, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Falemnderit, zoti kryetar!

Aleanca e mbështet dhe e përshëndet kalimin e Ligjit për marrëveshjen SOFA. Në të njëjtën kohë, konsiderojmë se kjo votë sot do të jetë element i thellimit të mëtejme të miqësisë dhe të partneritetit ndërmjet Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Fjalën e ka kryetarja e Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Falemnderit, kryetar!

Përshëndetje për kryeministrin, për Kabinetin qeveritar dhe për të gjithë të pranishmit,

Duke marrë parasysh rëndësinë e shtetformimit të Kosovës edhe në arenat ndërkombëtare, duke marrë parasysh miqtë më të mëdhenj të Kosovës, është nder për Kuvendin që sot të bëjë ratifikimin e kësaj marrëveshjeje për statusin e forcave SOFA në realizimin e bashkëpunimit ndërmjet forcave civile dhe ushtarake.

Për zhvillimin e një shteti, siç është Kosova, dora e zgjatur e Shteteve të Bashkuara të Amerikës më shumë se kurdoherë i duhet tash, dhe besoj e shpresoj që gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës janë në pajtim që sot të ratifikohet kjo marrëveshje.

Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah dhe shpresojmë se edhe në të ardhmen bashkëpunimi ndërmjet SHBA-ve dhe Kosovës do të vazhdojë në të gjitha sferat. Ju falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të SLS-së, deputetja Jelena Bontiq e ka fjalën.

JELENA BONTIĆ: Hvala predsedniče!

Samostalna liberalna stranka podržava proširenje saradnje sa Sjedinjenim Američkim Državama, posebno u vidu promovisanje sigurnosti i bezbednosti svih građana Kosova, i doprinos u stabilnosti i miru na Balkanu.

Kao predsednici Srpske zajednice, za ovo smo posebno zainteresovani. Ovaj sporazum daje pravni okvir unutar kojeg američka vojska i civilno društvo, Ministarstva Odbrane i Sjedinjenih Američkih Država koje nije deo misije NATO-a može da radi na Kosovu. Na osnovu toga, ovih kadrovi radiće se sa pripadnicima Kosovske Bezbednosne Snage, na daljem razvijanju njihovog kapaciteta, da izvršavaju svoja osnovna četiri zadatka, na gašenje požara, izvlačenju i spašavanju, odlaganju opasnog materijala i uklanjanju eksplozivnih materijala.

Duboko smo ubeđeni da je ratifikacija ovakvog sporazuma u interesu naših i ostalih zajednica i kosovskog društva u celini, tako da će Samostalna Liberalna Stranka podržavati ovaj sporazum. Hvala!

KRYETARI: Falemnderit! Radhën e ka kryetari i Grupit “6+”, Albert Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Falemnderit, i nderuari kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar këtë projektligj për ratifikim dhe do ta votojë dhe e mbështet ratifikimin e marrëveshjes me SHBA-të. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Nuk kemi të lajmëruar të tjerë për diskutim. Të pranishëm janë 98 deputetë.

(Ndërhyrje)

Shiko ministër, Administrata e Kuvendit nuk ndërhyr në tekst, sponsoruesi i dokumentit mund t'i bëjë ndërhyrjet gjuhësore, por ne si Kuvend nuk i bëjmë.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 98 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, me 98 deputetë të pranishëm. Kuvendi e miratoi Ligjin për ratifikimin e këmbimit të Notave Diplomatieke për statusin e forcave të huaja ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën kontestimore

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim në parim.

E ftoj ministrin e Drejtësisë, zotin Hajredin Kuçi, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Falemnderit, i nderuari kryetar!

I nderuari kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë, zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që para Kuvendit të Republikës së Kosovës ta prezantoj projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën kontestimore.

Ky projektligj është rezultat i punës dhe i përkushtimit të vazhdueshëm të Ministrisë së Drejtësisë për plotësimin e infrastrukturës ligjore në fushën e drejtësisë civile, si dhe eliminimin e zbrazëtirave dhe mangësive ligjore në këtë fushë.

Ky projektligj ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e dispozitave të Ligjit për procedurën kontestimore, që ka qenë në kolizion me ligjet tjera; plotësimin e ligjit me dispozita tjera për evitimin e mangësive dhe rregullimin e çështjeve përkatëse, si dhe harmonizimin e ligjit me ligje tjera të ndërlidhura me procedurën kontestimore.

Hartimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën kontestimore është iniciuar nga Ministria e Drejtësisë, pas analizimit të funksionimit të sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës dhe pas pranimi të rekomandimeve dhe sugjerimeve nga ekspertët dhe institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

Projektligji është hartuar në pajtim me procedurën për hartimin e legjislacionit dhe në bashkëpunim me ekspertët e vendit dhe ata ndërkombëtarë.

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën kontestimore është miratuar në Qeverinë e Kosovës më 25.4.2012, sipas procedurës së paraparë dhe i parashtrohet Kuvendit për miratim.

Ky projektligj përmban 28 nene dhe përfshin dispozitat që e kanë këtë qëllim.

Harmonizimi i Ligjit për procedurën kontestimore me Ligjin për përdorimin e gjuhëve zyrtare në Republikën tonë.

Ngritja e efikasitetit dhe respektimi i afatit për nxjerrjen e aktgjykimit nga gjyqtari, duke përcaktuar obligimin për përfshirjen e datës së marrjes së aktgjykimit në pjesën hyrëse të aktgjykimit.

Plotësimi dhe përcaktimi i shkeljeve për të cilat lejohet paraqitja e revizionit, përcaktimi i rasteve ku nuk lejohet paraqitja e revizionit.

Përcaktimi i mundësive të ofrimit të provave të reja me revizion, vetëm nëse ato kanë të bëjnë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të bëra në procedurën e gjykatës së shkallës së dytë dhe pa fajin e palës, nuk ka qenë e mundur të paraqiten më herët.

Plotësimi i dispozitave me Institutin e Revizionit të palejueshëm dhe përcaktimin e rasteve kur revizioni është i palejueshëm.

Plotësimi dhe qartësimi i dispozitave për padi, vërtetimi me qëllim të eliminimit të pengesave të vërejtura gjatë praktikës gjyqësore.

Dispozitat për mbrojtjen e bashkë-ndërgjyqësve me rastin e marrëveshjes gjyqësore, apo tërheqjen e kërkesë-padisë.

Plotësimi i dispozitës që ka të bëjë me caktimin e ekspertizës nga gjykata ex officio, e jo vetëm me propozimin e palëve, siç ka qenë deri më tani.

Eliminimi me kolizionin e Ligjit për arbitrazhin dhe përcaktimi i dispozitës për njohjen dhe përbarimin e vendimeve të huaja, në përputhje me Konventën e Nju-Jorkut për njohjen dhe përbarimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit.

Ndryshimet e tilla janë të rëndësishme që ky projektligj të jetë në funksion të eliminimit të pengesave procedurale me të cilat janë ballafaquar deri më tani gjykatat, por edhe palët gjatë zhvillimit të procedurave kontestimore.

Eliminimi i këtyre pengesave, u mundëson gjykatave dhe palëve në procedurë të kenë efikasitet dhe sukses në trajtimin e lëndëve dhe në zgjidhjen e tyre në afat sa më të shpejtë kohor.

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën kontestimore është hartuar edhe në përputhshmëri të plotë me standardet ndërkombëtare, duke përfshirë edhe ato të së drejtës evropiane dhe të drejtën ndërkombëtare.

Miratimi i këtij projektligji është i një rëndësie të veçantë dhe e kompletion infrastrukturën ligjore në sistemin e drejtësisë dhe do të mundësonte në shtimin e efikasitetit të punës së Gjyqësorit, si dhe do të ndikonte direkt në arritjen e besimit të qytetarëve për punën e gjyqtarëve dhe të prokurorëve tanë.

I nderuri kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Duke marrë parasysh rëndësinë e ndryshimeve të propozuara në këtë projektligj dhe eliminimin e zbrazëtirave dhe mangësive ligjore në këtë fushë, dhe me qëllim të shtimit të efikasitetit të punës së Gjyqësorit, ju propozoj që me sugjerimet dhe vërejtjet tuaja ta miratojmë këtë projektligj. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit zëvendëskryeministër! Fjalën e ka kryetari i Komisionit Funkcional për Legjislacion, deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Falemnderit, kryetar!

Komisioni për Legjislacion e ka trajtuar ligjin. Ligji ka bazë juridike dhe nuk është në kolizion me ligje tjera. Është një ligj i rëndësishëm që sqaron disa çështje që kanë mbetur pezull në Legjislacionin e Kosovës. Prandaj, mendojmë se ky ligj duhet të kalojë. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Falemnderit, kryetar!

Edhe në Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike e kemi shqyrtuar këtë projektligj dhe do ta japim kontributin tonë në Komisionin Funkcional. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të “Vetëvendosjes” deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Falemnderit, kryetar! Edhe ne si Grup Parlamentar e kemi analizuar projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën kontestimore. Në këtë plotësim-ndryshim kemi vërejtur që ka më tepër ndryshime teknike, që kanë të bëjnë me terminologjinë juridike, mirëpo edhe disa tjera përmbajtjesore, të cilat mendoj se do ta lehtësojnë implementimin e këtij ligji dhe sadopak do të ndihmojnë në kompletimin e infrastrukturës ligjore në fushën e drejtësisë. Andaj, si të tillë do ta votojmë. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të AAK-së, deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Falemnderit, zoti kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës e ka shqyrtuar projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën kontestimore dhe e përkrah atë në parim.

KRYETARI: Ndoshta e kalova LDK-në, për shkak se Arbeni e pati fjalën. A e do dikush fjalën në emër të LDK-së? Deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Falemnderit, kryetar!

Edhe grupi ynë kuvendar e kemi shqyrtuar këtë projektligj, i cili vjen si plotësim-ndryshim për procedurën kontestimore. Mangësitë e evidentuara në tekstin bazik të ligjit, sidomos gjatë procedurave gjyqësore, është shumë e nevojshme të ndryshohen dhe të përshtaten me ligjet tjera, që të mos ketë kolizion, siç është rasti edhe te pjesa e arbitrazhit. Prandaj, ne e përkrahim në parim dhe sigurisht që edhe kontributin tonë do ta japim nëpërmjet Komisionit Funkcional. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, fjalën e ka deputeti Amir Ahmeti.

AMIR AHMETI: Falemnderit, kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, për Ligjin për procedurën kontestimore mendojmë se ndryshimet dhe plotësimet në këtë ligj janë në funksion të punës më efikase të gjykatave në lidhje me çështjet e procedurave kontestimore dhe mendojmë se ky ligj do ta bëjë më të lehtë dhe më efikase punën e gjykatave, që qytetarët e Kosovës të marrin shërbime më të shpejta dhe më të drejta në gjykata tona. Kontributin tonë në vazhdim do ta japim në komisionet përkatëse dhe projektligjin do ta përkrahim në parim. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit, deputet! Në emër të SLS-së, deputetja Jasmina Zhivković e ka fjalën.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Hvala predjedavajući!

I Parlamentarna Grupa SLS je razmatrala ovaj predloženi Nacrt zakona, i smatramo da ovim predlogom se znatno olakšava primena već postojećeg zakona o parničnoj proceduri, te čemo s toga podržati ovaj Nacrt zakona. Hvala!

KRYETARI: Falemnderit! Kryetari i Grupit “6+”, Albert Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Falemnderit, i nderuari kryetar! Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën kontestimore dhe në parim do ta votojë, ndërsa kontributin do ta japë nëpërmjet komisionit. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit, deputet! Tani për debat është deputetja Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Falemnderit!

Ajo që desha ta theksoj është rëndësia e nenit 511 të këtij ligji, që parasheh procedurën e arbitrazhit, si një ndër metodat që ka ndikuar në zhvillimin e bizneseve, sidomos në vendet e rajonit dhe të thithjes së investimeve të huaja. Ka rëndësi të veçantë futja e aplikueshmërisë së Konventës së Nju-Jorkut të vitit 1958, e cila kërkon përmbartimin dhe njohjen e vendimeve të arbitrazhit të tribunaleve të huaja dhe dhënien e përparësisë së

atyre vendimeve ndaj vendimeve të gjykatave. Për arsye se, siç e thashë, aplikueshmëria e arbitrazhit në zgjedhjen e kontesteve biznesore është metoda kryesore në vendet e zhvilluara dhe deri tani bizneset e Kosovës e kanë pasur një problem jashtëzakonisht të madh në implementimin e kontratave të tyre sidomos me investitorë të huaj. Prandaj, një dispozitë e tillë besoj që do ta lehtësoj edhe punën e gjykatave për implementimin dhe për përmbartimin e vendimeve të tribunaleve të huaja të arbitrazhit. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Falemnderit, kryetar!

Nuk ka dilemë se këto përmirësime të këtij projektligji janë shumë të rëndësishme për efikasitetin e procedurave civile, në veçanti atyre kontestimore.

Unë e kam vetëm një sugjerim, në nenin 21 është përdorur shprehja ex officio, pra një shprehje që përdoret gjerësisht në shkencat juridike, por edhe në legjislacion. Sugjeroj që ajo të zëvendësohet me shprehjen në gjuhën shqipe, “sipas detyrës zyrtare”. Pra, ekziston mundësia edhe besoj që e ka të njëjtin kuptim që e ka propozuar edhe propozuesi. Falemnderit!

KRYETARI: Mirë, falemnderit! Nuk kemi të lajmëruar për diskutim. Nuk e kemi kuorumin për të votuar. Vazhdojmë diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim në parim.

E ftoj ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Falemnderit, zoti kryetar!

I nderuari kryetar i Kuvendit,

I nderuari zëvendëskryeministër, ministër,

Deputetë të nderuar,

Më lejoni që shkurtimisht ta prezantoj projektligjin për taksën rrugore dhe ekologjike, të cilën e ka hartuar Ministria e Financave.

Fillimisht, më lejoni të ju informoj se kjo fushë deri më tani ka qenë e rregulluar me Rregulloren ekzistuese 2005/14, të lëshuar nga UNMIK-u, e cila ha hyrë në fuqi më 20.03.2005. Në bazë të kësaj rregulloreje, të gjitha automjetet e regjistruara në Kosovë do të paguajnë taksë rrugore.

a). Ato nën 3.5 tonë në vlerë prej 40 euro dhe

b) Ato me peshë mbi 3.5. tonë në vlerë prej 90 euro.

Përveç taksës rrugore për automjetet, e cila është taksë vjetore fikse, në këtë projektligj do të përfshihet edhe një taks ekologjike, e cila është taksë vjetore specifike dhe e cila do të jetë e përcaktuar në bazë të llojit të automjetit dhe cila do të paguhet nga të gjithë personat fizikë dhe juridikë që përdorin automjetet rrugore dhe automjetet e tyre ndihmëse në territorin e Republikës së Kosovës.

Kësaj takse gjithashtu do t'u nënshtrohen edhe automjetet e huaja, të cilat hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës. Këto janë taksa vjetore, pra do të paguhet një herë në vit.

Propozimi i cekur më lart është në harmoni me rregulloret e BE-së, sipas aquitimitare, si dhe me praktika ndërkombëtare.

Hartimi i këtij ligji është bërë në përputhje me praktikën e vendeve fqinja dhe vendeve të Bashkimit Evropian dhe standardeve ndërkombëtare të pranura në lidhje me këtë fushë.

Ky ligj është në harmoni me Traktatin e Kopenhagës dhe Protokollin e Kiotos, sipas të cilave shumë vende në botë dhe rajon e kanë zbatuar taksën mbi produktet dhe aktivitetet që bëjnë lirim e gazrave të dëmshme sikur dyoksidi i karbonit, të cilat kanë ndikim shkatërrues për ekologjinë.

Gjithashtu është konsultuar edhe direktiva 2005/55EC lidhur me mostrat që duhet marrë kundër emetimit të ndotësve të gaztë nga motorët e automjeteve si shpërndarës të ndotësve të gaztë nga motorët me gaz natyror, ose gaz të lëngshëm të naftës.

Vendosja e taksës ekologjike për automjete bëhet në përputhje me zotimet e Qeverisë për rritje më të lartë të standardeve në mbrojtjen e ambientit dhe përmirësimin e kualitetit të jetës, në përgjegjësi, në kontekst të procesit të vazhdueshëm të integritetit të Kosovës në BE.

Kështu që si pjesë e kontributit për mbrojtjen e mjedisit, si dhe bazuar në reforma, në kontekstin e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian Ministria e Financave propozon një taks ekologjike për mbrojtjen e ambientit, e cila në të njëjtën kohë rezulton me të hyra shtesë për Buxhetin e Kosovës.

Qytetarët e Republikës së Kosovës do ta paguajnë taksën ekologjike kur ta kryejnë regjistrimin e automjeteve, ndërsa shtetasit e huaj do ta paguajnë taksën ekologjike me hyrjen e tyre në Kosovë. Kjo taksë është propozuar të jetë 10 euro për automjetet nën 3.5 tonë dhe 30 euro për automjetet mbi 3.5 tonë.

Ky ligj gjithashtu do të ketë ndikim pozitiv edhe në të hyrat për Buxhetin e Kosovës.

Të gjitha të hyrat, sidomos sa i përket taksës specifike ekologjike, të cilat do të jenë shtesë për Buxhetin e Kosovës, ne jemi të gatshëm që me rastin e propozimit të buxhetit

të njëjtat t'i kthejmë në Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor me qëllim të përmirësimit të ambientit. Falemnderit!

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Falemnderit! Fjalën e ka kryetarja e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, Safete Hadergjonaj. Nuk e merr fjalën, d.mth. nuk e do. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Hasime Krasniqi.

HASIME KRASNIQI: Falemnderit, zoti nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar dhe analizuar këtë projektligj dhe në parim e mbështet atë. Kontributin tonë ne do ta japim në Komisionin FunkSIONAL. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Për Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Falemnderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar Ligjin për taksën rrugore dhe ekologjike. Ky ligj e rregullon një pjesë të fushëveprimtarisë së Rregullores së UNMIK-ut 2005/14, sipas të cilit qytetarët e kanë paguar taksën rrugore.

Ne kemi problem me vënien e taksës së re, do të thotë të taksës ekologjike. Në fakt, taksa ekologjike nuk tingëllon keq, por qëllimi i projektligjit nuk konsiston aspak me emrin.

Ky ligj është vazhdimësi e aksioneve të Ministrisë së Financave për ta mbushur arkën e shtetit, e cila po shpenzohet pa plan.

Të hysh në Bashkimin Evropian, para së gjithash, do të thotë të kesh një mirëqenie ekonomike, shteti të marrë nga qytetarët dhe bizneset vetëm aq sa për t'i mbuluar shpenzimet elementare. Ta lejojë sektorin privat të rritet dhe të gjenerojë vende pune. Sa i përket ligjit, ne do të pajtoheshim sikur Qeveria paraprakisht ta paraqiste një plan për mbrojtjen e ambientit dhe të tregonte se qëllimi i vjeljes së kësaj takse ka për qëllim mbrojtjen e ambientit. Mirëpo, po ta shikojmë kornizën afatmesme të shpenzimeve 2013-2015, shihet se buxheti për mbrojtjen e ambientit për 3 vjetët në vijim është në shumën prej 5 milionë e 10 mijë euro. Ndërsa nga zbatimi i këtij ligji inkasohen 5.2 milionë euro në vit.

Por, më tepër, në memorandum shpjegues të qëllimi dhe arsyt e nxjerrjes së projektligjit thuhet se ky projektligj është në përputhje me prioritetet të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të cilat ndërlidhen me qëndrueshmërinë makro-fiskale dhe se është në harmoni me marrëveshjet që Qeveria e Republikës së Kosovës i ka me institucionet ndërkombëtare financiare, duke aluduar këtu në Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Ne jemi kundër taksave të tilla që për qëllim e kanë vetëm mbushjen e xhepave të qeveritarëve; ngritjes së tatimeve, si ato në të ardhurat personale, të hyrat nga korporatat; ngritjes së akcizës së duhanit; akcizës në gomat e përdorura, në poçet elektrike e tjera, të cilat nuk po përmbushin standarde por po e rëndojnë edhe më tepër jetën e qytetarëve, po e financojnë stafin e punësuar në baza familjare 100% në 19 ministritë e Qeverisë Thaçi, po i mbulojnë shpenzimet e kostove të veturave të reja të Qeverisë, të cilat po ndërrohen çdo 2 vjet, po financojnë karburante, shpenzime marramendëse të telekomunikimit, darkat e drekat zyrtare dhe mëditjet e qeveritarëve që po i marrin për ekskursionet që po i bëjnë jashtë Kosovës.

Dhe, duke marrë parasysh të gjitha këto, LDK-ja i thotë “jo” këtij ligji, pikërisht për shkak të vënies së taksave të reja, që kanë qëllim tjetër, e jo atë të mbrojtjes së ambientit. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit zonja deputete! Për Grupin e Lëvizjes “Vetëvendosje”, deputetja Albana Fetoshi.

ALBANA FETOSHI: Falemnderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Taksa rrugore është identike me atë që ka qenë si rregullore e UNMIK-ut, bile edhe në tekst nuk ka asnjë ndryshim, veçse tani është ligj i Kosovës, e jo rregullore e UNMIK-ut. Pra, vazhdohet që kjo taksë rrugore për automjetet me peshë nën 3.5 tonë të mbetet 40 euro.

Taksa ekologjike do të jetë 10 euro, dhe kjo është risia, pra dhjetë euro gjatë regjistrimit të veturës, ose për veturat e huaja gjatë hyrjes në kufi.

Kjo taksë do të derdhet në buxhetin qendror dhe nuk ka kurrfarë dispozite që kjo taksë të përdoret për ekologji, apo që së paku fondi ekologjik do të rritet për ta minimizuar efektin e veturave.

Ne jemi të vetëdijshëm se situata e ndotjes së ambientit është në nivel alarmant. Përveç ndotjes industriale, në Kosovë ekziston një numër jashtëzakonisht i madh i veturave të vjetra ndotëse.

Po ashtu, jemi të vetëdijshëm se shumica e shteteve e imponojnë një taksë të tillë ekologjike për vetura për të paguar për ndotjen që e shkaktojnë.

Megjithatë, nuk pajtohem me qëllimet e kësaj Qeverie, e cila këtë taksë po e imponon vetëm për t'i mbushur zbrazëtirat buxhetore, si pasojë e planifikimit të dobët buxhetor.

Po ashtu, nuk kemi vërejtur asnjë rritje, as të buxhetit, as planifikimit buxhetor për ambient për ta justifikuar një taksë të tillë.

Prandaj, si përfundim, ne abstenojmë, derisa nuk marrim siguri se qëllimet janë me të vërtetë ambientaliste, e jo për mbushje të zbrazëtirave dhe plaçkitje e diasporës. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit, deputete! Kryetari i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Falemnderit, zoti nënkryetar!

Shumë ngjashëm, edhe ne mendojmë se në Kosovë është me rëndësi që të punohet drejt përmirësimit të kushteve të ambientit. Sidoqoftë, u tha se ka shpërputhje ndërmjet kësaj takse, e cila do të vjelë mjete për Buxhetin e Kosovës dhe kornizës afatmesme të shpenzimeve. Do të thotë nuk është përcjellë korniza e shpenzimeve, nuk është paraparë qartë që këto mjete vërtet do të shkojnë në përmirësimin e gjendjes në ambient. Kjo është çështja e parë.

Çështja e dytë tepër e rëndësishme është se rritja e taksave, e cila po ndodh gradualisht në Kosovë, nuk po korrespondon me rritjen e GDP-së, do të thotë bruto-produktit, që do të thotë se nëse ka rritje të taksave dhe nuk ka rritje të bruto-produktit, popullsia shkon duke u varfëruar te biznesi. Në të njëjtën kohë, kjo fillon të rritet si ortek, si një varfërim ortek, i cili në Kosovë ka filluar të shihet me rënien e të hyrave buxhetore, jo për shkak të mospagesës vullnetare, ose jo për shkak të ngurrimit të bizneseve që të paguajnë taksa, por për shkak të uljes së aftësisë së tyre për të bërë biznes e për të paguar taksa.

Ne mendojmë se politikat e këtilla janë të gabueshme aq më tepër kur nuk janë paraparë më përpara se si do të mund të shpenzohen dhe si do të mund të kthehen këto taksa në të njëjtën kohë në të mirë të qytetarëve dhe të të biznesit.

Po ashtu, ne mendojmë se ky ligj këssoj nuk duhet të kalojë. E dimë se është e rëndësishme që të ecet më tutje në këtë drejtim, mirëpo nuk është i përgatitur në harmoni as me NDP-në, as me dokumente tjera, të cilat Qeveria i ka sjellë më përpara në Kuvend. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit, zoti Gjini! Për SLS-në, deputetja Jelena Bontiq.

JELENA BONTIĆ: Hvala predsedavajući!

Zakon koji je pred nama donosi nove novine, uređenje plaćanja taksi na korišćenje puteva, ranije definisano Uredbom UNMIK-a, i uvođenje nove ekološke taksa na motorno vozila.

Posebno bi se sadržala na implikacije ove druge takse. Tako nas je predlagač Zakona informisao uvođenje ekološke takse u skladu je sa evropskim standardima, i ne krši načela Evropske unije.

Moja prva zamerka je ipak ta što se iz Nacrta zakona ne vidi jasno gde će se i na koji način trošiti novac, prikupljen na ovaj. Smatramo da bi ovim Zakonom, ili podzakonskim aktima, trebalo definisati da se novac prikupljen po ovom osnovu troši za potrebe ekološke zaštite. Samo tako uređenje ovog nameta imaće svoj pun smisao.

Drugi stvar na koji bi se osvrnula tiče se odredbi ovog zakona, po kojem i vozila koja nisu registrovana na Kosovu plaćaju ekološku taksu u istom iznosu. Prosta logika govori da nivo ekološkog zagađenja nije isti od strane vozila koja su na Kosovu privremeno, i koja su tu tokom cele godine.

Takođe bih iskoristila priliku da posetim da su nakon briselskog sporazuma Beograda i Prištine, prilikom implementacije sporazuma o slobodi kretanja nastali priličnih problemi. Osiguranje za prelaz motornih vozila postala je finansijska prepreka, možda čak i veće nego ona administrativna koja postojala pre pregovora.

Predstavnici srpske zajednice, koji prirodno imaju potrebu za najvećom frekvencijom na ovim prelazima, za to su astronomske cene osiguranje njih pogodilo najviše.

Koristim ovu priliku da pozovem Ministarstvo Financije da u saradnji sa uređenjem osigurača preispita cenu osiguranja koja se plaća na prelazima.

Samostalna Liberalna Stranka shvata potrebu uređenje ove oblasti i podržaće ovaj zakon u načelu. Hvala!

KRYESUESI: Falemnderit! Për Grupin “6+“, Albert Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Falemnderit, i nderuari nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar Projektligjin për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve. Në parim, grupi do ta votojë këtë projektligj, ndërsa kontributin do ta japë nëpërmjet komisionit. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Nga deputetët, fjalën e ka Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Falemnderit, i nderuari nënkryetar i Kuvendit!

Qysh në titull tingëllon si diçka pozitive, “taksa rrugore ekologjike”, tingëllon se qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e ambientit. Mirëpo, veprimet e mëtutjeshme janë në kundërshtim edhe me titullin, edhe me qëllimin. Pse? Sepse kostoja e këtij ligji do të shkojë direkt te një masë shumë e madhe e qytetarëve, që e dëmton realisht interesin e tyre, sepse ata do të detyrohen të paguajnë edhe më shumë, për qëllimin që u cek, pra mbushja e Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Ne e kemi parasysh dhe e dimë që Qeveria e ka për qëllim mbushjen e buxhetit dhe duhet ta mbushë buxhetin, mirëpo nuk duhet të shkaktojë aso defektesh, që pastaj ta rëndojë buxhetin e varfër të familjes me taksa të tilla.

Nëse do të duhej të ishte vërtet qëllimi mbrojtja e ambientit, atëherë Qeveria, e në këtë rast Ministria si propozues i këtij ligji, do ta kishte shumë më të lehtë që të propozonte taksa, supozojmë, për “Ferronikelin”.

Ju e dini se “Ferronikeli”, përveç se shkakton probleme, edhe e rrezikon jetën e qytetarëve të Drenasit në vazhdimësi, emeton edhe gazra dhe e dëmton ambientin. Do të mund të vendoste taksa edhe për Korporatën Elektroenergjiqe të Kosovës.

Mirëpo, unë e kam dyshimin e bazuar se pikërisht këto para për taksën ekologjike, mbledhjen në emër të taksës ekologjike, do të shkojnë subvencione për KEK-un, i cili do të prodhojë ndotje ekologjike, që është një problem në koncept. Çka po bëjmë? Cili është qëllimi i kësaj takse?

Po ashtu, Ministria dhe Qeveria, në këtë rast, do të duhej t'i kishin parasysh edhe disa elemente tjera. Deponitë që janë krijuar në Kosovë, lloj-lloj deponish, disa sosh që po vërehen kohëve të fundit dhe që janë këtu rreth Prishtinës, janë deponi të mineraleve. Këto deponi të mineraleve, përveç se rrezatojnë, kanë edhe rrezatim radioaktiv, e ndotin edhe ambientin, e nuk u paguajnë institucioneve të Kosovës apo Qeverisë së Republikës së Kosovës asnjë lloj takse tatimi.

Këto do të duhej të ishin objektivi i parë i taksimit dhe i tatimit nga institucionet e shtetit të Republikës së Kosovës, e jo buxheti i varfër i familjeve të Kosovës. Sepse, kjo taksa shtrihet shumë gjerë në buxhetin e varfër të familjeve, e jo në buxhetin e disa bizneseve klienteliste të Qeverisë.

Ju e dini se ka raporte klienteliste ndërmjet përfaqësuesve të Qeverisë dhe individëve të caktuar që merren me biznes dhe e ndotin relativisht shumë ambientin. I përmenda disa, siç janë: “Ferronikeli”, KEK-u, deponitë e mineraleve që janë bërë rreth kryeqytetit e në disa qytete tjera, dhe këto, përveç se e ndotin ambientin, rrezatojnë radioaktivitet dhe e rrezikojnë shëndetin publik të qytetarëve të Kosovës.

Prandaj, mendoj se prioriteti i parë do të ishte eliminimi i rrezikut nga radioaktiviteti dhe pastaj të vinte ministri e të fliste me këto fjalë shumë të lezetshme - Protokolli i Kjotos dhe protokollet e tjera për emetimin e gazrave, mirëpo realisht emetimi i gazrave bëhet nga dy prodhues, emetues të mëdhenj, që është “Ferronikeli”, i cili me shpërthime e herëpashershme po e rrezikon edhe jetën e qytetarëve të Drenasit dhe KEK-u, i cili po subvencionohet me këto para, që po merren për taksën ekologjike, gjë që është non sens. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Fjalën e ka deputetja Aurora Bakalli.

AURORA BAKALLI: Falemnderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Projektligji për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve paraqet një iniciativë të mirë dhe të rrallë për mbrojtjen e ambientit në Kosovë.

Kjo iniciativë, në formën e një projektligji prej 6 faqesh, jo vetëm për shkak të vëllimit të tij, por edhe për shkak të përmbajtjes, ofron skepticizëm.

Nëse vendosim ta mbrojmë ambientin, për ta bërë këtë ka shumë mënyra. Këto mënyra domosdo vijnë nëpërmjet vendosjes së standardeve për mbrojtjen e ambientit edhe nëpërmjet taksave të ndryshme. Mirëpo, duke pasur parasysh se ndotja është kuantitative, pra e matshme, atëherë ndotësi do të duhej identifikuar dhe klasifikuar. Pra, ka ndotës më të mëdhenj dhe më të vegjël. Rrjedhimisht, për ata të cilët prodhojnë më shumë ndotje do të duhej afruar standarde, të cilat janë më strikte dhe taksa të cilat janë më të larta, se sa për ata të cilët veprojnë në të kundërtën.

Edhe në rastin e veturave, do të duhej të vlente e njëjta gjë. Veturat të cilat prodhojnë ndotje më të madhe, do të duhej paguar taksa më të larta se sa ato vetura të cilat posedojnë katalizatorë. E pastaj, e gjithë kjo do ta stimulonte uljen e ndotjes, qoftë nëpërmjet konsumit më të kujdesshëm, apo nëpërmjet uljes së numrit të veturave.

Si rrjedhojë e kësaj, do të shfaqeshin opsione të ndryshme për zgjidhjen racionale të nevojës për transport në sferën ndërrbane, e madje edhe të distancave më të mëdha. Mirëpo, kjo nuk do të mund të arrihet pa investime nga shteti, i cili është në pozitë që të akumulojë mjete nga ndotësit për të qenë në gjendje që më pastaj ta përmirësojë ambientin dhe jetën e qytetarëve të vet.

E gjithë kjo tingëllon ideale dhe gati e pamundshme, por tingëllon e tillë vetëm për faktin se asnjëherë nuk është provuar të bëhet konkretisht.

Një gjë e cila bie në sy në këtë projektligj është mosprecizimi i saktë i alokimit të këtyre mjeteve. Aty, dorën në zemër, përmendet se këto mjete do të shkojnë në Buxhetin e Kosovës, por nuk precizohet se ku do të përdoren ato.

Konsideroj se nëse këto mjete mblidhen në formë të taksave me qëllim të mbrojtjes së ambientit, atëherë pse të mos ceket se në cilën formë të mbrojtjes së ambientit do të alokohen.

Kur është fjala për ndotës, nuk duhet të mendojmë shumë dhe të gjithë do ta drejtojmë gishtin te termocentralet tona në Obiliq, që nuk ka dyshim se janë ndotësit më të mëdhenj në vend, ku patjetër se ka nevojë shumë të madhe për investime me qëllim të uljes së nivelit brengosës të përbërësve- ndotës të ambientit në atë rajon. Pikërisht ky, mendoj, është vendi i parë për t'i investuar këto mjete të mbledhura.

Ide tjetër do të ishte investimi për krijimin e hapësirave të gjelbra nëpër vendet urbane, me qëllim të pastrimit të ajrit, qoftë nga industria, apo numri i stërngarkuar i automjeteve.

Si përfundim, me këtë ligj do të duhej të parashihej se si do të shërbejë kjo taksë ekologjike apo taksë e gjelbër, siç quhet në shumë vende të botës, për një ambient më të pastër.

Në fund të fundit, ky projektligj, me anë të parashikimit të formave konkrete të investimit për një ambient më të pastër, do të arsyetonte edhe qëllimin e vet.

Nuk dua të besoj se kjo taksë është vetëm formë për ta shtuar buxhetin, apo pro-formë për t'i plotësuar standardet evropiane.

Komisionit i sugjerojmë që t'i marrë parasysh propozimet e Lëvizjes për Bashkim gjatë amendamentimit të këtij projektligji. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Deputetja Lumnije Morina e ka fjalën.

LUMNIJE MORINA: Falemnderit, kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministër,

Të nderuar deputetë,

Ashtu siç e tha edhe ministri i Financave, taksa rrugore për automjetet e regjistruara në Republikën e Kosovës ka qenë e rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut të vitit 2005, por sot ky projektligj, përpos taksës rrugore, do ta rregullojë edhe mbledhjen e taksës ekologjike për automjetet.

Ky projektligj, të cilin sot po e shqyrtojmë, ka shumë gabime dhe do të ishte e kuptueshme, ndoshta edhe e arsyeshme, nëse ky projektligj do të ishte voluminoz dhe për shkak të volumit do të mund të ishin lëshuar gabime. Por, kështu siç është, me kaq pak nene, me vetëm 10 sosh, është e pajustificueshme dhe e patolerueshme të ketë kaq shumë gabime.

Gabime ka që nga përkufizimet, ku bëhet shpjegimi i shprehjeve që përdoren në këtë projektligj, dhe, në vend që shprehjet të sqarohen, ato ngatërrohen. Për shembull, “person përgjegjës” është vendosur në thonjëza, e që nuk duhet të jetë ashtu. Shpjegimi është ky: do të thotë personi, në emrin e të cilit është regjistruar automjeti, apo në emrin e të cilit automjeti kërkon të regjistrohet, sipas Ligjit numër 2, e tjera, e tjera.

Sqarimi, apo më mirë të them ngatërimi, vazhdon edhe me katër shprehje tjera, për shembull: “automjeti i regjistruar”, “rrugë të Kosovës” e tjera dhe nuk bëhen sqarime për shprehjet, për shembull “taksë rrugore”, “taksë ekologjike”, “taksë vjetore”, “inkasim i taksës”, “dëshmia e pagesës” e tjera, e tjera.

Shprehja “taksë” është fjalë kyçe e këtij projektligji që nga fillimi e deri në fund dhe nuk ka sqarime te përkufizimet.

Vend për t’u përmirësuar e riformuluar ka pothuajse që nga fillimi deri në fund të këtij projektligji, por i mbetet Komisionit FunkSIONAL që gjatë amendamentimit të punojë në rehabilitimin e gabimeve, të cilat janë evidente në këtë projektligj.

Përndryshe, mendoj se Ministria e Financave mjetet e vjela nga taksa ekologjike duhet t’i derdhë në Ministrinë e Ambientit dhe kjo ministri do t’i shfrytëzojë për përmirësimin e kushteve të ambientit. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Falemnderit, zoti kryesues!

Normalisht që situata ekologjike në Kosovë duhet të përmirësohet dhe t’i jepet kontribut rreth kësaj situatë.

Por, ne si Grup Parlamentar, duke e shqyrtuar këtë projektligj i kemi vërejtjet tona të mbështetura, sidomos në këtë taksë që i vihet të ashtuquajturës “shtetas të huaj”, megjithëse këtu bëhet fjalë për qytetarët e Republikës së Kosovës që punojnë në mërgatë, të cilët janë më të shumtit, që vijnë me automjete të tyre në Kosovë dhe mendoj se në vend që të mendonte edhe Qeveria që 50 euron e famshme t’ia hiqte si një e padrejtë që po u bëhet atyre për sigurime shtesë, kjo Qeveri po i shton obligimet e kësaj kategorie, e cila ka dhënë shumë për këtë vend dhe po ashtu po i shton obligimet dhe i trajton si shtetas të huaj, duke e vënë një taksë shtesë për qytetarët e Kosovës, të cilët punojnë në mërgatë.

Mërgimtarët tanë do të duhej të ishin ndër të fundit të cilëve do t’u kërkohej që të - ta quaj kuptimisht “të dënoheshin” me taksa të tilla të padrejta, sepse ne vlerësojmë që kjo taksë është e padrejtë ndaj tyre.

Përderisa shtetasit e Kosovës nuk paguajnë dhe me automjetet e tyre nuk paguajnë kur shkojnë as në Shqipëri, as në Maqedoni, as në Mal të Zi, e as në Gjermani e në Zvicër, atëherë pse ata do të duhej ta paguanin një taksë të tillë shtesë?

Pra, ne jemi që taksa shtesë ekologjike, e quajtur “taksë për shtetasit e huaj”, pavarësisht se mund të jenë me dyshtetësi apo shtetasit shqiptarë e kosovarë që janë dhe punojnë në mërgim, nuk do të duhej t’u vihej edhe atyre kjo taksë.

Pra, në anën tjetër, Qeveria e ka një qëllim dhe është e kuptueshme se qëllimi i Qeverisë është që ta mbushë buxhetin për këtë pjesë të vitit të mbetur, për shkak se diaspora po rëndohet edhe më tutje nga kjo taksë dhe dihet që kjo taksë po ngutet të implementohet nga 1 korriku. Dhe, ne e dimë se qëllimi i Qeverisë është për të vjelë edhe pak para në shërbim të mbushjes së buxhetit. Por, Qeveria edhe me buxhetin e këtij viti nuk e ka parë shumë shqetësues ambientin, përderisa edhe e ka zvogëluar buxhetin për ambientin nga viti 2011 në vitin 2012

Pra, ne po e kuptojmë qëllimin e kësaj takse, qëllimi është i thjeshtë, për t’i vjelë edhe pak para për t’ia dhënë Buxhetit të Kosovës, por kësaj radhe të kamufluar në emër të një takse ekologjike. Mendoj se Qeveria do të duhej të kërkonte diku tjetër për ta mbushur buxhetin, e jo nga ajo kategori, e cila gjithmonë ka dhënë dhe është e gatshme të japë, por jo të merren në këtë formë si taksë për ambiente, apo taksë ekologjike.

Prandaj, si përfundim, ne do të përmbahemi në votim, pra do ta abstenojmë këtë ligj përderisa nuk marrim siguri se qëllimet e vërteta ambientaliste nuk kanë tendencë për ta vjelë edhe më tutje diasporën. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Deputeti Haki Demolli e ka fjalën.

HAKI DEMOLLI: Falemnderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit të Kosovës,

Unë do të paraqes disa vërejtje dhe propozime lidhur me këtë projektligj.

Fillimisht kam një vërejtje të përgjithshme, sepse me dispozitat e këtij ligji nuk përcaktohet destinimi specifik i të hollave të inkasuara nga taksa ekologjike, shuma e të cilave, duke pasur parasysh numrin e veturave të regjistruara në Kosovë, që është 252 mijë e 610 sosh, dhe me ato që do të hyjnë, sigurisht do të jenë afro 5 milionë euro në vit.

Nëse kjo çështje nuk rregullohet me këtë ligj, atëherë qytetari ynë vetvetiu vetvetiu do të dyshojë se këto mjete financiare do të shfrytëzohen për blerjen e veturave luksoze të qeveritarëve, apo për shpenzime tjera reprezentative të zyrtarëve të lartë.

Andaj, propozoj që në dispozitat e këtij ligji të përcaktohet destinimi i tyre, e që, sipas mendimit tim, ato duhet destinuar për ndërtimin dhe avancimin e ambientit jetësor të qytetarëve kosovarë, siç është ngritja dhe mirëmbajtja e parqeve, mbjellja e fidanëve dhe krijimi i hapësirave të gjelbra, në përgjithësi.

Ndërsa, vërejtja ime konkrete ka të bëjë, në radhë të parë, me nenet 2 dhe 3. Konkretisht, me paragrafët dy të këtyre neneve, në të cilët theksohet se “shuma e taksës do të vihet në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, është përcaktuar me shtojcën b) përkatësisht shtojcën c) të këtij ligji”. Mirëpo, kur i shikojmë këto dy shtojca b) dhe c), atëherë

vërejmë se secila prej tyre nuk i ka as nga dhjetë fjalë. Andaj, jam i mendimit që shtojcat e këtij ligji të hiqen në tërësi, kurse përmbajtja e tyre të inkorporohet në nenet përkatëse, respektivisht në nenet 2 dhe 3.

Më tutje, në nenin 5, paragrafi 1 theksohet se inkasimi i taksës ekologjike për veturat e huaja, përveç që bëhet me rastin e kalimit të automjeteve në kufij shtetërorë të Republikës së Kosovës, ajo mund të bëhet edhe në një moment tjetër kohor - të përcaktuar nga ministri i Financave, nëpërmjet akteve nënligjore.

Mendoj se kjo pjesë e dytë e këtij paragrafi vetëm sa e komplikon procesin e inkasimit të kësaj takse. Andaj, propozoj që pjesa e dytë e paragrafit 1 të fshihet në tërësi, dhe atë duke filluar nga fjalët “apo në ndonjë moment tjetër”.

Gjithashtu, edhe për nenin 7 kam vërejtje të njëjtë, sikur për nenet 2 dhe 3 dhe propozoj që teksti i shtojcës a) të bëhet pjesë e këtij neni.

Dhe, në fund, dëshiroj të theksoj se është interesante, që kur bëhet fjalë për ligjet prej të cilëve qytetarët e Kosovës përfitojnë ndonjë beneficet, atëherë Ministria sponosuese e ligjit, hyrjen në fuqi të tyre e parashih pas disa vjetësh. Kemi pasur raste që parashihet hyrja në fuqi në vitin 2015, apo hyrje në fuqi vitin 2016. Kurse, kur bëhet fjalë për ligjet në të cilat ngrenë obligimet financiare të qytetarit, edhe ashtu të varfër kosovar, atëherë parashihet që të hyjë në fuqi sa më parë që të jetë e mundshme, siç është rasti me këtë projektligj.

Prandaj, propozoj që hyrja në fuqi e këtij ligji, që rregullohet me nenin 10, të shtyhet për ndonjë vit, apo të paktën të mos hyjë në fuqi para janarit të vitit 2014.

Andaj, duke i pasur parasysh vërejtjet e theksuara, e sidomos goditjen e xhepit të qytetarit të varfëruar kosovar, edhe ashtu shumë të taksuar dhe të tatimuar nga kjo Qeveri, do të jem kundër aprovimit të këtij projektligji. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! I fundit për diskutim të kësaj pike është deputeti Sali Asllanaj.

SALI ASLLANAJ: Falemnderit, nënkryetar!

Përsëritje, zëvendëskryeministër,

Ministër,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në fillim të them se të bisedojmë për taksën ekologjike duket shumë e mirë për vesh, por realisht mund të jetë shumë e padobishme për qytetarët.

Këtë po e lidhi me atë që vërtet defekti më i madh i kësaj takse ekologjike është se nuk është paraparë destinimi apo dedikimi i këtyre mjeteve.

Unë e dëgjova justifikimin ministrit, i cili në mënyrë verbale premtoi se do të jenë mjete të destinuara për Ministrinë e Mjedisit, por gjithsesi serioziteti i kësaj pune shihet edhe

me mospranimin e ministrit të Mjedisit, që s'është këtu hiq kur po bisedohet për një taksë, e cila ka të bëjë pikërisht me të.

Në këtë aspekt, mendoj se jo vetëm premtimi verbal i ministrit, por do të duhej miratuar edhe një projekt detal, ndoshta i një programi të caktuar ekologjik, i cili do t'u kthehej qytetarëve tanë në të mirën e tyre.

Për shembull, nëse Ministria do të na premtonte që me këtë taksë ekologjike do të zvogëlonte eventalisht 1% të lirimit të dyoksid-karbonit në atmosferë, do të na mbushej mendja të gjithëve që ta votojmë. Nëse do të premtonte se eventalisht me këto taksa do të zvogëlohej qarkullimi rrugor i automjeteve private dhe do të stimulohej trafiku kolektiv ose urban, edhe kjo e ka një kuptim. Dhe, nëse s'është ky kuptim, atëherë le të kuptohet që ndoshta Ministria ose Qeveria ka për qëllim që t'i stimulojë udhëtimet jashtë, në mënyrë që të mos ndotet ambienti brenda, apo të ironizoj edhe më tepër, ndoshta mbulimi i shpenzimeve të tepruara në karburant, që sipas raportit të shpenzimeve kanë qenë shumë më të mëdha, ndoshta këto mjete të grumbulluara do të shkojnë në atë destinim, apo dreka zyrtare, udhëtime jashtë e tjera.

Unë mendoj se ky ligj vërtet është me primesa evropiane, por do të duhej edhe projektet tjera mbështetëse të këtij ligji të jenë evropiane, pra jo vetëm taksa, por të jenë të tilla edhe projektet ambientale, të cilat janë kompatible me Bashkimin Evropian. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Nuk kemi më diskutues të paraqitur. Propozuesi, e do fjalën? Jo. Në seancë janë të pranishëm 67 deputetë.

Atëherë, lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim të - Shqyrtimit të parë të Projektligjit për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve dhe votojmë tash.

38 plus 1 - 39 janë për, kundër 23 dhe 8 abstenime, prandaj konstatoj se me shumicë votash, në lexim të parë kalon Projektligji për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve.

Kërkohej nga Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren të Kuvendit, ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raporte me rekomandime.

Tash votojmë për pikën e gjashtë, që e konsumuam më parë si diskutim:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën kontestimore

Edhe deputetët, edhe regjia, le të bëhen gati dhe e votojmë këtë projektligj.

I kemi 65 plus 1 - 66 vota për, asnjë kundër dhe 1 abstenim, dhe konstatoj se me shumicë votash Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën kontestimore.

Kërkohej nga Komisioni Funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregullore të Kuvendit ta shqyrtojë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesë raporte me rekomandime.

Kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raport me rekomandime për shqyrtim.

Ftoj ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, zotin Nenad Rashiq, që ta arsyetojë këtë projektligj. Zoti ministër, e keni fjalën. Para kësaj, një sugjerim deputetëve: dijeni se kemi votim dhe bëhuni pak të arsyeshëm e të disiplinuar, sepse gjithë ditën do të kemi nevojë për votim, prandaj nuk është e nevojshme t'ua tërheq vëmendjen. Urdhëroni, ministër!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Poštovani kolege, kolega ministar,

Poštovani narodni poslanici,

Kao što znate, pravo na štrajk prema međunarodnim konvencijama, jeste jedno zagantovano i nesporno pravo zaposlenih koji putem ove forme sindikalnog pritiska, glavnu težnju imaju zaštitu socijalnih, ekonomskih i profesionalnih interesa.

Na Kosovu, prvi put, pravo za štrajk jeste regulisano sa Zakonom broj 03-ZET-200 o štrajkovima, i cilj donošenja ovog zakona bio je zagantovanje prava i sloboda za zaposlene na Kosovu, u vezi organizovanja i učešća zaposlenih u štrajku.

Ovaj bazični zakon za štrajk usvojen je od strane Skupštine Kosova 22.7.2010. godine i samim tim stupio na snagu u septembru mesecu 2010. godine.

Od strane interesnih grupa i šire javnosti, pomenuti zakon je sproveden bez ikakvih određenih smetnji, a vezano za ovo je i sama Ministarstvo za Rad i Socijalnu Zaštitu dalo svoj doprinos, odnosno donela je podzakonske akte koji su bili neophodni.

Glavni atribut ili glavni razlog za amendatiranje ovog zakona jesu preporuke koje proizilaze iz Izveštaja Progres Evropske Komisije za 2011. godinu, prema kojoj ovaj zakon, koji je na snazi, nije u potpunosti u skladu sa svim međunarodnim standardima, i zato se javila inicijativa da do promene, odnosno do amendamentiranja ovog zakona dođe, i samim tim Ministarstvo za Rad i Socijalnu Zaštitu pokrenulo ovo amandamentiranje.

Glavne promene, odnosno glavni amandmani koji moraju da budu u delu ovog zakona su:

1. Pravo zaposlenih iz sindikalnih organizacija na zakazivanje, odnosno deklarisanje štrajka; zatim
2. Uspostavljanje kvoruma od jedne trećine i tajnog glasanja, kao jedan od uslova za izjašnjavanje ili deklarisanje štrajka od strane sindikalnih i nesindikalnih zaposlenih;
3. Uspostavljanje procedura pomirenja preko posedovanja i arbitraže kao preduslov za zakazivanje štrajka od strane sindikata;
4. Pravo kompenzacije za zaposlene štrajkače koji treba da rade tokom navedenog štrajka, gde treba da se obezbedi minimum procesa rada, i pod šest:
6. Eliminisanje odredbi koja stvaraju suprotnost jedna sa drugom.

Prilikom izrade i razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o štrajku su poštovane procedure za izradu i razmatranje određenog Nacrta zakona sa pravilnikom o radu Vlade Broj 09-2011. Posebno je značajno da se istaknu i javne konsultacije koje su odvijene sa interesnim grupama, odnosno sa socijalnim partnerima.

Ukratko, ovo amandamentiranje će sigurno doprineti boljem zakonu i videli ste i sami da je akcenat stavljen baš na prava radnika, koji će još jednom biti u većoj meri ispoštovana, i samim tim svi radnici koji eventualno mogu biti deo štrajkačkog odbora, ili deo štrajka, sigurno će imati osigurana prava da u jednom momentu, kad prekinu sa štrajkom, vratiti na svoja radna mesta.

Pozivam vas da usvojite zakon, jer jeste stvarno u interesu zaštite radnika. Hvala puno!

KRYESUESI: Falemnderit, zoti ministër! Kryetari i Komisionit Funksional nuk e ka kërkuar fjalën. Atëherë kalojmë me deklaratat e grupeve parlamentare lidhur me këtë projektligj. Për PDK-në flet Kurtan Kajtazi.

KURTAN KAJTAZI: Falemnderit, kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Qëllimi i këtij projektligji është garantimi i lirive dhe i të drejtave për organizime dhe pjesëmarrjen e të punësuarve në grevë sipas ligjeve të aplikueshme dhe standardeve ndërkombëtare.

Ky projektligj është në përputhje të plotë me politikat e Bashkimit Evropian dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë e efikase rregullon fushën e mbrojtjes së të drejtës në punë, rregullimin e marrëdhënieve të punës ndërmjet punëdhënësve dhe punëmarrësit.

E drejta për grevë është e drejtë fundamentale, e drejtë e të punësuarve, e njohur në gjitha vendet e botës. Edhe te ne, në Kosovë, kjo e drejtë është e njohur me Kushtetutën e vendit.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për grevat dhe i rekomandon Kuvendit ta miratojë në parim, ndërsa vërejtjet dhe sugjerimet e deputetëve tanë do të vijnë gjatë amendamentimit në Komisionin Funksional. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Për Grupin e LDK-së, deputeti Bahri Thaçi.

BAHRI THAÇI: Falemnderit, zoti kryesues i Kuvendit!

Duke pasur parasysh se e drejta për organizimin dhe deklarin e grevave është një parim fundamental i të drejtave të punëtorëve në të gjitha vendet e botës, edhe në vendin tonë kjo e drejtë është e garantuar me Kushtetutë dhe me ligje të tjera.

Në Raportin e Progresit është rekomanduar që Ligji për grevat të përafrohet me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, sepse si rezultat i mospërafrimit dhe moskonkretizimit të disa normave juridike që i rregullojnë grevat, në raste të caktuara janë keqpërdorur apo keqinterpretuar kërkesat legjitime të grevistëve, por ka pasur raste edhe kur është keqpërdorur greva apo persona të caktuar kanë përfituar nga kërkesat e grevistëve.

Të nderuar deputetë,

Ne në Kuvend lehtë mund t'i përafrojmë ligjet tona me standardet evropiane e ndërkombëtare, por nuk besoj që Raporti i Progresit kërkon nga ne që vetëm t'i përkthejmë këto ligje, por këto ligje që dalin nga ky Kuvend duhet ta obligojnë Qeverinë tonë t'i implementojë ato.

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat i ka gjithsej 10 nene, me të cilat favorizohen të drejtat e punëtorëve, e për organizimin e grevës nuk nevojitet më pëlqimi i gjysmës së organizatës sindikale, apo i të punësuarve, por vetëm një e treta të anëtarëve të organizatës sindikale, apo e të punësuarve. Gjithashtu, në këtë ligj i jepet rëndësi negociimit nëpërmjet ndërmjetësuesit të licencuar sipas rregullave dhe procedurave të Ligjit për ndërmjetësim.

Duke marrë parasysh se ky projektligj ka për qëllim njohjen dhe garantimin e lirive dhe të drejtave për organizimin dhe pjesëmarrjen e të punësuarve në grevë sipas ligjeve të aplikueshme dhe standardeve evropiane, ky projektligj nuk i cenon pastaj parimet themelore të legjislacionit të BE-së, është i përballueshëm dhe nuk pritet të ketë pengesa buxhetore gjatë zbatimit.

Andaj, Grupi Parlamentar i LDK-së, e përkrah këtë projektligj në parim, ndërsa vërejtjet dhe sugjerimet e veta do t'i japë në komisionin përkatës. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit, zoti deputet! Për Grupin e “Vetëvendosjes”, deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Projektligjin për plotësim-ndryshimin e Ligjit për grevat, Lëvizja “Vetëvendosje” do ta votojë.

E përkrahim, pasi konsiderojmë se ligjin ekzistues e përmirëson në shumë pika, e posaçërisht në aspektin që tani është 1/3 e punëtorëve që me këto ndryshime, në kuadër të një ndërmarrjeje, apo 1/3 e anëtarëve të sindikatës, mund të vendosin për një grevë, për dallim, siç ka qenë deri tash, gjysma, me ligjin ekzistues.

Ky, pra, është një përparim dhe është përmirësim i këtij ligji. Vërejtja qëndron në nenin 5, ku shtjellohet neni 9, pikërisht te procedurat e ndërmjetësimit dhe pajtimit, e cila nuk është vërejtje kështu substanciale, por kjo gjë do të duhej të shtjellohej mirë, sepse pikërisht te procedurat e ndërmjetësimit dhe të pajtimit, thuhet: “Ato duhet të jenë të përshtatshme, të jenë të shpejta”, ato duhet të definohen më qartë, sepse është kjo pikë, e cila mund të keqpërdoret pastaj që një grevë të shpallet e paligjshme. Pra, kur punëtorët futen në grevë, greva e tyre shpallet e paligjshme, duke ua kontestuar çështjen e pajtimit dhe ndërmjetësimit që ata do të duhej ta bënin para grevës.

Natyrisht se do të duhej që para se të ndërmerrej një grevë, punëtorët t’i deklarojnë kërkesat e tyre dhe të bëjnë përpjekje e t’i shterin mjetet që ato kërkesa të zgjidhen pa grevë, por kur ato mjete shteren, atëherë nuk mbetet rrugë tjetër, përpos grevës. Dhe, kufiri ndërmjet procedurës së ndërmjetësimit dhe ndërhyrjes a marrjes pjesë në grevë, do të duhej të jetë i definuar më qartë.

Kjo është edhe te çështja e arbitrazhit, ngjashëm, pra ku përcaktohet minimumi i punës që duhet të kryhet për ndërmarrje, të cilat kanë rëndësi jetike, për shërbimet të cilat kanë rëndësi jetike, është edhe procesi i procedurave të arbitrazhit, ku definohet minimumi i procedurës, i asaj punës që konsiderohet jetike edhe ajo duhet të jetë e definuar më qartë.

KRYESUESI: Falemnderit! Për Grupin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Falemnderit, zoti nënkryetar!

Qëllim i këtij projektligji është garantimi i lirive dhe të drejtave lidhur me organizimin dhe pjesëmarrjen e të punësuarve në Kosovë, në grevë, sipas standardeve ndërkombëtare.

Projektligji në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe efikase e rregullon fushën e mbrojtjes së të drejtës së punës, rregullimi i drejtpërdrejtë i marrëdhënieve të punës ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit. Meqenëse projektligji është plotësim-ndryshim, me këtë projektligj tash është bërë përafrimi i Ligjit të grevave ndërmjet standardeve evropiane dhe ndërkombëtare, përkatësisht me Kartën Evropiane.

Përputhshmëria e përgjithshme me legjislacionin e BE-së, të drejtat e të punësuarve dhe organizatave sindikale për grevë, e drejta e kompensimit për të punësuarit grevistë, të cilët duhet të punojnë gjatë grevave, eliminimi i dispozitave, të cilat krijojnë kundërshtime me njëra-tjetrën.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe do ta përkrahë në parim. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Për Koalicionin Kosova e Re, Suzan Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Falemnderit, kryesues!

Edhe Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat.

KRYESUESI: Falemnderit! Në të gjitha format, thirrni deputetët të hyjnë brenda, sepse i kemi edhe dy diskutues të fundit, prandaj do të votojmë.

Për Grupin SLS, fjalën e ka deputeti Boban Todoroviq.

BOBAN TODOROVIC: Zahvaljujem, gospodine predsedavajući!

I naša Parlamentarna Grupa je razmatrala ovaj Nacrt zakona. Smatramo izuzetno važnim ove dopune, i glasaćemo za isti ovaj zakon. Hvala!

KRYESUESI: Falemnderit! Për Grupin 6+, deputetja Duda Balje.

DUDA BALJE: Hvala vam!

I Parlamentarna Grupa 6+ glasaće za ovaj nacrt zakona i svoj doprinos daće kroz rad u kompetentnoj komisiji. Hvala!

KRYESUESI: Falemnderit! Fjalën e ka deputetja Salihe Mustafa.

SALIHE MUSTAFA: Falemnderit, kryesues!

E nderuar zëvendëskryeministre,

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Konsideroj se Ligji për grevat duhet të plotësohet dhe ndryshohet kur dihet se e drejta për grevë është e drejtë fundamentale e të punësuarve. Gjithashtu, edhe në Raportin e Progresit është rekomanduar që ky akt ligjor të përafrohet me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

Risi në këtë projektligj është vendosja e procedurave të pajtimit nëpërmjet ndërmjetësuesit të licencuar, si parakusht për deklarimin e grevës nga sindikatat, risi kjo e adresuar në nenin 4, paragrafi 1.4. të këtij projektligji.

Në situatën kur palët pajtohen për ndërmjetësim, mendoj se duhet të saktësohet se në cilat raste dhe situata mund të kyçet ndërmjetësuesi, ngase në nenin 7 të Ligjit për grevat, arsyet e mbajtjes së grevës, vetëm në dy situata, si në pikën 1.3 dhe pikën 1.4, ka arsye për ndërmjetësim. Në pikat tjera, ku situatat janë të rregulluara me ligj, nuk do të duhej të kërkohej ndërmjetësimi nga asnjëra palë.

Në rast se lihet mundësia që Komisioni i Ndërmjetësimit ta ketë të drejtën të ndërhyjë në çdo situatë, edhe atëherë kur çështjet janë të rregulluara mirë me ligj, mendoj se ligjet do të viheshin në provë.

Neni 6, paragrafi 3 i Projektligjit, i cili është propozuar që t'i shtohet nenit 13, mendoj se në masë të caktuar e vë në dyshim pikën 1 të nenit 13, ngase thuhet se punëtorët kanë të drejtë në pagë dhe përsëritet neni 13.1, por nuk saktësohet se për cilën pagë bëhet fjalë, për pagën e rregullt, për pagën e punës shtesë apo pagën e kujdestarisë.

Gjithashtu mendoj se neni 17 paragrafi 2, nënparagrafi 2.2 i ligjit në fuqi, në këtë situatë do të duhej të saktësoheshin nivelet e shërbimeve emergjente, ndërsa në shëndetësi do të duhej të jetë: “Shërbimet emergjente në të tri nivelet e kujdesit shëndetësor”. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Nuk kemi më deputetë të paraqitur për diskutim.

Të pranishëm momentalisht janë 62 deputetë.

I thërras deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim dhe votojmë tash:

Me 61 votë për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat.

Kërkohej nga Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregullore të Kuvendit ta shqyrtojnë këtë projektligj dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Kolegë të nderuar, tash do të kemi pushim dreke, deri në orën 15,00. Falemnderit!

(Pas pauze, seanca e vazhdoi punën)

(Seancën e drejton kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi)

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Për shkak se nuk kemi kuorum, do të vazhdojmë me pikën e trembëdhjetë, për të cilën kërkohet një lloj debati.

13. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2011

Raportin vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2011 e ka shqyrtuar Komisioni FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe ia ka paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime, për shqyrtim dhe miratim.

Po ashtu, edhe Komisioni për Buxhet e Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2011 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Kryetari i Komisionit Funkcional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, deputeti Ahmet Isufi do ta arsyetojë raportin me rekomandime.

Deputet, e keni fjalën.

AHMET ISUFI : Falemnderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 4.5.2012, e ka shqyrtuar Raportin e vitit 2011 të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe ka vlerësuar se raporti i punës është në pajtim me ligjin 0.3/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale dhe i rekomandon Kuvendit që ta miratojë.

Megjithatë, gjatë shqyrtimit, Komisioni ka bërë vërejtje rreth jofunksionalizimit të agjencisë, sidomos në transferet e disa zyrtarëve nga institucionet tjera, pastaj shfrytëzimi i objektit me qira që edhe më tutje është në formën e tillë, të cilat në të ardhmen duhet të zgjidhen.

Komisioni kërkon nga deputetët që ta përkrahin aprovimin e këtij raporti, meqë kemi të bëjmë me një agjenci që ende nuk i ka plotësuar të gjitha kushtet që të mund të funksionojë ashtu si duhet, por që në të ardhmen këto rekomandime, të cilat i jep komisioni, duhet të përmbushen. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Deputeti Fatmir Xhelili e ka fjalën.

FATMIR XHELILI: Falemnderit, kryetar!

Përshëndetje,

Përshëndetje për ministrin,

Përshëndetje për deputetët e Kuvendit,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar raportin në fjalë dhe duke e marrë parasysh afatin e shkurtër kohor të themelimit të kësaj agjencie, e ka pasur parasysh se nuk kanë mund të arrijnë rezultate të dukshme dhe që ato të reflektojnë me një punë shumë pozitive, mirëpo janë në drejtim të duhur dhe të mirë për ta strukturuar një agjenci serioze dhe agjenci që i përmbush obligimet ligjore të dala nga ligji në fjalë.

Normalisht se janë identifikuar edhe disa të meta, të cilat i kemi paraqitur në rekomandime dhe vërejtja kryesore është vazhdimi i kontraktimit të ndërtesave apo objekteve private për punë të institucioneve shtetërore, për ç'gjë është marrë edhe një vendim i mëhershëm i Qeverisë që të mos kontraktohen objekte private për të shpenzuar financa prej Buxhetit të Kosovës për qira, kur e dimë se në shumë institucione ka objekte të lira, qoftë të ish-TMK-së, qoftë objekte tjera, dhe me kujdes dhe përkujdesje të Ministrisë së Administratës këta kishin mundur ta gjejnë një objekt që ta ushtrojnë funksionin e tyre, andaj kjo është edhe vërejtja kryesore që e paraqesim si njërin nga rekomandimet e grupit tonë parlamentar dhe i propozojmë Kuvendit që ta miratojë këtë raport, duke i marrë për bazë agjencia rekomandimet në fjalë. Ju falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit, deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka deputetja Vjollca Krasniqi.

VJOLLCA KRASNIQI: Falemnderit kryetar!

Të nderuar deputetë,

Materialin, të cilin e ka dërguar Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është një material bukur i gjerë, por më së paku i ngjason një raporti.

Gati i tërë materiali është një përshkrim i misionit, i detyrave, i vizionit, sfidave me të cilat përballlet me aktivitetet që i planifikon t'i ketë kjo agjenci. Pra, shumëçka është planifikuar të bëhet në të ardhmen.

Meqenëse e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale si pjesë e privatësisë është e drejtë themelore në kuadër të të drejtave të njeriut, por si e tillë institucionet tona janë pak apo fare të njohura me këtë të drejtë se si do të duhej të bëhej një gjë e tillë, e aq më pak janë të njohur qytetarët.

Mbrojtja e të dhënave personale ka rëndësi të posaçme për Republikën e Kosovës drejt synimeve për integritet evropian. Andaj, edhe Raporti i Progresit për Kosovën, për vitin 2011, ka evidentuar mangësi në këtë segment. Po citoj: “Vetëdijesimi i mbrojtjes së të dhënave mbetet shumë i ulët. Kapacitetet nga të gjitha institucionet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave kanë vazhduar të jenë shumë të kufizuara. Në përgjithësi, mungesa e mbrojtjes së të dhënave personale mbetet një çështje brengosëse. Kosova duhet të bëjë përpjekje më të mëdha në këtë fushë.

Sa i përket personelit, ashtu siç thanë edhe parafolësit, ajo ka transferuar disa zyrtarë nga institucionet tjera dhe kjo ka filluar të bëhet edhe si një dukuri.

Edhe pse ky organizëm ka obligim të japë këshilla e opinione, deri më tani e ka dhënë vetëm një këshillë dhe një opinion.

Sa u përket ankesave, nuk ka asnjë ankesë në adresë të agjencisë, e kjo dëshmon se qytetarët nuk dinë gjë për ekzistimin e kësaj agjencie, e aq më pak dinë për këtë të drejtë të tyre.

Në bashkëpunimin ndërkombëtar kishin qenë paksa më të suksesshëm, sepse për një periudhë të shkurtër kohore kanë bërë një numër të madh vizitash, si në Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi, Slloveni, Belgjikë. Janë vizituar ambasadat e Republikës së Kosovës në Tiranë, Bruksel, Bernë, në Lubjanë dhe Shkup.

Sa i përket caktimit të zyrtarit mbrojtës, agjencia nuk jep informacione se sa institucione e kanë caktuar zyrtarin mbrojtës, gjë që është obligim ligjor dhe raporti do të duhej ta përmbante një informatë të tillë. Agjencia nuk e ka shpenzuar buxhetin, e kjo tregon se planifikimi nuk është bërë në mënyrë të duhur. Dhe ajo që është më kryesore, është se kjo agjenci paguan mjete për ta shfrytëzuar hapësirën për punë në një objekt privat me qira.

Ky nuk është problem vetëm i agjencisë, por edhe i shumë institucioneve tjera, të cilat i shfrytëzojnë hapësirat private me qira.

Do të doja të rikujtoja, edhe pse **kryeministri** nuk është këtu, por ndoshta do t'ia përcjellë dikush këtë, se në fushatën e tij parazgjedhore ka premtuar se institucioneve qeveritare do t'u mundësohet shfrytëzimi i hapësirave qeveritare, por një gjë e tillë nuk po ndodh as sot.

I nderuar kryetar,

Me miliona euro të taksapaguesve, do të thotë të qytetarëve tanë, shkojnë për objekte private me qira. Dhe, siç e tha edhe kolegu nga Partia Demokratike, është një vendim i vitit 2008, me të cilin kryeministri e autorizon Ministrinë e atëhershme të Shërbimeve Publike, e tash e Administratës Publike, që të gjitha institucionet qeveritare t'i akomodojë në objekte qeveritare. Por, një gjë e tillë nuk po ndodh.

Ky raport, në përgjithësi, nuk është i përpiluar ashtu si duhet, por ne si Grup Parlamentar do ta miratojmë dhe do ta japim votën për, me arsyen e vetme sepse është një agjenci e formuar shumë vonë dhe besojmë se në një të ardhme do të funksionalizohet në tërësi. Ju falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Falemnderit, zoti kryetar!

Çështjen e objektit të vendosjes së këtij institucioni në një objekt me qira ne e konsiderojmë problem shumë të madh se sa thjesht pagesa e qerasë dhe shpenzimi i Buxhetit të Kosovës në mënyrë të paarsyeshme.

Këtu bëhet fjalë për një institucion që do të duhej t'i mbronte të dhënat personale, që do të thotë se niveli i sigurisë në këtë institucion duhet të jetë shumë i lartë.

Vendosja e një institucioni të tillë në objekte me qira dhe objekte private do të thotë që nuk plotësohen kushtet minimale të sigurisë.

Çështja tjetër është problemi të cilin e shtruan parafolësit, harxhimi i buxhetit në mënyrë krejtësisht të paarsyeshme për institucione, mbase sepse dikush në një moment të caktuar ka pasur lidhje për të marrë objekte të tilla me qira. Dikujt i kanë shkuar paratë në xhep. Kjo është logjikë krejtësisht joshetformuese. Të dyja janë logjikë shtetformuese, edhe vendosja e institucionit në objekt privat, por edhe keqmenaxhimi ose keqpërdorimi i Buxhetit të Kosovës. Ne gjykojmë se as puna e institucionit, pavarësisht se është i ri, e as raporti dhe mënyra e raportimit nuk janë në rregull, nuk janë ashtu sikurse duhet dhe nuk kemi arsye për ta votuar këtë raport. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Nga AAK-ja, kush e kërkon fjalën? Kryetari i Komisionit, Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Atë që e thashë në emër të Komisionit, vlen edhe në emër të Grupit. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja e Grupit, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Falemnderit, kryetar!

Duke marrë parasysh përvojën e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili nuk ka jetëgjatësi shumë të madhe, mund të themi se raporti i tyre e përshkruan një punë, e cila duhet të bëhet, edhe pse në bazë të ligjit kjo agjenci është shumë e rëndësishme, atëherë mbetet që ne si Kuvend, meqë vetë i kemi përzgjedhur këta njerëz që të punojnë në Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, t'u ndihmojmë në punët e tyre, të cilat i kërkojnë në bazë të ligjit.

Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah Raportin vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe kërkon nga ta që të shkojnë viza-vijë me ligjin, i cili ua jep mundësitë e tyre. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të SLS-së, e do dikush fjalën? Jo. Në emër të 6+? Jo. Atëherë fjalën e ka kryetarja e Komisionit për Buxhet e Financa, deputetja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Falemnderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Komisioni për Buxhet e Financa, në mbledhjen që e ka mbajtur më 18 prill, e ka shqyrtuar Raportin vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2011 dhe ka vlerësuar se i njëjti i përmbush obligimet ligjore për raportim, që dalin nga neni 46 i Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi dhe plotësim-ndryshimet e të njëjtit ligj.

Kjo agjenci e ka filluar punën në gjysmën e dytë të vitit 2011, kurse buxheti prej 185.502 euro është miratuar më 29.8.2011. Domethënë kanë pasur kohë vetëm 2 muaj ta shfrytëzojnë buxhetin.

Këtu u diskutua shumë rreth shpenzimeve të bëra për qira, por nëse i marrim dhe i analizojmë shpenzimet e kësaj agjencie me të agjencive tjera, shpenzimet e kësaj agjencie për qira janë dukshëm më të vogla. Mirëpo, Komisioni për Buxhet e Financa, si në këtë raport, po ashtu edhe në çdo raport financiar ka qenë kritik ndaj pagesës së qirasë, nga pamundësia e zgjidhjes së problemit të vendosjes së këtyre institucioneve.

Në raportin e shpenzimeve për vitin 2011 të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale janë pasqyruar shpenzimet për të gjitha kategoritë ekonomike në mënyrë të përmbledhur dhe të detajuar. Nga raporti vërehet se janë shpenzuar 134.456 euro, që do të thotë se është shpenzuar 72.48% e buxhetit, i cili i është ndarë këtij institucioni.

Për paga dhe mëditje, buxheti është realizuar 78%, kurse për mallra dhe shpenzime 94%, ndërsa shpenzimet komunale e kanë pasur një realizim të shpenzimeve komunale 49%.

Pas diskutimeve të cilat janë bërë në komision, ku ka qenë edhe përfaqësuesi - udhëheqësi i kësaj agjencie, Komisioni njëzëri e ka miratuar raportin dhe i ka rekomanduar Kuvendit që ta miratojë raportin financiar të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2011, sepse ka vlerësuar se i njëjti raport i ka përmbushur obligimet që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike.

KRYETARI: Falemnderit! Fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Falemnderit, zoti kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar këtë raport, i ka dhënë vërejtjet e veta, ashtu sikur edhe thanë para folësit e mi, por sidoqoftë ne i mbështetim rekomandimet e Komisionit, e po ashtu edhe vërejtjet e Komisionit. Ashtu siç kanë vërejtje deputetët, edhe Komisioni ka pasur vërejtje rreth raportit, rreth shumë gjërave, gjë që lë për të dëshiruar dhe për të ndryshuar, por sidoqoftë ne e mbështetim raportin me rekomandimin e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Fjalën e ka deputetja Salihe Mustafa.

SALIHE MUSTAFA: Falemnderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Konsideroj se është një raport i mirë dhe është punuar mjaft mirë, duke pasur parasysh periudhën e shkurtër të punës së kësaj agjencie.

Duke pasur parasysh kohën e shkurtër të konsolidimit, si dhe vonesat në ndarjen e buxhetit, konsideroj se agjencia për këtë periudhë ka treguar dinamizëm, e sidomos në bashkëpunimin ndërkombëtar.

Në këtë raport ceket se janë kryer 4 inspektime të operatorëve të telefonisë mobile, të cilat janë realizuar pas shqetësimeve të paraqitura në Raportin e Progresit të vitit 2011, inspektime këto që kanë rezultuar me urdhërimin e operatorëve mobilë për eliminimin e parregullsive që janë gjetur.

Është për t'u vlerësuar koha e shkurtër e reagimit të agjencisë në verifikimin e këtyre shqetësimeve. E inkurajojmë atë që në këtë vit ta rrisë numrin e inspektimeve, në mënyrë që qytetarët e Republikës së Kosovës ta rritin nivelin e besimit që të dhënat e tyre të përpunohen dhe mbrohen sipas ligjit.

Gjithashtu dihet se sipas ligjit për mbrojtje të dhënave personale, çdo person i cili konsideron se i është shkelur e drejta në privatësi, në kuptim të të dhënave personale, mund të parashtojë ankesë në këtë agjenci.

Fatkeqësisht, deri më tani ka pak njohuri për funksionimin e kësaj agjencie. Mendoj se ajo duhet t'i kushtojë shumë rëndësi njoftimit të opinionit me punën e saj, si dhe

promovimi të të drejtave themelore për mbrojtjen e të dhënave personale nëpërmjet mediave elektronike.

Duke pasur parasysh që e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale u garantohet me Kushtetutë qytetarëve të Republikës së Kosovës, kërkoj nga agjencia ta shpejtojë konsolidimin, në mënyrë që edhe përkundër zhvillimit të hovshëm të teknologjisë dhe mundësisë më të lehtë të abuzimit me të dhënat personale, të arrijë që privatësia e tyre në kuptimin e të dhënave personale të mbrohet me ligj. Ju falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Nuk kemi të lajmëruar për diskutim. Shkojmë në votim. Të pranishëm janë 64 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Pa kartela? Vetëm 1.
Kundër? Nuk ka. Falemnderit!

Me 58 vota për, asnjë kundër dhe 1 abstenim, Kuvendi e miratoi Raportin vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2011, me rekomandimet e Komisionit Funkcional.
I kthehem pikës së dhjetë të rendit të ditës:

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Teatrot

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Teatrot dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale e Media, deputetin Idriz Vehapi që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

IDRIZ VEHAPI: Falemnderit, zoti kryetar!
Të nderuar deputetë,
Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin për Teatrot, ka bërë amendamentimin e tij, e pastaj edhe komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar atë me amendamentet e propozuara. Tri komisionet nuk kanë pasur vërejtje në projektligj, përveç Komisioni për Financa, i cili ka dhënë vërejtje në amendamentin 15.

Projektligji i ka gjithsej 22 amendamente. 4 amendamente janë pa përkrahje të Komisionit Funkcional, përkatësisht amendamenti 2, 3, 5 dhe 13. Ndërkaq në amendamentin 15, Komisioni për Buxhet e Financa ka dhënë vërejtje.

Njëkohësisht duhet të bëjmë me dije edhe një herë se ky projektligj ka qenë në rend dite edhe në seancën e kaluar.

Shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së ka kërkuar që projektligji të shtyhet për një seancë tjetër dhe ne në komision jemi marrë vesh që amendamentet eventuale që vijnë nga Grupi

i LDK-së të paraqiten sot dhe deputetët të vendosin për miratimin ose jo të tyre. Falemnderit shumë!

KRYETARI: Prania e deputetëve? Në sallë i kemi 60 deputetë. I paralajmërova se po hyjmë në procedurën e votimit, prandaj nuk është mirë të dalin jashtë. Ju lutem!

(Ndërhyrje-reagim...)

Ligjet nuk janë vetëm të opozitës! Kuvendi si institucion përbëhet prej pozitës dhe opozitës!

Mirë, të pranishëm tani janë 61 deputetë, prandaj vazhdojmë.

Amendamenti 1

A ka kundër?

Abstenim? Nuk ka. Miratohet amendamenti.

Amendamenti 2

Propozim i Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Me votim elektronik, do të thotë e votojmë amendamentin 2, i propozuar nga Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tash:

(Ndërhyrje)

Mirë, por ne hymë në procedurën e votimit. Fjalën e ka Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Falemnderit, kryetar!

Po e marr fjalën një herë, për të mos e marrë te amendamentet tjera.

Po flitet për teatrot në numrin shumë. Unë këtu dua t'u sugjeroj deputetëve, para së gjithash, që të kenë kujdes, sidomos kur lexohen projektligjet në leximin e parë dhe të mos bëjnë plagjiaturë të amendamenteve.

Flitet për Teatrin e Gjakovës. Gjakova e ka një traditë mbi 35-vjeçare, dhe jo vetëm që meriton t'i kthehet statusi që e ka pasur, sepse me të është krenuar Gjakova, krenohet edhe Kosova, por në këtë rast, kryetar, është bërë plagjiaturë e amendamenteve të propozuara nga ne.

Prandaj, u sugjeroj deputetëve që të paktën t'i lexojnë transkriptet kur lexohen në leximin e parë dhe të mos bëjnë plagjiaturë. Kjo nuk është në rregull, sepse nuk i bëjnë nder as Kuvendit, as vetvetes. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Për LDK-në, fjalën e ka deputeti Salih Morina.

SALIH MORINA: Falemnderit, kryetar!

Te çështja e teatrove kombëtare, që janë përmendur në shumës, do të thotë me plot të drejtë ndërhyri edhe kolegja deputete dhe këtu duhet të sqarohet nga komisioni, sepse ne nuk mund t'i kemi 6-7 teatro kombëtare.

Është fjala për një teatër kombëtar në nivel qendror, ndërsa teatrot e niveleve regjionale, të cilët me vendim të ministrit kanë qenë teatro profesionale, tash janë shndërruar në teatro të qytetit... Do të thotë, ne duhet të fiksohemi dhe nuk jam kundër asaj që edhe qyteti i Gjakovës ta ketë një teatër kombëtar, i Pejës, i Prizrenit apo edhe i regjioneve tjera, por ne duhet të dimë qartë se kemi të bëjmë me një teatër kombëtar në nivel qendror.

Ndërsa, atje ku përmendet më poshtë, te neni 5, ku thotë “kemi të bëjmë me teatrot kombëtare”, ne duhet ta fiksojmë se kemi të bëjmë me një teatër kombëtar në nivel qendror, ndërsa teatrot në nivel regjional mund të jenë ose profesionistë ose teatro të qytetit.

Prandaj, kjo është edhe ngarkesë buxhetore, dhe njëkohësisht po t'i shikojmë vendet e nivelit të regjioneve që i kemi përreth, kanë të bëjnë vetëm me teatër kombëtar dhe kanë të bëjnë me teatro profesionale dhe teatro të qytetit.

KRYETARI: Falemnderit! Kryetar i Komisionit, a je dakord me këtë që u tha? Regjia, fjalën deputetit Idriz Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: Sqarimet janë se amendamentet që nuk e kanë përkrahjen e komisionit d.m.th. nuk e kanë përkrahjen e komisionit dhe deputeti le ta lexojë mirë amendamentin dhe e ka përgjigjen aty.

KRYETARI: Nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti, e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Unë, për shkak të etikës së punës në Parlament, do t'i them dy-tri fjalë.

Nuk ka nevojë të krijohen replika pa kurrfarë nevojë, kinse si pozicionime partiake për probleme. Duhet të këqyret esenca. Këtu kemi të bëjmë me një ligj, i cili, jo fort moti, është aprovuar në Kuvend, është rimarrë dhe tash ka edhe variacione.

Nuk është me rëndësi këtu kush i ka propozuar, por me rëndësi është a janë logjike, a janë të domosdoshme dhe a janë në rregull, pa marrë parasysh se cili grup bën propozime, cili s'bën.

Herën tjetër, LDK-ja ka kërkuar shtyrjen e afatit dhe kryetari i komisionit e di. Jo se do të bëjë amendamente, por sepse shoqëria civile dhe njerëzit e profesionit, nëse ju s'ju ka ardhur, ka deputetë që u ka ardhur një ligj alternativ, totalisht i ndërtuar nga njerëzit e profesionit, dhe i keni nëpër kutia, ose nëpër postën elektronike.

Problemi ka qenë që nëse njerëzit e profesionit kanë kaq shumë çështje të thonë rreth këtij ligji për teatrin, sa kanë provuar të bëjnë edhe alternativë, gjë që është shumë mirë, do të thosha unë. Atëherë është menduar që është mirë të merret e të studiohet ky.

Pra, ky ka qenë qëndrimi. Nuk ka qenë që ka dalë, se dihet çka është thënë, është e shënuar. Le të mendohet edhe një herë se ka zgjidhje. Dhe, ato zgjidhje janë krejt në dy pika dhe i dini ju krejt çfarë janë: Problemi i drejtorit menaxhues dhe i drejtorit artistik.

Sepse, ky është problem që është shtruar tërë kohën dhe ndeshja e madhe e artistëve të teatrit, po e quaj me regjisorë, me dramaturgë, me aktorë, është se ata gjithherë mendojnë se drejtori i përgjithshëm i teatrove ose i Teatrit Nacional duhet të jetë menaxher i mirë, por nuk duhet të jetë udhëheqës artistik. Dhe, ata mendojnë, edhe sot, me alternativat e tyre, që drejtori artistik duhet të jetë profesionist. Këtu është problemi, faktikisht, themelor.

Tjetër gjë është se ato janë ide. Ne tash e kemi një tekst përpara dhe po flasim për të. Unë pajtohem që duhet të diskutojmë konkretisht tash për ato që janë propozuar, e s'janë propozuar.

Sa i përket asaj që e tha zoti Morina, është e vërtetë se te ne është modë të thuhet kombëtare për diçka. Nuk është puna kombëtare në nivel, mjafton profesionale. Ne kemi qejf edhe na e ka ëndja, edhe e ruajmë një teatër kombëtar themelor, që i bie, a më i madhi, i vetmi. Se me këtë ligj, në shumës nuk thuhet teatro kombëtare, se s'ka pse. Dikur i është thënë popullor, por popullor në kuptimin e nivelit profesional. Mund të thuhet, ekziston një teatër nacional ose kombëtar, dhe teatrot profesionale. Por, kjo duhet të precizohet, sepse këto në propozim-ligjin dhe të komisionit nuk ekzistojnë, por i keni si variante të propozuara nga një grup parlamentar, me të cilin unë, sa e mora vesh, pajtohet. Pra, sa mora vesh unë, pajtohet deputeti i Aleancës, veç se thotë na e kanë marrë idenë.

(Ndërhyrje)

Po, ti s'e the. Ti pajtohesh, domethënë, por ti mendon se ju e keni shpikur e këta e kanë marrë. Falemnderit!

(Ndërrprerje e incizimit)

KRYETARI: ...E keni me e marrë fjalën, mos u ngutni. Kryetari i Komisionit, deputeti Idriz Vehapi e ka fjalën.

(Reagim)

Atëherë, deputetja Teuta Haxhiu, për replikë.

TEUTA HAXHIU: Falemnderit, kryetar!

Edhe një herë kërkoj falje, nuk është kjo në karakterin tim. Fjala shpikje, nuk e ka shpikur askush. Teatri i Gjakovës ka kërkuar dhe po kërkon t'i kthehet statusi. Por, në këtë rast, nuk guxoj të them është shpikur prej një subjekti politik.

Edhe një herë thashë, nuk është në nderin e Kuvendit, e as të deputetëve të bëhet plagjiaturë. Unë u sugjeroj deputetëve t'i lexojnë transkriptet. Janë bërë propozimet, megjithatë nuk është në rregull. Kjo le të mbetet si është. Është bërë plagjiaturë. Unë, gjithsesi, jo vetëm që jam për t'iu kthyer statusi Teatrit të Gjakovës, sepse këtë e meriton, të gjithë duhet të jemi për këtë. Por, edhe një herë po them, të mos përsëritet kjo përvojë, se me të vërtetë, jo vetëm se më ka fyer mua, por vërtetë të gjithë deputetët duhet t'i fyejë.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Salih Morina, për replikë!

SALIH MORINA: Mos ma merrni si replikë, por dua të sqaroj pak a shumë çështjen, pasi unë vetë kam punuar në Ministrinë e Kulturës dhe në vitin 2009, me kërkesën e kryetarëve të komunave, po flas të komunave të regjioneve më të mëdha, këto teatro e kanë pasur emërtimin - teatrot profesionale.

Kërkesa e tyre ka qenë që këto teatro t'i bartin në pronësinë e komunave. Me vendim të Qeverisë, kjo situatë ka ndodhur dhe të gjitha teatrot profesionale janë bartur në teatro të komunave, që tash quhen teatro të qyteteve. Do të thotë, ka qenë kërkesë e tyre.

Mirëpo, unë mendoj se ajo që ka ndodhur, me kërkesën e tyre, qëllimi ka qenë sa për ta zgjedhur vetëm drejtorin. Ndërsa, në aspektin buxhetor komunat kanë pasur vështirësi t'i përballojnë aktivitetet e ndryshme, që do t'i zhvillojnë këto teatro. Prandaj, tash duhet të mendojmë, ngase këtu nuk bëhet fjalë për teatro kombëtare, emërtim që duhet ta ketë Teatri i Gjakovës, i Pejës, i Gjilanit apo i Prizrenit. Këtu kemi të bëjmë me një teatër kombëtar në nivel nacional dhe këto tjerat i emërtojmë, ose teatro profesionale, ose i emërtojmë teatro të qyteteve. Domethënë, ky është qëllimi.

KRYETARI: Falemnderit! Tani e ka fjalën kryetari i Komisionit.

IDRIZ VEHAPI: Falemnderit, zoti kryetar!

Unë vetëm desha të sqarohem me deputetin Hamiti. Zoti deputet, kërkesa e Grupit Parlamentar, përkatësisht e shefit të Grupit Parlamentar të LDK-së ka qenë që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një seancë tjetër dhe kjo është bërë. Pastaj, i njëjti shef i Grupit Parlamentar ka biseduar me mua dhe ka thënë se deputetët nga LDK-ja që janë në komision...

(Reagim)

...Po unë po flas për diçka që është realitet, e ti dil kur të kesh qejf. Nuk është me rëndësi ajo. Unë vetëm po sqaroj dhe s'po të bërtas. Askujt s'i bërtas. Po, ta kryej unë fjalën, e pastaj ti fol.

Dhe, ka qenë komunikimi që deputetët e LDK-së që janë në komision i kanë disa propozime lidhur me disa nene të projektligjit. Ne kemi biseduar në komision dhe jemi marrë vesh që ato propozime të rrjedhin në seancën e radhës, dhe kështu ka qenë.

Prandaj, unë e elaborova këtë çështje ashtu siç jemi marrë vesh në komision me deputetët e Grupit të LDK-së, por njëkohësisht me pëlqimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të LDK-së. Kështu ka qenë muhabeti, edhe unë për hir të opinionit dhe të deputetëve këtë e sqarova.

Dhe, fjala në shumës - për teatrot, me këtë është lënë mundësia që të themelohen edhe teatro tjera dhe ta marrin statusin kombëtar. Ky është amendamenti 1, neni 4, në të cilin thuhet “themelimi i teatrove” dhe është bërë një ridefinim i krejt nenit, me të cilin parashihet edhe themelimi i teatrove tjera kombëtare, duke përfshirë edhe të Gjakovës dhe të ndonjë tjetër. Falemnderit!

KRYETARI: Sabri Hamiti, replikë! Veç, shpeshherë, në vend të sqarimit, po e ndërlikoni dhe absolutisht asgjë nuk po sqaroni.

SABRI HAMITI: Zotni deputet,
Zotni kryetar i Komisionit,

Unë nuk dal kurrë veç për ta thënë një fjalë, qoftë edhe kur kam të bëj me ty, ose me një grup parlamentar, ose me një kuvend, aq më tepër, të interpretoj mendimet e një deputeti, qoftë edhe kryetar i grupit tim parlamentar.

Unë po të them ty, zotëri, se ekziston një ligj alternativ. E shoh këtë dhe unë besoj se e ke ti në dorë, e aq më tepër edhe zoti Beqiri, nëse ka dashur të hyjë në lojë, është dashur ta ketë. Unë e kam. Dhe e kam lexuar.

Domethënë, e kemi një tekst alternativ në Kuvend. Shumë rrallë ka ndodhur kjo. Mbajeni mend këtë! Për një lëmi, të cilën e kanë hartuar dhe na e kanë ofruar si propozim këta njerëz: Jeton Neziraj, dramaturg, ish-drejtor i Teatrit Kombëtar të Kosovës; Arian Krasniqi, dramaturg, ish-drejtor i përgjithshëm, e të tjerë, që është një ide për t’u respektuar.

Unë mendoj se ky Kuvend për një lëmi nuk ka pse të mërzhitet për ta trajtuar këtë. Kjo ishte ajo çka thashë unë. Nëse nuk është trajtuar, është tjetër punë.

Unë as që jam në atë komision, por unë jam deputet dhe kam dëshirë të hedh para Kuvendit diçka të vlefshme. Nuk po them se duhet të votohet kjo, por loja ka qenë të shqyrtohen të gjitha mundësitë. Dhe, këtu unë s’di çka të sqarohet tjetër gjë.

Ndërsa, sa u përket emërtimeve, ato duhet të precizohen, sepse me të vërtetë, e di që është punë perceptimi. Dikush mendon se është teatër profesional dhe duhet patjetër t’i thuhet kombëtar. Kjo nuk është e thënë. Ajo është konventë si vendos ta quash një teatër. Kaq.

KRYETARI: Falemnderit! Jo, ju lutem, asnjë minutë. Dhe, dëgjoni, bëhuni më i disiplinuar, sepse në emër të sqarimit nuk po sqaroni bash kurgjë.

(Reagim)

Jo, ju lutem! Nuk kemi ne ligj alternativ. Ligjet alternative vijnë me 10 ose 15 mijë nënshkrime. E kemi një ligj të amendamentuar. Deputetja Myzejene Selmani e ka fjalën dhe hyjmë në procedurën e votimit.

MYZEJENE SELMANI: Falemnderit, kryetar!

Duke marrë parasysh deklaratimet e deputetëve këtu, është joetike, sepse nëse nuk janë mësuar për një vit, ndoshta mësohen në vitin e ardhshëm, sepse është viti i parë i tyre dhe kanë kohë të mësohen. Të etiketohet se nuk është vetëm zonja nga Gjakova, por është edhe zonja Sevdije nga Gjakova, e Gjakova nuk është vetëm e AAK-së, por është e gjithë qytetarëve të Kosovës. Ju falemnderit!

KRYETARI: Kemi hyrë në procedurën e votimit. Deputete, e tha kryetarja juaj atë që doni ta thoni ju.

(Reagim)

Pra, hymë në procedurën e votimit, se fjala e nxjerr fjalën, e nuk mund ta kryejmë këtë punë. Asnjë minutë! Vazhdojmë ta votojmë amendamentin e dytë.

Amendamenti 2

Propozim i Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tash:

Me 13 vota për, 45 kundër, një pa kartelë: 46 vota kundër... Nuk miratohet amendamenti.

Amendamenti 3

Propozim i Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tash:

Me 7 vota për, 50 vota kundër, nuk miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4

A ka kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Propozim i Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tash:

(Ndërhyrje - reagim)

Me 46 vota kundër, nuk kalon amendamenti 5.

Amendamenti 6

A ka kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? S'ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? S'ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Propozim i Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tash:

Me 9 vota për, 46 kundër dhe asnjë abstenim, nuk miratohet amendamenti 13, propozim i Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Pa përkrahje të Komisionit për Buxhet e Financa. Votojmë tash:

Me 29 vota për, 20 kundër dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 15, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 20

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 21

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 22

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Tani e votojmë Ligjin në tërësi.

Në sallë janë të pranishëm 66 deputetë, do të thotë kemi kuorum. Faleminderit!

Tash e votojmë Ligjin në tërësi.

Konstatohet se me 35 vota për, 15 kundër dhe 12 abstenime, Kuvendi e miratoi Ligjin për Teatrot.

Tash e vazhdojmë me pikën:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore, dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

Tash i kemi 14 amendamente.

Amendamenti 1

A ka kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër, nuk ka?

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

A ka kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër, nuk ka?

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

A ka kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër, nuk ka?

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10.

A ka kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

(Ndërhyrje - reagim)

Ju lutem! Kemi hyrë në procedurën e votimit.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër, nuk ka?

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

A ka kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër, nuk ka?

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Të pranishëm janë 62 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Me 42 vota për, 4 kundër dhe 1 abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore. Faleminderit!

(Ndërhyrje)

Nuk e keni kërkuar fjalën me kohë. Kërkojeni fjalën me kohë, do ta merrni, sepse tash kemi hyrë në procedurën e votimit.

(Ndërhyrje)

Po, nuk e kam parë unë. Ke mundur ta kërkoish fjalën përpara?

(Ndërprerje e incizimit)

Vërtet nuk e kam parë, sepse s'kam pasur asnjë arsye të mos ua jap fjalën.

Atëherë, po vazhdojmë me pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës:

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Sa i përket Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore, ne si grup parlamentar votojmë kundër, edhe amendamentet, një pjesë të tyre kundër, përpos 5 amendamenteve, të cilat përmirësojnë në një aspekt. Pse? Për shkak se projektligji është që kjo agjenci të bartet nga ministria dhe të kalojë në Kryeministri.

Fillimisht, projektligji ka qenë që kjo agjenci të hiqet nga ministria dhe të bëhet agjenci e pavarur, në fund ka përfundua si një agjenci që duhet të kalojë në Kryeministri. Cila është arsyeja që kjo agjenci të kalojë në Kryeministri? Kjo është një epidemi e përgjithshme, që gjithnjë e më tepër po bëhen agjenci të pavarura edhe ato që kalojnë në Kryeministri, kur e dinë fare mirë se në analizë çka kemi bërë edhe në komision, vendet e regjionit e kanë nëpër ministri. Madje, Sllovenia ka central bërthamor, e një agjenci të tillë e ka në ministri.

Ministria e Financave ka qenë kundër, sepse si agjenci brenda ministrisë ka qenë në zhvillim e sipër. Do të mund të flitej ndoshta pas disa viteve kur të zhvillohet. Pse, duhet të dal e pavarur, kur e dimë fare mirë se nuk ka kurrfarë pune, përpos punës së licencave që duhet dhënë për spitalet të cilat bëjnë radiologji, apo për shërbime të ndryshme, për fotografime me rreze x, e kështu me radhë. Pra, bëhet fjalë për këto licenca, të cilat mund të kryhen në kuadër të ministrisë.

Cili ka qenë arsyetimi për këtë agjenci? Arsyetimi i vetëm ka qenë duke u ankuar dhe duke e nxirë ministrinë qysh ajo i ka diskriminuar vazhdimisht si departament.

Kjo gjë do të mund të zgjidhej me ligj, me buxhet, që ata ta kenë linjën e vetë dhe të zhvillohen në mënyrë normale. Kur ne e dimë shumë qartë se nuk kemi as ekspertë të kësaj fushe, ne bëjmë agjenci të pavarur dhe e çojmë në Kryeministri! Prandaj, motivi ka qenë çdo herë i paqartë. Arsyetimi në komision ka qenë i paqartë, vetëm se ka pasur diskutime, presione të ndryshme se duhet të bëhet, pa ndonjë arsyetim të vlefshëm.

Prandaj, do të ishte e udhës që ky projektligj të mos kalojë, që kjo agjenci të mbetet në ministri edhe për sa e sa vite, gjë që është e nevojshme, që t'i ndahet qartë linja buxhetore dhe të zhvillohet në kuadër të ministrisë. Pse paska nevojë pa tjetër të bëhet patjetër agjenci e pavarur, e u bëjmë rrush prej agjencive të pavarura, të cilat ndërmjet ministrisë dhe kryeministrit e kanë krijuar një farë tamponi prej agjencive të ndryshme, të cilat më shumë kanë konflikt me ministrinë se sa bëjnë ndarjen ndërmjet kryeministrit dhe ministrive dhe e krijojnë konfliktin ndërmjet ministrive dhe këtyre agjencive.

Kjo po e shndërron sistemin totalisht në një sistem jofunksional, sepse agjencia vlen të formohet vetëm kur zhvillohet një lëmi e caktuar. Ky ishte arsyetimi.

KRYETARI: Do të thotë, ishte arsyetimi i votës kundër. Vazhdojmë me pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës.

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Mbeturina

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Mbeturinat dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, deputetin Nait Hasani, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime. Nëse do ta bësh arsyetimin.

NAIT HASANI: Falemnderit, kryetar!

Komisioni e ka shqyrtuar dhe ka amendamentuar Projektligjin për Mbeturinat dhe i ka 2-3 vërejtje, që duhet të merren parasysh. Te amendamenti 14, pika 4 dhe 5, nuk duhet të votohet, për shkak se është e rregulluar me Ligjin për ndërmarrjet publike.

E kemi amendamentin 15, pika 1 dhe 2, fjala në fund duhet të hiqet, dhe e kemi amendamentin 19, fjala “licencuar” duhet të zëvendësohet “për administrimin e mbeturinave”. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Kur të arrijmë aty, paraqitesh për fjalë.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka.

Abstenim. Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër. Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Nait, cilat pika duhet të shlyhen.

NAIT HASANI: Në amendamentin 14, duhet të fshihen pikat 4 dhe 5, për shkak se janë në kundërshtim me Ligjin për ndërmarrjet publike.

KRYETARI: Pra jeni “për”, pa pikën 4 dhe 5. Mirë.

Amendamenti 15.

Deputeti Nait Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Te amendamenti 15 duhet të hiqet fjala e fundit dhe të marrë pëlqimin nga ministria, për shkak se pëlqimi nuk merret nga ministria, por këtu duhet të jetë pjesë e komunave drejtpërdrejt, është në plan-programin nacional.

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Hiqet pjesa, të cilën e citoi deputeti Nait Hasani.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19

Deputeti Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Në fund të paragrafit, ministria me akte nënligjore i përcakton rregullat dhe kushtet e licencimit, duhet të hiqet fjala “licencimi” dhe të zëvendësohet “për administrimin e mbeturinave”. Amendamenti 19, neni 21.

(Ndërprerje e incizimit)

Amendamenti 20

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 21

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 22

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 23

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 24

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 25

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 26

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 27

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 28

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 29

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 30

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 31

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 32

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 33

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 34

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 35

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 36

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 37

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 38

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 39

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 40

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Tani të pranishëm janë 65 deputetë. Votojmë tash:

Konstatohet se me 62 për, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet Ligji për Mbeturinat.

Pika e katërmëdhjetë e rendit të ditës:

14. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, për vitin 2011

Raporti vjetor i Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, për vitin 2011, të cilin e ka shqyrtuar Komisioni Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe ia ka rekomanduar Kuvendit për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, për vitin 2011 dhe ia ka rekomanduar Kuvendit për miratim.

Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinorë, deputeti Nait Hasani, për arsyetimin e raportit me rekomandime. Deputet, e ke fjalën.

NAIT HASANI: Falemnderit, kryetar!

Komisioni e ka shqyrtuar dhe e ka kthyer një herë raportin e Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina dhe e ka shqyrtuar për herë të dytë, me gjithë vërejtje që i kemi pasur. I ka përmirësuar disa nga vërejtjet në çështjen e furnizimit me ujë dhe tarifave të ujit dhe jemi pajtuar që ky raport të kalojë në Kuvend. Falemnderit!

KRYETARI: Radha e grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike, deputeti Njazi Idrizi e ka fjalën.

NJAZI IDRIZI: Falemnderit i nderuari kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit,

Të nderuar deputetë,

Grupi ynë parlamentar e ka shqyrtuar këtë raport dhe e ka vlerësuar si korrekt. Ky raport e prezanton realisht gjendjen në këta sektorë, në të cilët janë evidentuar edhe suksese, por edhe dobësi. Kështu, analizat e ujit të pijshëm janë bërë në mënyrë të rregullt. Po ashtu, numri i ankesave për shërbimet e ofruara me ujë dhe ujëra të zeza është rritur. Arkëtimi i faturave gjatë vitit 2011 është rritur rreth 3%, gjë që është pozitive.

Sektori i mbeturinave vazhdon të ketë performansë të dobët në të gjithë treguesit, gjë që është negative. Në raport është evidentuar përkushtimi i këtij institucioni për përmirësimin e kësaj gjendjeje.

Zyra e Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina gjatë vitit 2011 e ka finalizuar aprovimin e tarifave të reja volumentrike të shërbimeve të ujit në përputhje me metodologjinë e re, e cila përdoret në disa vende të Evropës, dhe e cila do të zbatohet gjatë viteve 2012-2014.

Zyra e Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina ka dhënë afate ligjore për vendosjen e ujëmatësve kudo ku është e mundur, me qëllim që konsumatorët të mos diskriminohen. Është për t'u përshëndetur opinioni i krijuar në Zyrën e Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina se shumica e konsumatorëve janë të gatshëm të paguajnë nëse përmirësohet cilësia e shërbimit.

Zyra e Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina po ashtu kërkon investime në zgjerimin e shërbimeve sanitare, që aktualisht është e ulët, për përmirësimin e cilësisë së ujit nga të gjithë ofruesit, investime në infrastrukturë për t'i ulur humbjet e ujit, ku aktualisht ka humbje të mëdha për ngritjen e kapaciteteve të reja prodhuese, e tjera.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështet këtë raport dhe inkurajon Zyrën e Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina që ta vazhdojë përkushtimin për vendosjen e rregullit në fushat e përgjegjësisë. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Lidhjes Demokratike, deputeti Sali Morina.

SALIH MORINA: Falemnderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e ka shqyrtuar këtë raport dhe njëkohësisht e ka bërë një analizë dhe pajtohem edhe me parafolësin se ky raport është shumë real, për të cilën vërejtjet janë paraqitur sidomos kur është pyetje kualiteti i ujit. Po ashtu, edhe performansa është jo e mirë sa u përket mbeturinave, por e kemi edhe një përqindje jashtëzakonisht të lartë të ujit të pafaturuar dhe nga ky raport i tillë i Zyrës Rregullative të Ujit dhe e Mbeturinave duhet ta arrijë performansën e vet. Njëkohësisht duhet ta përmirësojë sidomos nëpërmjet kompanive, të cilat i ka të licencuara në nivel regional, ta arrijë kualitetin më të mirë, sidomos sa i përket ujit të pijshëm, sepse veçohet sidomos regjioni i komunës së Pejës, e veçanërisht komuna e Klinës, në të cilën ka mungesë të ujit dhe njëkohësisht shquhet për cilësi jo të mirë të ujit, sipas Institutit të Shëndetit Publik të regjionit të Pejës.

Andaj, edhe ne, si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike, e mbështetim këtë raport dhe njëkohësisht kërkojmë që kjo zyrë në të ardhmen t'i rrisë kapacitetet e veta, sepse tash do ta ketë më lehtë, ngase mbeturinat më nuk do të jenë kompetencë e kësaj zyre, por kompetencë do të jetë vetëm çështja e ujit të pijshëm dhe e kanalizimit. Falemnderit shumë!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Po ashtu, edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar Raportin vjetor të punës për Zyrën e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina. Siç u tha edhe më herët, ky raport së pari është kthyer në komision dhe pastaj i plotësuar është pranuar nga komisioni, e tani në këtë formë ne e konsiderojmë të pranueshëm, sepse e paraqet, relativisht në mënyrë reale, gjendjen e rëndë.

Vërejtjet të cilat kanë qenë, më duhet t'i përmend, elementet e paushallit, të cilat i paguajnë konsumatorët e Kosovës, nuk kanë qenë të prezantuara mirë, meqë e dimë se 61% e ujit humb si i pafaturuar. Dhe, kjo humbje e madhe shpeshherë kompensohet me pagesën nëpërmjet paushallit të familjeve, të cilat janë parapagues të rregullt. Shembull janë, e po shpresojmë që po mendohet që ky paushall diku nga qershori të përfundojë politika e faturimit të tillë, por deri më tani e kemi një situatë mjaft të rëndë gjithandej, meqë edhe mënyra se si bëhet faturimi paushall nga kompanitë e ndryshme është totalisht e ndryshme, e edhe këtu përmendet se është 30 metra³ për familje, ta zëmë në Prishtinë, apo 70 m³ për familje në Pejë, te kompania regjionale “Radoniqi”.

Mos të harrojmë që edhe ky paushall, që mendohet se në këto familje dhe ndërtesat kolektive është paushall brendapërbrenda ndërtesës te familjet që ndahet në bazë të numrit të anëtarëve, nuk ndodh në këtë mënyrë për shkak se nuk bëhen fare matjet dhe ka ngecur vendosja e ujëmatësve, gjë që e bën mjaft të pabesueshme se do të arrihet që deri në qershor dhe të ndalet praktika e faturimit paushall.

Megjithatë, raporti si raport, i paraqet të gjitha këto problematika, dhe ne do ta pranojmë si të tillë.

KRYETARI: Në emër të AAK-së, kryetari Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Falemnderit, zoti kryetar!

Mendojmë se me gjithë atë që shkruan në raport dhe që definitivisht duhet të kalojë si raport i tillë, duhet të kalojë në Kuvend, prapëseprapë ka qenë dashur që ky raport të përcillet me një pyetësor, i cili vjen nga Qeveria se si do të sanohet gjendja, për shkak se e kemi një prerje të gjendjes, e dimë se ku jemi.

Temat të cilat u përmendën këtu ndoshta nuk është keq të thuhet se në vendet tjera, sidomos në ato të Unionit Evropian janë zgjidhur në fillim të shekullit të kaluar. Do të thotë, Kosova sot ballafaqohet me një situatë, e cila në vendet normale është zgjidhur para 100 vjetësh. Por, nëse e kemi një raport të këtillë, atëherë detyrimisht është dashur të përcillet me një studim dhe me një plan se si duhet të kalohet nga kjo gjendje, sa kohë do

të na duhet, sa mjete do të na duhen. Nëse vazhdojmë kështu vetëm ta kalojmë raportin dhe ta konstatojmë gjendjen, do të kemi probleme që si Kosovë të dalim nga kjo gjendje. Sidoqoftë, e mbështetim raportin si të tillë për shkak se në këto rrethana nuk kemi çfarë të bëjmë tjetër. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputeti Jeton Svirca.

JETON SVIRCA: Falemnderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar Raportin vjetor të Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, si dhe të njëjtin do ta përkrahë. Ju falemnderit!

KRETARI: Falemnderit!

SLS-ja nuk ka të paraqitur. "6+" nuk ka të paraqitur.

Atëherë fillojmë me diskutime, i kemi tre deputetë të paraqitur. Po fillojmë me deputeten, Safete Hadergjona.

SAFETE HADERGJONAJ: Falemnderit, kryetar!

Unë desha ta njoftoj Kuvendin që Komisioni për Buxhet dhe Financa më 2 prill e ka shqyrtuar raportin e Zyrës së Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, për vitin 2011. Nga raporti, të cilin e ka paraqitur Zyra e Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina shihet që kjo zyrë i ka shpenzuar diku 83.70% të mjeteve. Nga 326 mijë e 570 euro të miratuara me buxhet ka shpenzuar 273 mijë e 323 euro.

Ky rregullator njëkohësisht inkason edhe të hyra dhe ka arritur t'i inkasojë të hyrat në vlerë prej 238 mijë e 960 euro nga kompanitë e licencuara të ujësjellësit dhe kompanitë e grumbullimit të mbeturinave, nga 327 mijë e 364 euro, sa i ka pasur të planifikuara për t'i realizuar brenda vitit 2011, që do të thotë se e ka realizuar planin diku 72.99%.

Kësaj kompanie i kanë borxh edhe disa kompani të licencuara, të cilat nuk i kanë paguar obligimet në shumën prej 98 mijë e 194 euro.

Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina po ashtu ka pasur përkrahje nga donatorët në formë të asistencës, duke përfituar 1,8 milion euro nga projektet IPA-së, të cilat mjete janë menaxhuar nga donatorët.

Në Komisionin për Buxhet dhe Financa, ku ka qenë i pranishëm edhe udhëheqësi i kësaj zyre të ujësjellësit dhe të mbeturinave është diskutuar rreth mënyrës së inkasimit të mjeteve dhe mosgatishmërisë së qytetarëve për t'i paguar shpenzimet e tyre, me qenë se nga projektet nga të cilat ka përfituar Zyra e Rregullatorit të Ujit dhe Mbeturina në shumë ndërtesa kolektive janë të vendosur orëmatësit, kurse inkasimi nuk bëhet në bazë të orëmatësve të vendosur, por ende bëhet inkasimi paushall, për ç'gjë janë shprehur edhe reagimet dhe vërejtjet nga deputetët e anëtarët e komisionit në lidhje me këtë çështje, sepse edhe me legjislacionin në fuqi është paraparë që pagesa të bëhet në bazë të orëmatësve. Prandaj, edhe ka shumë mjete të painkasuara nga borxhlinjtë.

Me qenë se raporti, në përgjithësi, i ka plotësuar kushtet për raportim, të gjithë anëtarët e komisionit kanë qenë për këtë raport. Prandaj, rekomandojmë që të miratohet edhe pjesa financiare e raportit.

KRYETARI: Falemnderit! Fjalën e ka deputeti Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Falemnderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Atë që e thatë ju të gjithë, edhe grupet parlamentare në një mënyrë i dhanë vizë. Në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike po ashtu e kemi shqyrtuar këtë raport. Nëse e marrim formën se si e ka prezantuar, mund të pranohet, por nëse e këqyrim se çka ka prezantuar dhe a është në rregull, kjo, jo që nuk duhet pranuar, por është një shqetësim bukur i madh.

E pra, Kosova nuk ka resurse ujore të bollshme që të sillet me një komoditet të tillë, meqë 61% e ujit humb, pastaj nga 39%, pjesa më e madhe është e faturuar. Çmimi i përcaktuar sipas kompanive është i ndryshëm, duke filluar prej 0.19 deri 0.07, që unë mendoj se nuk është në rregull, sepse uji është i njëjtë, si këtu si në Prizren, e jo të paguhet ndryshe. Pastaj, sasia e ujit që paguhet në bazë të ujëmatësit është tepër e vogël, gjë që nuk arsyetohet me asgjë. Edhe aty ku ka ujëmatës, në disa raste nuk matet në mënyrë të rregullt, matet në 3-4 muaj, ose 5-6 muaj. Marrë në tërësi, menaxhmenti i kësaj agjencie mendoj se nuk e ka kryer punën e vet mirë dhe kjo duhet të jetë një brengë e Kuvendit. Në këtë rast, unë po e shoh që në Kuvend është disponimi të miratohet ky raport, por unë kam qenë për atë që t'i bëjmë disa rekomandime, në kuptimin jo t'i hiqet koka dikujt, por t'i caktojmë detyrat dhe të kërkojmë llogaridhënie, sepse kështu do ta presim një raport tjetër pas një periudhe pas 6 muajve apo një viti. Duhet të mendojmë se ku na çon formë kështu. Unë mendoj se nuk ka perspektivë. Po e përsëris, 61% humb, as që faturon. Nuk mund të arsyetohet jo me gypa të vjetër, e me këtë formë e me atë formë. Ka edhe kyçje ilegale që ata i dinë, e nuk i zbatojnë. Mandej, vlerësimet paushalle nuk janë hiç reale, të gjitha këto bëjnë që Kuvendi është dashur t'ia bëjë rekomandimet e caktuara këtij bordi dhe të kërkojë reflektim në të gjitha ato pika. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Deputeti Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Falemnderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë desha të kontribuoj lidhur me çështjen e këtij rregullatori, edhe pse ne jemi mësuar t'i kalojmë shkarazi kështu raportet. Është momenti i fund që çështja e ujërave dhe mbeturinave nga rregullatorët, të cilët paraqesin raporte, ta marrin përgjegjësinë, sepse është një sfidë e madhe për shëndetin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.

Kontaminimi që u bëhet sot ujërave nga industria e pakontrolluar, lëre anash këtu pjesën e pagesave që nuk numërohet, janë çështje të cilat duhen të jenë shqetësim për tërë popullatën dhe mendoj se kualiteti i ujit, sot për sot, nuk raportohet drejt edhe te pjesa, përveç asaj që kontrollohet nga pjesa e distribuimit, por edhe nga pjesa e atyre që rrjedhin nëpër lumenj.

Testimi i ujit në mënyrë periodike nga kontaminimi, përveç atmosferik, që bëhet me ujëra atmosferikë, nga industria që ne e kemi ngritur disa herë, për shembull siç janë gjigantët e mëdhenj “Ferronikeli”, Elektroekonomia, “Sharr-Cemi”, e këta të tjerët, të cilët në mënyrë direkte shkojnë në pije, në bimë, rrjedhimisht vijnë edhe në ushqimin e popullatës, janë elemente të cilat duhet të jenë shqetësuese.

Prandaj, rregullatori në të ardhmen duhet të jetë në këta komponentë monitorues, të cilët duhet të jenë shqetësues dhe mobilizues për institucionet të cilat e kanë përgjegjësinë.

Sa i përket çështjes së mbeturinave, Kosova po ashtu është në një sos, nëse mund të thuhet. I ka disa pika të grumbullimit të mbeturinave, por në një gjendje alarmante. Për shembull, komuna e Prishtinës në Obiliq e ka pjesën e mbeturinave, e cila qëndron mbi pjesën që figurativisht quhen bumbulat e metalit, sepse në pjesët e qymyrit ekzistojnë edhe grumbullimet e mundësive të metanit. Një eksplodim i mundshëm nga ndezjet që bëhet nëpër to, mund të sjellin një kontaminim të paparë të gjithë Prishtinës. Shpresoj që edhe deputetët e komisionit përgjegjës, edhe ministritë përgjegjëse ta ngrenë këtë si shqetësim, që ne t’i përkushtohemi dhe të kontribuojmë pozitivisht, qoftë duke gjetur donatorë, qoftë duke ngritur kapacitete investuese dhe monitoruese. Të jemi në pjesën e nivelit të preventivës së kësaj situate. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit!

Në sallë janë 58 deputetë. Ju lutem, është në përgjegjësinë e komisioneve që kanë agjenci të tilla të saktësojnë diçka. Ju e dini se disa herë na ka ndodhur në Kuvend që të mos i miratojmë raportet e agjencive të ndryshme, por në agjenci nuk ka ndodhur bash asgjë. Kështu që unë mendoj që komisionet duhet të kërkojnë amendamentimin e ligjeve. Çka nëse një agjencie nuk i miratohet raporti i punës, qoftë edhe raporti financiar? Përndryshe, nëse ne nuk e votojmë, por agjencia apo komisioni vazhdon me të vjetrën, cilat do të ishin arsyet e mosvotimit të një raporti, qoftë të punës, qoftë financiar? Mendoj që komisionet është mirë t’i shikojnë ligjet dhe kjo çështje të jetë e vërtetë dhe pastaj, nëse dihen përgjegjësitë, nëse një raport nuk kalon, unë mendoj që edhe agjencitë apo komisionet do të përpiqen ndryshe t’i bëjnë raportet.

I thashë këto fjalë edhe për faktin se nuk e kemi numrin e caktuar të deputetëve.

Tani kemi të pranishëm 62 deputetë.

E votojmë Raportin vjetor të Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina për vitin 2011 dhe rekomandimet e komisioneve. Votojmë tash:

Konstatohet se me 56 vota për, 5 kundër, një abstenim, Kuvendi e miratoi Raportin vjetor të Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, për vitin 2011.

Pika e pesëmbëdhjetë e rendit të ditës:

15. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji, për vitin 2011

Raporti vjetor i Zyrës së Rregullatorit për Energji, për vitin 2011, është shqyrtuar nga Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe ia ka rekomanduar Kuvendit për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Raportin vjetor financiar për vitin 2011 dhe ia ka rekomanduar Kuvendit për miratim.

Fjalën e ka kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti Zenun Pajaziti, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: Falemnderit, për fjalën zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në bazë të nenit 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 2. maj, e ka shqyrtuar Raportin vjetor të punës së Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe ka vlerësuar se ky raport është në pajtim me nenin 9 të Ligjit numër 3/185 për Rregullatorin e Energjisë dhe i rekomandon Kuvendit për miratim.

Më lejoni, zoti kryetar,

Për shkak të kohës, po ashtu edhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, konstatoj mbështetjen për këtë raport.

Grupi Parlamentar i PDK-së e ka trajtuar në tërësi Raportin e Zyrës së Rregullatorit për Energji. Është një raport goxha i detajuar për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me fushëveprimin e këtij mekanizmi të rëndësishëm për trajtimin e energjisë.

Me gjithë nevojat për investime në sektorin e energjisë dhe pamjaftueshmërisë të kapaciteteve gjeneruese ekzistuese për t'i plotësuar nevojat e furnizimit, ne i mbështetim nevojat për iniciimin e një ristrukturimi të një sektori, në përgjithësi, të energjisë nëpërmjet liberalizimit të tregut. Presim që së shpejti vetë Zyra e Rregullatorit të Energjisë ta aprovojë dhe ta finalizojë këtë liberalizim të tregut.

Jemi të shqetësuar po ashtu për pamundësinë e plotësimit të nevojave nga gjeneratorët vendorë me energji elektrike dhe për nevojën që energjia e munguar të paguhet me çmime relativisht të larta. Por, shpresojmë që së shpejti, me procesin e ri dhe me strategjinë e re për të filluar rritjen e këtyre kapaciteteve, Rregullatori i Energjisë, Qeveria dhe institucionet tjera mbështetëse t'ia dalin që ky proces të përmbyllet dhe të fillojë strukturimi ose ristrukturimi, në përgjithësi, i këtij sektori.

Pra, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike e mbështetim këtë raport. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Fjalën e ka kërkuar kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, Safete Hadergjonaj.

SAFETE HADERGJONAJ: Falemnderit, zoti kryetar!

Zyra e Rregullatorit të Energjisë, sipas nenit 18 dhe 21 të Ligjit për rregullatorin e energjisë, është e obliguar që së bashku me raportin vjetor ta dorëzojë edhe një raport financiar, në të cilin i paraqet në mënyrë të detajuar dhe të hyrat, të cilat i inkason ky

rregullator, dhe njëkohësisht edhe mënyrën e shpenzimit të mjeteve, ashtu siç janë planifikuar.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 25 prill, pasi e shqyrtoi Raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, për vitin 2011, vlerësoi se në raportin financiar të ZRRE-së mungojnë të dhënat për buxhetin e miratuar, krahasimet me buxhetin e shpenzuar për vitin 2011 sipas kategorive ekonomike dhe të nënkategorive tjera ekonomike dhe kërkoi nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë që ta dorëzojë një raport plotësues financiar që i përfshin të dhënat e kërkuara nga komisioni, dhe njëkohësisht janë edhe kërkesa ligjore për raportim.

Zyra e Rregullatorit të Energjisë e ka sjellë raportin shtesë, kështu që Komisioni për Buxhet dhe Financa për herë të dytë e ka shqyrtuar raportin më 2 maj 2012, të dërguar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

Kjo zyrë i ka shfrytëzuar mjetet diku 89.5% dhe po ashtu ka inkasuar të hyra në vlerë prej 508 mijë e 689 euro, kurse të hyrat e bartura nga viti 2010 kanë qenë 205 mijë e 217 euro, që do të thotë se gjithsej të hyrat e këtij Rregullatori janë 713 mijë e 902 euro.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, pasi i ka analizuar shpenzimet e këtij institucioni, në krahasim me atë që është planifikuar, dhe pas sqarimeve të cilat i ka marrë në lidhje me mënyrën e shpenzimit të këtyre mjeteve, unanimisht e ka përkrahur raportin financiar, tani më të plotësuar, i cili i është bashkangjitur edhe raportit me rekomandime, të cilin e ka dhënë Komisioni për Buxhet dhe Financa, dhe u rekomandon deputetëve ta miratojnë këtë raport. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të LDK-së, Teuta Sahatqija e ka kërkuar fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Falemnderit, kryetar!

Në komision është analizuar mirë ky raport, por edhe në Grupin Parlamentar, me anëtarët e Komisionit që janë nga LDK-ja.

Në raport janë trajtuar korniza ligjore, raporti financiar, licencat, sektori i energjisë elektrike, shpërndarja, tarifat e të tjera. Dhe, si raport paraqet një përmbledhje të mirë të shënimeve, të cilat paraqesin gjendjen në sistemin e energjetikës, si dhe prioritetet e saj.

Nga biseda me zyrtarët e ZRE-së, e kemi kuptuar se humbjet në sistemin e energjetik vazhdojnë të jenë ende të larta dhe paraqesin diku, sipas tyre, 38.15%. Në vendet e zhvilluara humbjet paraqiten 3 deri në 4%. Te ne, vetëm në distribucion, ato janë 16%.

Serbia ende vazhdon të alokojë kapacitetet energjetike, kurse transiti i cili kalon nëpër Kosovë paguhet nga konsumatori ynë.

Tri kompanitë e licencuara për blerjen e energjisë janë nga Serbia. Aplikimi i njësorëve elektrikë nuk ka nisur të aplikohet, edhe pse është planifikuar që ky proces të fillojë sivej.

Nga tabelat shihet se konsumi i energjisë në territorin e shtetit të Kosovës nga amvisëria përbën 54.51 të shpenzimeve. Nëse kemi parasysh shpenzimin nga institucionet, shkollat, shpenzimin në ndriçimin publik e tjera, për biznes dhe industri mbetet një përqindje e vogël. Kjo shumë qartë tregon se biznesi dhe industria shpenzojnë pak. Biznesi dhe industria shpenzojnë pak, sepse punojnë pak, sepse përkundër shumë fjalëve se ka përmirësim në hapësirën biznesore, ajo ende mungon.

Nga pyetjet tona se a ka ndikuar fusnota që Kosova në paraqitjet regjionale të ketë përmirësim të pozitës, përgjigjja ishte se nuk ka asnjë ndryshim. Dhe, Kosova vazhdon të paraqitet në siglën e UNMIK-ut.

Raporti meriton të votohet, por është me rëndësi të analizohen mesazhet, të cilat dalin nga ky raport. Me një fjalë, raporti është i mirë, por tregon qartë se sektori i energjisë kërkon urgjent një qasje serioze dhe përmirësim të performansës.

Mesazhi tjetër thotë se zhvillimi ekonomik çalon dhe përveç “power-point” prezantimeve nga Qeveria, duhet qasje serioze institucionale për krijimin e ambientit biznesor.

Mesazhi i tretë është se dialogu Kosovë-Serbi nuk po prodhon efekte të dobishme për Kosovën, e as për Tadiqin!

Rekomandojmë që të votohet si raport dhe të merren rekomandimet për gjërat tjera, të cilat dalin si mesazh.

KRYETARI: Falemnderit deputete! Në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Falemnderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar Raportin e Zyrës së Rregullatorit për Energji. Unë nuk do të ndalem në vërejtjet që i përmendi kolegja e mëparshme, në mënyrë që të mos i përtëris. Ndër arsyet tjera që ne do ta votojmë këtë raport është se Zyra e Rregullatorit e ka përfillur kërkesën e komisionit që ta bëjë pasqyrë të stërholluar financiare, pra pasqyra e stërholluar financiare është përfshirë në këtë raport dhe si të tillë do ta votojmë. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Aleancës, kryetari i grupit, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Falemnderit, zoti kryetar!

Gjithashtu ne e mbështetim votimin e këtij raporti, do të thotë e mbështetim që ky raport të kalojë në Kuvend. Sidoqoftë, duhet të thuhet se në projekt-rregulloren e re të Kuvendit, e cila ende është projekt, parashihet të ekzistojë një mundësi që Kuvendi, në rast se një raport nuk kalon, të parashohë që Bordi i agjencisë ose i rregullatorit të mund të shkarkohet, por kjo ende nuk është në fuqi. Por, shpresojmë se në të ardhmen do të jetë në fuqi, në mënyrë që edhe debati rreth raporteve të jetë më shumë në detaje, që raportet e zyrave rregulluese ose rregullatorëve t’i kenë edhe caqet e veta, të cilat ne mund t’i matim prej viti në vit dhe që debati në Kuvend të mos jetë kaq i thjeshtë.

Ne mendojmë se për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë do të fillojë një fazë tjetër në momentin kur të privatizohet distribucioni dhe një klauzolë e tillë në rregulloren e re të na japë mundësi që ne të shohim se cili do të jetë interaksioni ndërmjet rregullatorit, që është organ i shtetit dhe distributorit privat të energjisë. Sidoqoftë, edhe njëherë mendojmë se raporti duhet të kalojë. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja e Grupit, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Falemnderit, kryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar Raportin e Zyrës së Rregullatorit për Energji.

Duke marrë parasysh se Agjencia apo Zyra e Rregullatorit për Energji, edhe në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duhet të raportojë çdo vit në Kuvendin e Kosovës dhe është trup i organit të Kuvendit të Kosovës. Në këtë raport shihet mjaft qartë se këta e shohin çështjen e zhvillimit të sektorit të energjisë në këtë raport. Mirëpo, në esencë ne nuk kemi zhvillim të sektorit të ...

Rregullatorit të Energjisë, në realitet. Në këtë raport shihet mjaft mirë puna edhe e ndërmarrjes, apo më mirë të themi e Korporatës Eelektroenergjetike të Kosovës dhe KOST-it, ku rrjeti i transmisionit, në këtë rast, ka një ulje të humbjeve, ndërsa në projektet e filluara në vitin e mëparshëm, është shumë e habitshme. Përmendet një numër i projekteve që janë realizuar, në fakt është realizuar ky numër i projekteve, paketa projektuese- Peja 3, mos të hyj në anën profesionale, mbasandaj Ferizaj 2, ndërsa projektet e filluara, thotë: në vitet e mëparshme dhe kanë vazhduar në vitin 2011. Ndërtimi i linjës interaktive 400 kv Kosovë-Shqipëri është non-cens. Kjo ... as nuk ka filluar, as nuk do të fillojë. Këtu të jemi shumë të qartë dhe atë ditë unë i kam treguar përfaqësuesit të Zyrës së Rregullatorit, se nuk kanë pasur, kryetar, mos shkruaj diçka që nuk është.

Mbasandaj shkojmë te çështjet tjera në këtë raport, ku paraqiten diagrame të cilat është jo e kuptueshme për deputetët, se deputetët nuk janë inxhinierë të energjetikës që t'i kuptojnë këto diagrame ditore dhe javore, humbjet e energjisë elektrike në transmision. Kjo është një fatbardhësi se këtu ka ulje, për shkak të realizimit të disa projekteve. Kemi çështjen e prodhimit të energjisë elektrike, ku thuhet në raport se prodhimi i energjisë elektrike për vitin 2011 ka qenë më i lartë se në vitin 2010, mirëpo prapëseprapë ne jemi varur nga importi.

Shihet konsumi i energjisë, duhet të kuptohet se konsumi i energjisë në këtë situatë ekonomike çfarë është Kosova, pritët që të rritet, mirëpo rritja ka ndodhur vetëm në konsumin e amvisërisë, që është shumë e dhembshme për një shtet.

Kemi çështjen e konsumit në shpërndarje dhe humbjet në shpërndarje. Këtu shihet mjaft mirë se është bërë një tabelë e humbjeve në shpërndarje, sipas muajve në vitin 2011 dhe këtu shihet se distrikti i Mitrovicës ka humbje marramendëse, që do të thotë se mbetet çështja edhe e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, si ekzekutiv i vendit dhe e këtij

Kuvendi dhe e Zyrës së Rregullatorit, të jetë një kontrollues më i mirë, për arsye se çështja e ngritjes së tarifave ngarkon të gjithë qytetarët e Kosovës, pavarësisht se a jetojnë në Prishtinë, a në Gjilan apo diku tjetër?

Faturimi dhe arkëtimi, këtu është shumë e pakuptimtë kur i merr deklaratat e Korporatës Elektroenergjetike të Kosovës, e cila thotë se kemi rritur faturimin dhe arkëtimet e këtu shihet mjaft mirë se ne prapëseprapë japim pare e subvencion KEK-ut, për çështjen e importit të energjisë elektrike.

Në rast se e shohim në efekt këtë raport, mund të themi se raporti është i mirë, me përjashtim se ata mendojnë që është nisur një projekt madhor ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë dhe kërkoj nga Qeveria jonë dhe nga ky Kuvend të dihet saktë, a është nisur apo vetëm shënohet këtu në këtë raport?

Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah raportin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, për arsye se i jep në mënyrë shumë të qartë të gjitha marifetllëqet që i bën Korporata Elektroenergjetike e Kosovës.

KRYETARI: Falemnderit!

Në emër të SLS-së? Nuk ka.

Në emër të “6+”-it, kryetari i grupit Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Falemnderit, i nderuar kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar dhe analizuar raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë. Mendojmë se ky raport i plotëson të gjitha kushtet për miratim në Kuvend dhe si të tillë do ta votojmë. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Fjalën e ka kërkuar deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Falemnderit, kryetar!

Unë po filloj me atë çka ju e thatë pak më parë, me raportin e kaluar, sepse me të vërtetë ka ardhur koha që Kuvendi të vendosë, a do ta kryejë funksionin kushtetues që e ka legjislativ, mbikëqyrës dhe përfaqësues, apo vetëm këto dyja, legjislativ dhe përfaqësues dhe këtë mbikëqyrës të mbetet vetëm teknik, si ndaj Qeverisë ashtu edhe ndaj organeve të pavarura, institucioneve të pavarura, në këtë aspekt agjencie, siç është rasti edhe me këtë që tash po e shqyrtojmë këtë raport në fjalë?

Ndryshimi i legjislacionit është i domosdoshëm, sepse edhe nga vetë ky raport apo i ashtuquajtur i rekomandim, që vjen nga ky komision dhe komisionet tjera, tregon qartë se këtu nuk kemi të bëjmë me vlerësim të punës së organit të pavarur, nuk kemi të bëjmë me vlerësim të raportit vjetor të punës, por nuk kemi as rekomandime, që i drejtohen agjencisë në fjalë apo Kuvendit, si themelues të kësaj agjencie dhe agjencie të tjera. Vetëm kemi deklarime ad-hoc, ashtu siç i kanë kapur deputetët e caktuar në vijat e veta edhe politike, ndoshta edhe më të ngushta, partiake.

Prandaj, efikasiteti i Kuvendit të Kosovës në mbikëqyrjen parlamentare po shihet qartë, se është duke rënë në nivelin teknik dhe jo atë që është, mbikëqyrës dhe politik.

Pak më parë, ne apo Qeveria e Republikës së Kosovës, nëpërmjet Kuvendit dhe këtij komisioni e ka ndërruar edhe Bordin e Rregullatorit të Energjisë. Dhe, sot i njëjti komision vjen me vlerësim pozitiv. Domethënë, fare nuk e ka shqyrtuar vlerësimin e punës së këtij organi të pavarur, fare nuk ka rekomandime dhe kjo shihet qartë, që këtu nuk kemi mbikëqyrje të agjencive të pavarura. Kjo është më shumë, ndoshta, po e ndërlihd edhe me Rregulloren e punës së Kuvendit, sepse ne kemi edhe mos koordinim të pjesëve të ndryshme të raportimit, të dallimit kohor në mes të raporteve që vijnë, sidomos nga auditori gjeneral, Komisioni për Buxhet dhe Financa, periudha kohore ligjore, por edhe vetë periudha vjetore e raportimit.

Prandaj, këto janë disa çështje shqetësuese, që duhet në mënyrën më të shpejtë, nëpërmjet legjislacionit, komisioneve funksionale, por edhe përmes vetë rregullores së re të rregullohen. Përndryshe, roli mbikëqyrës i Kuvendit, do të mbetet vetëm në nivelin figurativ dhe nuk do të mund ta luajmë këtë rol, ashtu siç na takon, sipas Kushtetutës. Falemnderit shumë!

KRYETARI: Zenun, replikë a? Urdhëro, e ke fjalën!

ZENUN PAJAZITI: Falemnderit, shumë zoti kryetar!

Me të vërtetë u shtrua diçka që është esenciale, mendoj më mirë është të shtrohej në një debat për çështje të funksionimit të Kuvendit në përgjithësi, ose në të futej diçka, në ndonjë rregullore të re të punës së Kuvendit. Për sa i përket aprovimit ose mos aprovimit të raporteve të punës, për shumë agjenci, në vitin që shkoi kemi pasur raste kur nuk kemi aprovuar ndonjë raport dhe nuk ka pasur ndonjë hap tjetër konkret, se çka duhet të bëhej më tej.

Por, në rastin konkret, mendoj nëse s'ka edhe ndonjë arsye tjetër, më lejoni të sqaroj, që i kemi përmbushur të gjitha rregullat që janë në trajtimin e raporteve të agjencive të ndryshme.

Komisioni që unë drejtoj, për mendimin tim, ka më së shumti agjenci që i trajton raportet e tyre dhe deputetët, pa dallim politik, kanë qenë jashtëzakonisht shumë të angazhuar në pyetje, në komente, në trajtimin e të gjithë asaj që gjendet brenda materialit të raportit dhe në fund, votohet si raport. Pra, detyra jonë është të trajtojmë gjithë materialin brenda raportit dhe ta aprovojmë ose të mos e aprovojmë atë. Detyra e Komisionit, deri më tani, në përputhje me Rregulloren në fuqi është kjo.

Nëse ne dëshirojmë të bëjmë diçka tjetër, të ndërtojmë një metodë tjetër të mbikëqyrjes së punës dhe zbatimit të ligjit të këtyre agjencive, është çështje krejtësisht tjetër. Mendoj që duhet të bëjmë një grup punues, t'i gjejmë këto. Ne jemi të gjithë të interesuar ta avancojmë performancën e këtyre, duke mbikëqyrë punën e tyre, por mendoj që ne e kemi kryer punën tonë. I falënderoj të gjithë anëtarët e Komisionit, kanë qenë jashtëzakonisht shumë të përkushtuar, në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me punën e

këtij. Ne nuk e kemi trajtuar performancën e anëtarëve të bordit, këtu. Ka pasur mungesë të ndonjë anëtari të bordit, ndërkohë janë plotësuar, por performancën e gjithë këtij Rregullatori, i cili është konsideruar pozitiv dhe po ashtu, një raport i cili ka qenë i përmbledhur në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me këtë rregullator. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Nuk kemi të lajmëruar për diskutim. Në fund votojmë për raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji, për vitin 2011. Votojmë tash!

Prezentë janë 64 deputetë.

Ramizi s'qenka këtu. 54 vota për, 3 kundër, 3 abstenime, Kuvendi miratoi raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2011.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Shqip Muja.

SHIP MUJA: Unë po i shoh kërkesat, zoti kryetar, që është për t' u ndërprerë dhe të vazhdojë nesër, sepse kemi shumë pika. Edhe ashtu nuk do të jemi cilësorë. Prandaj, mund të vazhdojmë nesër nga pika e 16-të, ku jemi... ku kemi mbetur deri në fund. Edhe besoj që të gjitha grupet parlamentare, që kemi folur, janë dakorduar. Falemnderit, zoti kryetar!

KRYETARI: Unë jam dakord për ta vazhduar. Eprem, e ke fjalën.

EQREM KRYEZIU: Falemnderit, zoti kryetar!

Unë veç u entuziazmovava dhe u përkraha juve që ta vazhdojmë, se mund ta kryejmë sot dhe kështu që mos ta humbim. Falemnderit, shumë!

KRYETARI: Falemnderit! “Vetëvendosje”, çka po mendoni? Vazhdojmë. Deputetja Albulenë Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Falemnderit, kryetar!

Edhe ne mendojmë që duhet të vazhdojmë edhe me disa raporte të tjera, pasi që është shumë herët, që tash ta ndajmë seancën. Falemnderit!

KRYETARI: Ardian.

ARDIAN GJINI: Falemnderit, kryetar!

Mendoj se nuk kemi punuar gjatë sot, mund të vazhdojmë. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Falemnderit, kryetar!

Ardiani ka ardhur tash mbas pauze e ne kemi punuar, por prapëseprapë vazhdojmë.

KRYETARI: Vazhdojmë, atëherë vazhdojmë me pikën e gjashtëmbëdhjetë:

16. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2011

Raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2011 e ka shqyrtuar Komisioni Funkcional për Legjislacion dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Raportin vjetor financiar për vitin 2011 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për rekomandim.

Ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Legjislacion, deputetin Arben Gashi. Nuk është këtu. Atëherë, fjalën ia kaloj deputetit Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Në emër të Komisionit dhe në emër të Grupit Parlamentar.

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar raportin, duke vepruar në pajtim me nenin 72 të Rregullores së Kuvendit. Faktikisht, ne jemi njoftuar edhe me raportin, por edhe vetë nga përfaqësuesi i agjencisë, i cili përpos që ka raportuar për punën dhe funksionimin e agjencisë, ka raportuar edhe për vështirësitë e paraqitura në punën e saj, sidomos në pjesën veriore të Republikës së Kosovës, për funksionimin e zyrave jashtë territorit të Republikës së Kosovës dhe për çështje, që kanë të bëjnë me pranimin e kërkesave, përpunimin e tyre dhe vendimmarrjen për to nga Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe për Administrimin e Pronës.

Neve japim përkrahje në parim, ashtu siç ka rekomanduar edhe Komisioni për Legjislacion. Ju falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Nga PDK-ja, Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Falemnderit, zoti kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 25 prill e ka shqyrtuar Raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2011 dhe ka vlerësuar se raporti financiar i AKP-së, i dorëzuar në Kuvend, nuk është i plotësuar ashtu siç e kërkojnë rregullativat ligjore, sepse nuk janë paraqitur buxheti, ashtu siç është miratuar dhe siç është shpenzuar, sipas kategorive ekonomike.

Domethënë, nuk janë të paraqitura as nënkategoritë ekonomike, kështu që ka kërkuar një raport plotësues nga Agjencia Kosovare e Pronës, sepse këto gjëra të cilat nuk janë paraqitur nga Agjencia Kosovare e Pronës kërkohen edhe me ligj.

Në Raportin financiar të shpenzimeve për vitin 2011 të AKP-së, janë pasqyruar të hyrat nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe të hyrat nga donatorët si dhe shpenzimet e atyre mjeteve, mirëpo nuk kanë qenë të detajizuara, siç janë planifikuar. Prandaj, Agjencia e Pronës e ka sjellë raportin shtesë, i cili është shqyrtuar nga ana e Komisionit për Buxhet dhe Financa, sërish dhe sipas raportit shtesë, shihet se Agjencia e Pronës ka pasur në shfrytëzim buxhetin prej 2 milionë e 23 mijë e 625 euro, ndërsa ka shpenzuar 1 milion e 817 mijë e 609 euro.

Buxheti është shpenzuar 90% dhe njëkohësisht në bazë të një marrëveshjeje apo memorandumit të mirëkuptimit, kjo agjenci me Ministrinë e Financave ka shpenzuar edhe një pjesë të të hyrave vetjake.

Po ashtu, kjo agjenci ka pasur një përkrahje nga donatorët, ku janë planifikuar që këto donacione të jenë diku 2 milionë e 947 euro, ku nga kjo çka është planifikuar, janë shpenzuar 1 milion e 532 mijë e 43 euro. Domethënë, është fjala për pjesën që e kanë pasur nga donacionet.

Agjencia Kosovare e Pronës në raportin, të cilin e ka sjellë shtesë, që i është bashkëngjitur raportit me rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa, më datë 2 maj është shqyrtuar nga Komisioni për Buxhet, tanimë i plotësuar dhe unanimisht është përkrahur nga Komisioni, domethënë, nga të gjithë anëtarët e Komisionit, prandaj rekomandojmë që të miratohet edhe në seancën plenare.

KRYETARI: Në emër të “Vetëvendosjes”, deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Falemnderit, kryetar!

Fillimisht dua të potencoj faktin, që ndër elementet më të rëndësishme të pavarësimit të një vendi është procesi i dekolonizimit. Pra, e drejta e një populli që t’i rikthehet prona. Mirëpo, ajo çka ka ndodhur deri më tani, është që Agjencia Kosovare e Pronës, bashkë me Agjencinë Kosovare të Privatizimit e bëjnë saktësisht të kundërtën, pra shpronësimin e plotë të Kosovës, duke injoruar komplet faktin, që Kosova ka qenë nën pushtim.

Në kapitullin e parë të po këtij raporti, thuhet që AKP-ja është themeluar sipas Rregullores së UNMIK-ut, të vitit 2006/10 dhe pastaj me Rregulloren 2006/50 dhe që nga 31 dhjetori 2008 funksionon në bazë të ligjit nr.03-L/079 të Kuvendit të Kosovës, por problemi qëndron se ky ligj nuk e ndryshon natyrën dhe funksionimin e kësaj agjencie.

Më pastaj, thuhet që AKP ka mandat t’i zgjidhë kërkesat pronësore dhe të drejtën e shfrytëzimit për pronën e patundshme private, përfshirë pronat komerciale dhe token bujqësore e që janë rezultat i konfliktit të armatosur.

Pra, përveç që luftën në Kosovë e quan “konflikt të armatosur” edhe e përkufizon atë.

Më tej, thuhet që janë pranuar 41 mijë kërkesa, ku 90% e të cilave janë pranuar nëpërmjet të zyrave të AKP-së në Serbi. Gjithashtu edhe ish- Drejtoria për Çështje Pronësore nuk është marrë me trajtimin e uzurpimit të banesave nga periudha e viteve të 90-ta, pra nuk është marrë fare me rastet kur qytetarët shqiptarë humbnin pronat e tyre, pasi që i largonin nga puna.

Pra, kjo agjenci, në vend që të merret me trajtimin e thellë, por edhe të drejtë të pronave, deri më tani veprimtaria e kësaj agjencie ka qenë dhe mbetet vazhdimi i politikës së kolonizimit.

Pra, çështja e pronave, ne mendojmë që duhet rishikuar duke pasur parasysh parimet e dekolonizimit, origjinën e pronave, pasi që ajo do të duhej të ishte e shenjtë për të gjithë, gjë që nuk po ndodh.

Gjithashtu, duhet të theksojmë faktin, që në shkurt të vitit 2000, nga veriu i Mitrovicës janë dëbuar 11 mijë e 564 shqiptarë dhe, ato prona të shqiptarëve, sot i shfrytëzojnë serbët atje. Pra, ky proces është dashur të shikohet detajisht e jo të bëhen prioritet pronat e serbëve e që nuk janë të tyre, sepse asnjëherë nuk u shikua origjina e tyre.

Pra, për këto arsye ne, nuk do të votojmë për këtë raport. Falemnderit!

KRYETARI: Në emër të AAK-së, kryetari Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Falemnderit, zoti kryetar!

Më lejo që për nja 30 sekonda të shmangem pak prej pikës së rendit të ditës. Disa herë në Kuvend të Kosovës, e së fundi edhe nga deputetja Myzejene Selmani është përmendur se kemi të bëjmë me linjën interaktive Kosovë-Shqipëri. Vetëm sa mos të shkruaj dikush në gazetë, për të na thënë që s'po dimë çka po flasim, kemi të bëjmë me linjë interkonektive. Është linjë interkonektive 400 kilovoltëshe, jo interaktive, ndoshta është intriguar prej "Interaktivit" në Koha-vizion të Xhemës, po kemi të bëjmë me linjë interkonektive edhe njëherë.

Tani po kthehem në temë. Këtë e thashë vetëm sa mos të na thotë dikush që krejt deputetët s'po dinë për çka po flasim, se na mbyten gazetatat.

Te raporti, të cilin e kemi duke shqyrtuar në fjalë, raporti i Agjencisë Kosovare të Pronës, definitivisht se ne mendojmë se duhet të votohet raporti, për shkak se përkundër atyre që u thanë dhe që pjesa dërmuese e atyre që u thanë qëndrojnë, Agjencia si agjenci e ka kryer një punë të mirë.

Unë do ta them vetëm një aspekt të kësaj çështjeje, për të cilën ne po flasim sot. Më përpara e përmenda se është viti 2012 dhe shumë shtete, disa çështje për të cilat ne po diskutojmë i kanë zgjidhur në fillim të shekullit të kaluar e ekzakt gati njëjtë kemi të bëjmë edhe me këtë çështje. Në Kosovë, sot duhet të ekzistojë një agjenci e shtetit, i cila merret me menaxhimin e pronave private. Në përkthim kjo do të thotë, që në Kosovë nuk është e mundshme, që çdo qytetar ta menaxhojë vetë pronën private, por duhet të ekzistojë një agjenci e shtetit, e cila i menaxhon ato.

Për shkak të pamundësisë së menaxhimit nga vetë individët, pa marrë parasysh se cilat janë kontestet pronësore, pa marrë parasysh se kush ka të drejtë ose jo, pa marrë parasysh se cili do të mund të ishte vendimi i gjyqit, për të drejtën pronësore të dikujt, përkthimi është se në Kosovë ka nevojë që të kemi agjenci për t'i menaxhuar pronat private, të cilat individët ose qytetarët e Kosovës nuk mund t'i menaxhojnë vetë. Dhe, kjo duhet të jetë temë preokupimi për institucionet e Kosovës, jo vetëm për Agjencinë Kosovare të Pronës, por për gjithë Kosovën dhe mendoj se definitivisht Kosova do të ballafaqohet me një temë, një ditë në rrugën e vet drejt integritit në Unionin Evropian, nëse do të besojë

se në Kosovë, gjithkush ka të drejtë në pronën e vet, se prona është e pacenueshme dhe se nuk do të duhej të ketë agjenci të posaçme për menaxhim të asaj prone.

Ne do ta votojmë raportin, për shkak se, edhe njëherë po e them, mendojmë se përkundër të gjitha atyre që u thanë, agjencia si agjenci po e kryen punën e vetë si duhet. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit, deputet!

Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Suzan Novoberdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Falemnderit, kryetar!

Edhe Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar raportin e Agjencisë Kosovare të Pronës, të njëjtin do ta përkrahim. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit!

Nga SLS-ja nuk ka. Nga “6+”-i nuk ka.

Atëherë, fjalën e ka kërkuar deputeti nga Malisheva, Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Falemnderit, kryetar!

Unë nuk e kërkoja në emër të Malishevës, por në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, sepse më kanë ngarkuar që të flas me këtë rast dhe të jap pëlqimin dhe vlerësimin për këtë raport, të cilin edhe në grupin tonë parlamentar, sepse nga grupi ynë nuk u paraqit dikush, kështu më kanë ngarkuar, një mesazh e kam marrë kështu.

Edhe, nga që e kemi shqyrtuar, kam një perceptim se aty janë identifikuar shumë probleme, janë vërejtur shumë sfida, të cilat i ka agjencia dhe ne këtë agjenci e inkurajojmë që t'i tejkalojë këto sfida dhe e përkrahim raportin duke iu uruar punë të mbarë dhe Zoti e ndihmoftë këtë agjenci!

KRYETARI: Numër s'kemi për të votuar. Po vazhdojmë pikën e shtatëmbëdhjetë:

17. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit të Aviacioni Civil të Kosovës, për vitin 2011

Raportin vjetor i Agjencisë të Aviacionit Civil të Kosovës, për vitin 2011, e ka shqyrtuar Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka shqyrtuar Raportin vjetor financiar për vitin 2011 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Kryetari i Komisionit nuk është këtu. Fjalën e ka deputetja Tetuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Falemnderit, kryetar!

Pasi jam zëvendëskryetaria e parë, po e paraqes qëndrimin e Komisionit.

Raporti vjetor i punës së Autoritet të Aviacionit Civil të Kosovës, për vitin 2011, ka arritur në Komision dhe është shqyrtuar me kujdes të madh.

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në bazë të nenit 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 17 prill 2012 e ka shqyrtuar Raportin vjetor të AAC-së dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë rekomandimin, që ky raport vjetor të aprovohet me arsyetim se raporti me rekomandimet është analizuar me kujdes në komision. Në komision kanë marrë pjesë deputetët e të gjitha partive. Ka qenë një debat bukur i gjerë, me shumë pyetje dhe me shumë përgjigje prej autoriteteve, prej zyrtarëve të Autoritetit të Aviacionit Civil dhe si të tillë, raportin e rekomandojmë që të aprovohet në Kuvend.

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti)

KRYESUESI: Falemnderit, zonja deputete!

Tash në emër të Komisionit për Buxhet, sa marr vesh unë, do të flasë Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Falemnderit, nënkryetar!

Unë do të flas në emër të Komisionit për Buxhet dhe do t'i them edhe disa fjalë në emër të Grupit Parlamentar, nëse më lejohe, që të shkojmë më shpejtë.

Komisioni për Buxhet dhe Financa në mbledhjen, që ka mbajtur më 2 maj e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil dhe ka vlerësuar se në raportin e Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2011 janë pasqyruar shpenzimet për të gjitha kategoritë ekonomike të shpenzimeve.

Po ashtu, në raport janë prezantuar edhe të hyrat e realizuara nga veprimtaria e Autoritetit të Aviacionit Civil nëpërmjet tarifës së certifikimit dhe licencimit dhe taksës së sigurisë së udhëtarëve, që tregon një performancë më të mirë të këtij autoriteti, krahasuar me dy vjetët e kaluara.

Nga 756 mijë e 903 euro, sa kanë qenë të buxhetuara, Autoriteti i Aviacionit Civil ka shpenzuar 715 mijë e 326 euro, që shprehur në përqindje shohim se ka shpenzuar 94.51% të mjeteve.

Më rastin e shqyrtimit të raportit në Komision u sqarua se çështja e buxhetimit, prokurimit dhe financave janë të përmbledhura në një doracak të procedurave të Autoritetit të Aviacionit Civil, të cilat zbatohen nga personaliteti përgjegjës në këtë fushë.

Një çështje që është ngritur, po ashtu në Komisionin për Buxhet, është çështja e pagesës së shumave për qiranë, çka kërkohet që vërtet të bëhet një zgjidhje që të vendosen në institucionet, në hapësira ku nuk paguhet qira në mënyrën siç po paguhet dhe ne si Komision për Buxhet, dua t'u them që pothuajse për të gjitha këto agjenci të pavarura, por edhe për disa institucione tjera, të cilat janë të vendosura dhe po paguajnë qira të mëdha, kemi apeluar që vërtetë të bëhet një zgjidhje që këto shpenzime të qirasë të zvogëlohen dukshëm.

Megjithatë, në saje të ndërrimit të objektit që kanë bërë ky autoritet ka arritur deri te zvogëlimi në një masë i këtyre shpenzimeve, por megjithatë, ende qëndrojnë të larta.

Nga raporti, pasi që janë ngritur disa çështje në Komision, anëtarët e Komisionit në fund janë pajtuar njëzëri që ky raport të miratohet, pasi që përmbushen çështjet kryesore, të cilat janë të parapara edhe me Ligjin për aviacionin civil, por njëkohësisht edhe me Ligjin për menaxhimin e financave publike.

Po ashtu edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar këtë raport dhe ka vlerësuar që në përgjithësi janë paraqitur të gjitha çështjet të cilat janë të parapara me ligjet përkatëse.

Po ashtu, vërehet një performancë më e mirë e punës në këtë autoritet dhe e përkrah raportin në përgjithësi. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Teuta Sahatqija, në emër të LDK-së,.

TEUTA SAHATQIJA: Falemnderit, nënkryetar!

Autoriteti i Aviacionit Civil ka sjellë një raport të mirë, me shumë shënime dhe ka përgjigje në shumë pyetje të deputetëve.

Për dallim nga raporti i vitit të kaluar, ky raport ka të arritura të reja, që janë inkurajuese për Kosovën, por ka edhe çështje të cilat vazhdojnë të zvarriten pa u zgjidhur për shumë vjet.

AAC-ja është organ që vetëfinancohet nga taksat, si ai në shërbime të navigacionit, sigurimin e pasagjerëve, tarifat e certifikimit, licencimit, donacione, grande e tjera, gjë që paraqet që AAC-ja nuk është barrë e Buxhetit të Kosovës.

Lajm i mirë paraqet edhe ai i infrastrukturës ligjore dhe harmonizimi i saj me atë të Bashkësisë Evropiane. Ndarja e zlotëve tashmë është rregulluar, është trajtuar në Komision Evropian dhe paraqet çështje të mbyllur.

Shenja “Z-6” është propozuar nga Qeveria dhe shpresojmë që Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit dhe Organizatës për Standardizim Ndërkombëtar të Aviacionit, do të pranojë këtë shenjë të identifikimit të Kosovës në lëmin e Aviacionit.

Serbia, përveç pengesave për shenjën identifikuese, ka tentuar ta vë edhe një taksë ilegale, e cila fatmirësisht është eliminuar. Problem vazhdon të paraqesë pamundësia e marrëveshjeve kontraktuale me shtetet e BE-së, pasi AAC-ja vazhdon të mos ketë qasje në të dhënat e Agjencisë Evropiane të Sigurisë.

NATO vazhdon të kontrollojë hapësirën e lartë ajrore dhe tani ka rekomanduar Hungarinë, si shtet anëtarë të jetë partner, i cili do të kontrollojë këtë hapësirë, të cilën Kosova ende nuk e ka në menaxhim.

Në raport thuhet se shërbimet e CARGO-s kanë rënë në 16%, ndonëse tarifat për CARGO janë në nivel të regjionit. Edhe në këtë raport, si në atë të kaluarin, shihet se biznesi, i cili shfrytëzon CARGO-n ka rënë. Pasi ambienti biznesor e jo tarifat, jo vetëm që nuk përmirësohet, por statistikisht e ndryshme nëpër raporte tregojnë një gjendje të rëndë të ambientit biznesor. Fusnota, as në paraqitjet e AAC-së, nuk i ka sjellë ndonjë dobi Kosovës, sepse vazhdon e njëjta mënyrë e përfaqësimit të këtij organi në takimet regjionale. Në raportin e vitit të kaluar patëm marrë informatën se Aeroporti i Gjakovës, i cili menaxhohet nga KFOR-i italian dhe financohet nga Qeveria italiane, së shpejti do të jetë në menaxhimin vendor.

Nga viti i kaluar deri në raportimin e sivjetmë nuk ka asnjë përparim dhe Aeroporti i Gjakovës, i cili do të duhej të shërbente si aeroport alternativ, vazhdon të jetë jashtë kompetencave të shtetit të Kosovës.

Raporti si raport meriton të votohet duke pasur parasysh që ka mjaftë pengesa dhe mungesa të cilat shpresojmë që në raportin e ardhshëm do të jenë të eliminuara. Falemnderit!

KRYESUESI: Grupi i “Vetëvendosjes”, Alma Lama.

ALMA LAMA: Falemnderit, zoti kryesues!

Edhe grupi jonë parlamentar e ka shqyrtuar këtë raport dhe duke qenë se nuk kemi konstatuar vërejtje esenciale në lidhje me raportin, ne do ta votojmë. Natyrisht, që ka pengesa të jashtme për funksionimin e këtij institucioni, mirëpo kjo kërkon angazhimin edhe të shumë institucioneve të tjera në Kosovë, në mënyrë që të përmirësohet puna. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit, zonja Lama! Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, kryetari i Grupit Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Falemnderit, zoti nënkryetar!

Mendojmë se raporti duhet të kalojë, po ashtu, mirëpo deri në raportin e vitit tjetër ose edhe më herët, Qeveria e Kosovës, u tha pak më përpara, vetëm një “eko” po e bëj, duhet të na tregojë se a ka implikime nga marrëveshja për koncesionimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, në lidhje me Aeroportin e Gjakovës? Mendojmë se kjo është një temë, e cila duhet të sqarohet në Kosovë, për shkak se e dimë se në vende të rajonit, ka pas implikime serioze për aeroportet alternative, koncesionimi i aeroporteve kryesore të shtetit.

Sidoqoftë, mendojmë se ky raport si i tillë duhet të kalojë, ka qenë preciz dhe këto tema ne duhet t'i zgjidhim edhe në forume të tjera të institucioneve të Kosovës. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit, zoti Gjini! Koalicioni Kosova e Re, Myzejane Selmani, shefe e Grupit.

MYZEJENE SELMANI: Falemnderit, zoti nënkryetar!

Koalicioni për Kosovën e Re ka shqyrtuar raportin vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës. Duke marrë parasysh se ky autoritet, që nga formimi është duke punuar me persona shumë profesionalë, mund të them se është raporti i katërt që vjen brenda Kuvendit të Kosovës dhe me gjithë të drejtën në bazë ligjit, është raport shumë i mirë. Mirëpo, pengesat, shihet që prapëseprapë ekzistojnë për Kosovën, duke marrë parasysh se NATO-ja është ajo e cila kontrollon hapësirën ajrore.

Mirëpo, duhet të kemi mundësi edhe të tjera që në këtë raport shihen mjaftë qartë disa pengesa që i paraqiten shtetit të Kosovës. Shpresojmë dhe besojmë shumë shpejt, që këto marrëveshje teknike, të cilat u arritën dhe do të arrihen më vonë, që të kenë zbatueshmëri për arsye se zonja Teuta e tha mjaft mirë, çfarë dëmi i ka bërë Serbia vetë Kosovës, për arsye se ajo mendon se është mbi autoritetin tonë.

Komisioni Evropian e ka përkrahur këtë aviacion dhe i ka dhënë notë shumë pozitive dhe njëkohësisht ka kërkuar që gjatë punës së tij t'i zbatojë të gjitha ligjet të cilat janë të miratuara në Kuvend të Kosovës.

Njëkohësisht, mund të them se zotëri Gjini e potencoi një pikë shumë të ndjeshme, çështja e dhënies me koncesion e Aeroportit “Adem Jashari”, ndërsa, do të ketë edhe aeroporte tjera alternative. Shembulli më i mirë është shembulli i Tiranës, i cili jep të tregojë që ndoshta këto aeroporte tjera edhe për arsye tjera nuk do të mund të funksionojnë, mirëpo, mbetet në të ardhmen që Qeveria të jep sqarime.

Koalicioni për Kosovë të Re edhe një herë thashë është raporti i katërt që vjen, është raport shumë i mirë dhe shumë profesional, mirëpo mbetet përgjegjësi e Qeverisë që të japë sqarime tjera. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! SLS nuk është paraqitur. Grup “6+” nuk është paraqitur. Deputeti Agim Kuleta e ka fjalën.

AGIM KULETA: I nderuar nënkryetar,

Deputetë të nderuar,

Raporti i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës në përgjithësi është një raport i konceptuar dhe i shkruar mirë. Nga ky raport kemi vërejtur që AAC-ja ka përmbyllur kompletimin e kornizës legislative për ushtrim të plotë të funksioneve që ia jep ligji.

Këtu përfshihen edhe rregulloret që bëjnë implementimin e rregulloreve dhe direktivave përkatëse të BE-së, në rendin ligjor të Republikës së Kosovës, si detyrim që rrjedh nga Marrëveshja për hapësirën e përbashkët evropiane të aviacionit.

Është shumë e rëndësishme, që edhe këtë vit, njësoj si vitin e kaluar, Komisioni Evropian në Raportin e Progresit e ka vlerësuar pozitivisht punën në fushën e aviacionit civil.

Nga raporti, gjithashtu vërehet që janë kryer një numër i madh i inspektimeve dhe auditimeve të operatorëve të aviacionit civil në Republikën e Kosovës, duke përfshirë aeroportin, ofruesin e shërbimeve të navigacionit ajror dhe kompanitë e huaja ajrore.

Në këtë pikë, ne inkurajojmë Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, që ta intensifikojë edhe më tepër ritmin e inspektimeve, me qëllim të fitimit të një garancie që të gjithë këta operatorë i zhvillojnë aktivitetet e tyre në përputhje me standardet më të larta të sigurisë.

Kjo është një fushë shumë e ndjeshme dhe për këtë arsye kërkon përkushtim dhe ekspertizë të veçantë nga personeli përgjegjës.

Me kënaqësi kemi vërejtur bashkëpunimin shumë të ngushtë ndërmjet këtij autoriteti me autoritetet e aviacionit civil të rajonit e në veçanti me atë të Republikës së Shqipërisë.

Në këtë drejtim është për t'u përshëndetur fakti që inspektorët e AAC-së së Republikës së Kosovës, së bashku me ata të Republikës së Shqipërisë, kryejnë inspektime të përbashkëta të sigurisë të të gjithë operatorët në të dy vendet.

Pra, inspektorët e AAC-së së Kosovës kryejnë inspektime të operatorëve në Republikën e Shqipërisë, në emër të autoriteteve të Republikës së Shqipërisë dhe anasjelltas.

Nga raporti del qartë që autoriteti ynë i aviacionit ende nuk është i pranuar si partner i barabartë me autoritetet e shteteve të tjera dhe shkak për këtë është mungesa e marrëdhënieve kontraktuale me institucionet e BE-së.

Ndërkohë, që nga ky raport, po ashtu nuk vërehet ndonjë përfitim për institucionet tona të kësaj fushe nga Marrëveshja për bashkëpunim dhe përfaqësim rajonal e 24 shkurtit.

Përfundimisht, mendojmë që është një raport i mirë dhe që gjithashtu pasqyron një punë të mirë të Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2011. Falemnderit!

(Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Jakup Krasniqi)

KRYETARI: Falemnderit! Të lajmëruar s'ka më për diskutim. Numrat s'i kemi. Vazhdojmë me debatet!

A e kryejmë pikën 18 e 19 dhe i lëmë ato tjerat për nesër?

18. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2011.

Raportin vjetor i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, për vitin 2011 e ka shqyrtuar Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin vjetor financiar për vitin 2011 dhe Kuvendit i rekomandon për miratim.

Fjalën e ka deputetja Teutë Sahatqija, në emër të Komisionit.

TEUTA SAHATQIJA: Falemnderit, kryetar!

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në bazë të nenit 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2012, e ka shqyrtuar Raportin vjetor të punës, për vitin 2011, të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqet këtë rekomandim: - të miratohet Raporti vjetor i punës, për vitin 2011, të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave.

Në bazë të nenit 38, paragrafi 4, të ligjit 04-L/063 për hekurudhat e Kosovës, Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave i paraqet Kuvendit Raportin vjetor të punës.

Ne, si komision e kemi analizuar. Ka qenë një analizë dhe një debat bukur i gjerë, prej të gjitha grupeve parlamentare dhe mendojmë si Komision, që ky raport duhet të aprovohet nga Kuvendi.

KRYETARI: Falemnderit! Safete, a do fjalën? Në emër të grupit, Safete Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Falemnderit, kryetar!

Po i them dy fjalë në emër të Komisionit dhe po ashtu edhe në emër të Grupit Parlamentar.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Raportin e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, më datën 25 prill dhe njëzëri e ka përkrahur këtë raport.

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave e ka sjellë raportin të detajizuar, krahas me raportin, të cilin e ka sjellë, raportin e punës, ia ka bashkëngjitur edhe një raport plotësues, ku anëtarët e Komisionit kanë pasur mundësi që t'i verifikojnë të gjitha shpenzimet, në bazë të asaj që është planifikuar, sepse të dhënat janë paraqitur në mënyrë të detajizuar.

Ky autoritet i ka pasur të planifikuar 155 mijë e 281 euro dhe ka shpenzuar 147 mijë e 36 euro, çka do të thotë se ka shpenzuar 91.6% buxhetin.

Komisioni rekomandon që të miratohet raporti financiar. Po ashtu, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka shqyrtuar raportin e punës së Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave dhe e përkrah këtë raport, çka do të thotë se ftojmë deputetët, që të votojnë pro.

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të LDK-së, Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Ky raport është analizuar edhe në Komision, po edhe nga deputetët e LDK-së, që janë pjesë e Komisionit.

Mendojmë që ky raport është një raport bukur teknik. Nuk paraqet ndonjë vizion për zhvillimin e këtij sektori të hekurudhave. Në raportin financiar shihet një rritje e madhe e shpenzimeve për rroga. Prej 30.000 në 70.000 euro prej vitit paraprak, e cila nga zyrtarët e këtij autoriteti u arsyetua me mungesën e mëhershme të personelit.

Infrastruktura apo aktet nënligjore, ende nuk janë të kompletuara dhe kuptuam se mungon Rregullorja për dhënien e licencave, ndonëse ende askush, siç na thanë, nuk ka parashtruar kërkesa për licenca, por kjo nuk e arsyeton mungesën e aktit nënligjor.

Infra-KOS-i dhe Train-KOS-i janë organizata, të cilat menaxhojnë hekurudhat e Kosovës dhe thuhet që ndarja e aseteve është kryer.

Gjithashtu, thuhet që Train-KOS-i është i përgatitur për të hyrë në partneritetin publiko-privat, gjë e cila nga biseda e pamë që ende nuk është e përgatitur në masë të duhur për këtë partneritet.

Në raport mungon përshkrimi i gjendjes së linjave: Leposaviq-Mitrovicë, Podujevë-Prishtinë dhe nuk ka krahasime për shfrytëzimin e transportit hekurudhor ndërmjet viteve të kaluara dhe të këtij viti.

Ende makinistët nuk kanë zëvendës në vendet e tyre të punës dhe duke pasur parasysh rëndësinë, atëherë mendojmë që kjo mund të jetë edhe rrezik për sigurinë e udhëtarëve.

Kyçjet ilegale të rrugëve, që kryqëzohen me hekurudhë, vjedhja e binarëve të hekurudhës, vazhdon të paraqet problem dhe mundësi për aksidente të rënda dhe rrezik për sigurinë e udhëtarëve.

Raportin do ta votojmë për, por presim që në të ardhmen të kemi një raport më përmbajtësor, me më shumë shënime, më shumë tabela, më shumë analiza dhe më shumë rezultate të arritura. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të “Vetëvendosjes”, deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Falemnderit, zoti kryetar!

Përpara se të flas për raportin në fjalë do të doja ta tërheq vërejtjen për numrin e madh të raporteve, të cilët është vendosur të shqyrtohen brenda një seance. Janë tetë raporte dhe 23 pika rendi dite, gjithsej. Nuk mendoj që puna e Kuvendit bëhet mirë duke i futur kaq shumë raporte brenda një seance. Në të vërtetë ne bëjmë punë sipërfaqësore në qoftë se të gjitha këto i lëmë për një ditë. Mendoj që duhet të bëhen ndoshta më shpesh seanca dhe të shqyrtohen dhe të mbikëqyret më mirë puna e institucioneve. Ky është mendimi im, ju mund të keni mendim tjetër dhe besoj mendimi juaj ka ecur përpara përderisa është caktuar kështu.

Mirëpo, unë nuk mendoj që po luajmë rolin mbikëqyrës që i takon Kuvendit. Tetë raporte t’i shqyrtohen brenda një – dy ore nuk mendoj që është, po bëjmë punë të mirë.

Së dyti kam vënë re deri tani që nga të gjitha komisionet, të cilat shqyrtojnë raportet e institucioneve përkatëse, në Kuvendin e Kosovës, ose në seancë nuk ka ardhur asnjë raport i cili nuk është rekomanduar të votohet. Edhe kjo ngre shumë pikëpyetje, sepse ne kemi parë që ka raporte të cilët nuk e meritojnë të votohen për shkak të performancës së dobët të institucioneve. Të mos harrojmë që këto janë raporte, të cilat përgatiten nga vetë institucionet, të cilët janë të lirë të lavdërojnë punën e tyre ashtu sikurse kanë dëshirë dhe jemi ne pikërisht deputetët që do të duhej të ishin pak më kritik në lidhje me këto raporte.

Së treti, ne duhet të shqyrtojmë performansën e institucioneve jo vetëm çfarë shkruhet në letër. Në rast se flasim për raportin konkret për Hekurudhat e Kosovës nuk kemi çka të flasim, gjendja ose performansa e Hekurudhave të Kosovës është në nivel gati të relikteve të së shkuarës, performanca është shumë, shumë e dobët në gjithë territorin e Kosovës. Pothuajse janë inekzistente, ndërsa në pjesën veriore të Kosovës, ato janë krejtësisht jashtë kontrollit. Kështu që po bëjmë punë krejtësisht formale dhe nuk e shoh të arsyeshme që të votohet një raport i tillë, aq më tepër që nuk është shkruar ashtu sikurse duhet. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Deputete, rendi i ditës është bërë me dy anëtarë edhe të Grupit të Lëvizjes “Vetëvendosjes” dhe me gjithë shefat e grupeve parlamentare dhe nuk ka pasur vërejtje në këtë drejtim. Pastaj, nuk është e thënë që seanca të përfundojë brenda një dite apo brenda 4-5 ore. Seanca mund të vazhdojë edhe një javë të tërë, kështu që pse rendi i ditës i ka 23 pika nuk e arsyeton kalimin shkel e shko mbi raportet.

Vazhdojmë! Në emër të AAK-së kryetari i grupit deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Falemnderit, zoti kryetar!

Fillimisht duhet të them se po flasim për Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave dhe në dukje duket edhe oksimoron, për të cilat hekurudha po flasim.

Në Kosovë funksionon efektivisht, do të thotë pa problem vetëm një linjë hekurudhore, linjat tjera nuk funksionojnë fare ose funksionojnë jashtëzakonisht pak shumë rrallë, dhe atë jo për transport të rregullt. Raportin duhet ta kalojmë për shkak se këta të shkretë çka kanë pasur të shkruajnë në raport, çka të thonë, të tregojnë çka kanë, çka po ndodh. Mirëpo, ky është një refleksion i asaj se cilat caqe i qet Kosova, ose cilat caqe i qet Qeveria e Kosovës për zhvillimin e hekurudhave? Më duhet t’ju them me shumë saktësi, ndoshta jo 100%, por me shumë saktësi, i kam hulumtuar disa rajone ish-koloni, të cilat në fund të shekullit të XIX, tani nuk po flas për shekullin e kaluar, po për një shekull më përpara në vitet 1870, për km² kanë pasur më tepër hekurudha dhe kanë pasur transport të mallrave dhe të udhëtarëve dhjetëra herë më të madh se Kosova që ka në vitin 2012, do të thotë në dekadën e dytë të shekullit XXI.

Tani edhe ky është njëfarë parametri që tregon se ku jemi. Unë nuk po dua të them se ka mund të bëhet ndonjë mrekulli për pak vjet, mirëpo ajo që është e rëndësishme të thuhet është se nuk ka ende caqe. Kosova nuk po e sheh realisht si prioritet zhvillimin e hekurudhave edhe mendoj se për zhvillimin ekonomik të vendit është mëkat. Hekurudhat do të ishin rrugë shumë më e shkurtër për zhvillimin ekonomik se sa rrugët e tjera të

transportit, të cilat po ashtu duhet të them se janë të domosdoshme. Sidoqoftë, raportin duhet ta votojmë se s'kanë pas tjetër çka të shkruajnë, mirëpo duhet të konstatohet se gjendja në hekurudhat e Kosovës është sikur në vendet më të pazhvilluara të globit në shekullin XIX dhe ende nuk ka caqe të sakta se ku do të shkojë Kosova dhe nuk ka plane se për sa kohë dhe me sa mjete do të mund të realizoheshin ato caqe. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja e grupit Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Falemnderit, kryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re ka shqyrtuar Raportin e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, i cili është themeluar në bazë të Ligjit të hekurudhave të Kosovës, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, në qershor të vitit 2008.

Në rast se e marrim punën e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave mund të themi se është një raport shumë i thatë, përshkruan çështjen e departamenteve edhe përshkruan çështjen e ndarjes së hekurudhave në dy kompani të regjistruara, mirëpo në thelb nuk është ku ta di çfarë raporti dhe s'ki çka diskuton për të. U fol edhe nga parafolësit që shihet se si është gjendja e hekurudhave dhe këta zotërinjtë as nuk kanë pasur ndoshta tjetër mundësi çka të bëjnë në këtë autoritet. Mirëpo, shpresojmë që në të ardhmen edhe ekzekutivi edhe legjislativi edhe Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave dinë çka kërkojnë nga vetvetja dhe të mbërrijnë aty ku duhet mbërri.

Koalicioni për Kosovë të Re edhe njëherë thashë nuk ka sanksione për një Autoritet Rregullativ në rast se i kthehet raporti, atëherë është e rrugës që t'i jepet një përkrahje. Falemnderit!

KRYETARI: Në emër të SLS-së s'ka të lajmëruar, në emër të "6+"jo. Të lajmëruar nuk ka për diskutim. Përfunduar dhe pikën e 18 të rendit të ditës.

Po vazhdojmë dhe me pikën e 19

19. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2011

Raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2011 e ka shqyrtuar Komisioni Funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Raportin vjetor financiar për vitin 2011 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim. Ftoj kryetarin e Komisionit Funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, deputetin Idriz Vehapi për arsyetimin e raportit me rekomandime.

IDRIZ VEHAPI: Falemnderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Në bazë të nenit 19 të ligjit nr. 03 L192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i paraqet Kuvendit të Kosovës raport vjetor të punës. Komisioni Funkcional në mbledhjen e mbajtur, më 25.4.2012 e ka shqyrtuar raportin vjetor të punës për vitin 2011 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Komisioni e ka vlerësuar se raporti vjetor i punës për këtë vit, i parashtruar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është në pajtim me nenin 19 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe i rekomandon Kuvendit për miratim. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Partisë Demokratike deputetja Xhevahire Izmaçu.

XHEVAHIRE IZMAKU: Falemnderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i partisë tonë e ka vlerësuar raportin si një raport real dhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës shihet që brenda këtyre viteve ka evoluar me një kualitet më të lartë në kryerjen dhe funksionimin e punëve, të cilat i ka si obligime dhe në bazë të ligjit që funksionon.

Pra, është një raport i cili do të votohet për nga Partia Demokratike, ndërsa unë si deputete kisha dashur t' i them vetëm pak fjalë lidhur me punën që e ka kryer brenda kësaj periudhe, mirëpo edhe lidhur me shqetësimin që e kanë sjell te deputetët e Komisionit lidhur me një vendim që është shumë i çuditshëm që tani i vjen Komisionit, Këshillit si organ i pavarur pra, dhe këtë vendim e sjell Gjykata Supreme. Është një vendim interesant ku thuhet që të gjitha vendimet tash e tutje nuk do të kenë pra kurrfarë roli dhe nuk ka mundësi të ekzekutohen. Është shumë e çuditshme, pasi që Këshilli i Pavarur është kategori kushtetuese dhe ka një ligj që funksionon. Pra, në këtë drejtim Gjykata Supreme interpreton diçka që duhet ta interpretojë realisht Gjykata Kushtetuese dhe në këtë drejtim ne tash e tutje si Komision do të shikojmë nëse me të vërtetë Gjykata Supreme e sjell një vendim të tillë, atëherë çfarë efekti do të ketë funksionimi i mëtutjeshëm i Këshillit.

Mirëpo, sot ne do të votojmë pro, ndërsa në komision sigurisht bashkë me anëtarët e subjekteve tjera do të shikojmë pasi që Këshilli ka performuar shumë pozitivisht edhe duhet të ekzistojë, në këtë drejtim ne do të ndërmarrim masa dhe të shikojmë se duhet, ose të ndryshohet ligji, ose çka më tutje, mirëpo jo të përfundojë mandati i Këshillit. Falemnderit!

KRYETARI: Në emër të LDK-së, deputeti Eqrem Kryeziu e ka fjalën.

EQREM KRYEZIU: Falemnderit!

Natyrisht, unë jam në atë Komision, për të cilin foli edhe Xhevahirja edhe në fakt ne shpeshherë po gjendemi në një pozitë pak paradoksale. Nuk po kemi çka t'i bëjmë

raportit, mirëpo realiteti është shqetësues. Pra, realiteti i atij Komisioni, asaj agjencie që e mbikëqyr pak a shumë atë lëmi.

Kështu që më lejoni, ju lutem, pra nuk do të ketë problem për LDK-n që ta votojë këtë raport, problemi është te do implikime tjera. Dhe, më lejoni të flas këtu, duke abuzuar me durimin tuaj, natyrisht, për një përplasje ndërmjet procedurave dhe moralit elementar njerëzor. Dhe, kur kjo përplasje është kaq e madhe, atëherë unë mund ta quaj ndoshta me guximin se po e teproj pak: “terror të procedurave”. Ju e patë që ne kishim rrezikun që si i pari i vendit nëpërmjet procedurave ... një emisar i vullnetshëm i Millosheviqit, nëpërmjet procedurave, totalisht në kundërshtim me moralin elementar.

Unë po ju përkujtoj se duke qenë se e kam pasion shahun, po kamerat ende nuk e kanë pasur atë kënaqësi të më incizojnë, po luaj nga disa orë në ditë, s’kam tjetër punë çka të bëj. Unë po ju përkujtoj se legjenda më e madhe e shahut amerikan, Bobby Fischer, ka vdekur më 2008, në Islandë, në **Reikjavik**, sepse amerikanët ia patën anuluar pasaportën legjendës së vet më të madhe të shahut në krejt historinë e Amerikës, duke qenë se e pat thyer embargon dhe shkoi në Beograd të luajë shah. Embargon që Amerika kishte vu edhe për shkak të Kosovës, ndërkaq procedurat tona, një emisar të vullnetshëm të Millosheviqit, ishim duke e bërë të parin e vendit. Pra, këtë e quaj unë: “terror të procedurave”- a do të thotë se jam për anarki, unë? Jo, jo, jo... por, në rast kur ka një përplasje të tillë të madhe ndërmjet procedurave dhe moralit elementar njerëzor, atëherë duhet hulumtuar do procedura tjera. Jo ato që janë aq primitive, aq barbare, aq dhunuese, është terrorizuese sikurse në rastet që po i përmend.

Dhe, në rastin konkret, për fat të keq, mua po më vjen keq që nuk është as zoti Pacolli këtu se natyrisht edhe pse s’po përmend emra aty dihen modalitetet e mundshme, po më vjen keq edhe zëvendëskryeministrja Mimoza Kusari-Lila nuk është këtu se konkretisht doja të flas për një rast që ka ndodhur me Ministrinë e saj, mirëpo unë shpresoj që kanë aq nerva sa t’i këqyrin pastaj incizimet kush çka foli dhe mundësisht ndonjë revanshizëm eventual.

Por, jemi këtu edhe për goditjet revanshiste. Çka ka ndodhur me Ministrinë e Tregtisë? Milaim Hasin e ka nxjerrë në rrugë zonja Mimoza Kusari-Lila. Kush është Milaim Hasi? Një djalë i **Piranës**, ekonomist, ka pasur një biznes relativisht të mirë. Familja e tij, gruaja është prej Krushës së Madhe, të rralla janë familjet që kanë pësuar aso tragjedi si familja e kësaj bashkëshortes së Milaim Hasit. Pas luftës u shkatërrua gati me biznes, sepse u dashurua tmerrësisht në Partinë Demokratike të Kosovës dhe i ka ndihmuar me të gjitha forcat, të them të drejtën, për mua nuk është ku ta di çfarë dashurie racionale, por ato dashuritë janë irracionale krejt edhe sikur të dashurohej në Lidhjen Demokratike të Kosovës. Nuk ia vlen aq, por unë u kënaqsha, sepse kishte aq besim njeri, mua nuk më pengonte fare. Mua më impresiononte ajo zemërbardhësi dhe besim i tij. Kështu që mbet definitivisht në rrugë njeri, duke qenë pra bartës i një familje jashtëzakonisht të martirizuar, duke qenë edhe pa mjete financiare, çka bëra unë? Meqë e njihesha ia rekomandova zotit Lutfi Zharku, thashë: “këqyr bre ta strehojmë këtë njeri se është problem emocional është ky, natyrisht social”po, edhe unë ia di për nder shumë ministrit Lutfi Zharku dhe besoni që unë nuk jam shumë i përdorshëm për të mira të tilla

individuale, por aq më goditi ky rast që i ka fëmijët e mëdhenj, **dajët** të shkatërruar totalisht nga mizoria serbe, hallall, zoti Lutfi Zharku e mori në punë. Vjen tash Mimoza Kusari – Lila me procedura, 1.000 pyetje parlamentare po t’ia kisha bërë unë, ajo do të thoshte procedurat janë ok. Ja këtë e quaj unë: “terror procedurash” dhe ai njeri ende është natyrisht në rrugë. Unë dola këtu për të thënë se në qoftë se Kompania Mabetex, unë s’po i shoh kusur Mimoza Kusarit – Lila, ajo është parti private, burrë, personale është ajo. Tash pse mjaftohet një zonjë edhe tash sa i përket zonjave mua më kanë mbushur me kompleks si, e nderuara Flora Brovina, si Teuta edhe s’po guxoj të flas kundër grave, të them të drejtën, por në qoftë se këto krenohen me gjestin e Mimoza Kusarit – Lila, unë them: “me shëndet e bashi” nuk kam koment tjetër. Edhe çka do të thotë kjo, çka po më pengon mua kjo? Në qoftë se unë si një eksponent që nuk jam ku ta di çfarë burri i mirë, të merremi vesh, por në qoftë se unë si një eksponent i një partie tepër rivale me PDK, kam intervenuar për këtë njeri që e shkriu pasurinë për PDK-në, tash del që zoti Pacolli, prej **Luganos**, e ka pasur zonjën Milica të Kragujevcit menaxhere kryesore. Edhe mua kjo, të mos keqkuptohemi që kam ndonjë paragjykim. Jo, jo, unë kam studiuar në Beograd dhe absolutisht paragjykime të tilla s’kam.

(Ndërhyrje)

Edhe tash çka ndodh? Ndodh që zoti Pacolli, që është krejt shëndosh, ka shpëtuar për fat të mirë dhe unë nuk jam xheloz për dërrasa mangu si na që i kemi, vjen e bëhet persekutor i njerëzve që janë martirizuar, duke i qitur përsëri në rrugë. ...

KRYETARI: Është duke folur në emër të Grupit dhe çdo grup, jo, jo s’e ndërpres.

EQREM KRYEZIU: ...Këtë unë e quaj “terror të procedurave”.

KRYETARI: Çdo grup e ka rendin e vet. Kur të vjen rendi, urdhëroni merreni fjalën.

(Ndërhyrje)

KRYETARI: Jo, unë nuk e kam të drejtën se është duke folur... ky si e zgjedh gjuhën, është çështje e tij.

EQREM KRYEZIU: As nuk më vjen keq që zoti Pacolli e ka një shoqëri multietnike se e tillë të fundi i fundit është edhe Kosova, por nuk do të më vinte mirë në qoftë se në atë kompani multietnike, por do të më vinte keq në qoftë se në kompaninë e tij multietnike ndryshe trajtohen shqiptarët dhe ndryshe trajtohen ata tjerët. A, ky do të ishte një problem shumë i ndjeshëm. Kështu që me këtë rast që e nisa me zotin Hasin, në qoftë se nuk bëhet diçka tjetër, unë do të detyrohem t’i drejtohem zotit kryeministrit edhe këtyre tjerëve zëvendësministrave, të tjerëve që ta kenë parasysh këtë rast drastik. Pra, deri këtu shkon çështja e torturës nëpërmjet procedurave. Unë këtu po e përfundoj, zoti kryetar, duke shpresuar se pak a shumë adrenalinën e kam zgjuar në këto orë të vona. Falemnderit, shumë!

KRYETARI: Pak, po. Në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Afrim Kasolli e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: Falemnderit!

I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Edhe lëvizja “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar me vëmendje raportin vjetor të punës së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2011 dhe si e tillë e përkrah përmbytjen e këtij e raporti.

Po ashtu, si lëvizje jemi të shqetësuar për shumë nga gjetjet që posedon ky raport. Faktet e konstatuara nga ky Këshill në mënyrë simptomatike pasqyrojnë gjendjen e vështirë në të cilën ndodhet Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës. Kështu raporti konstaton faktet që nga politizimi i këtij sektori të rëndësishëm, mungesa e meritokracisë në avancimin e stafit civil e deri tek faktet tjera që tregojnë se si vlerësimet e rezultateve në punë nuk bëhen gjithherë në mënyrë objektive. Po ashtu, sfidë tjetër në këtë drejtim mbetet edhe moszbatimi i vendimeve të Këshillit nga organet përgjegjëse duke krijuar kështu një gjendje ambivalente juridike ndërmjet një vendimi që ka procedurë përmbartimore dhe moszbatimit të tij.

Është interesant të thuhet se sipas statistikave që ofron ky raport, 79.11% të atyre që kanë ankesa janë meshkuj, kurse vetëm 20.88% janë femra. Megjithatë, ky fakt në vetvete nuk do të thotë se kemi të bëjmë me avancimin e vetëdijes gjinore, shoqërore dhe se shkeljet janë më pak të orientuara ndaj femrave, por kjo ndodh ndoshta, sepse vetë femrat në përgjithësi janë më pak të prira për të adresuar ende ankesat e tyre ndaj mostrajtit të barabartë që mund t’ju bëhet në vendin e punës. Ndërkaq, ajo që e mbështet edhe më shumë këtë pandën ka të bëjë edhe me disa të dhëna tjera që i ofron ky raport, bie fjala sa i përket strukturës gjinore në institucionet qendrore, janë të punësuar 9.053 meshkuj, kurse vetëm 5.199 femra, pra që do të thotë dyfishi.

Kurse, në institucionet lokale disparitetet gjinore në punësim janë edhe më të mëdha, me gjithsej 4.506 meshkuj dhe vetëm 1.445 femra.

Këto statistika tregojnë se sa jo proporcional është ende përfaqësimi gjinor në institucionet publike, si të nivelit qendror, ashtu edhe të atij lokal. Bazuar në këto fakte këtu ndoshta qëndron arsyeja se edhe pse numri i ankesave në përqindje është shumë më i vogël, si dhe pjesëmarrja e tyre në këto institucione është shumë më e vogël. Shkeljet e tjera në këtë segment prekin edhe çështjet sikurse se vërehen se si institucionet e caktuara edhe pse kanë vende të lira të punës, ato nuk procedojnë në përputhje me ligjin, por i mbajnë ato vende me ushtrues detyre, duke i tejkaluar afatet ligjore. Gjithsesi, duke marrë parasysh të gjitha këto fakte është me rëndësi që të përshëndetet puna e këtij Këshilli me monitorimin e kësaj sfere edhe përkundër faktit se vetë Këshilli në fjalë është duke u përballuar me sfidat qenësore në realizimin e detyrave të tij ligjore dhe kushtetuese. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të AAK-së deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Falemnderit, kryetar!

Që në fillim po e them se edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, do ta votojë raportin.

Do të mundohem t'i prek disa çështje që nuk u prekën, në fakt për të thënë që e përkrah fuqishëm parafolësin e LDK-së. Do të fillojë shumë shkurt, një shërbim civil i pavarur profesional dhe i qëndrueshëm, është garanci e fuqishme e funksionimit të shtetit, pavarësisht rrethanave, situatave të ndryshme. Kështu do të duhej të ishte se a është kështu raporti nuk e thotë? U përmendën që unë dua të precizoj që krahasuar me raportin e vitit të kaluar, ky raport është një përmirësim i theksuar, por jo i kënaqshëm. Më duhet të ndalem pak a shumë te ankesat më të mëdha që kanë ardhur në Këshill, kryetar, dhe ju të nderuar deputetë, janë pikërisht ankesat në Ministrinë e Shëndetësisë, me gjithsej 43 ankesa ose 10.56%, pastaj pason Ministria e Punës dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, me 10 ankesa. Pra, ankesat më të mëdha kanë ardhur nga këto dy ministri edhe unë do të ndalem këtu, e krahasuam me vitin e kaluar që printe me ankesa, Ministria e Drejtësisë, e udhëhequr nga PDK-ja, kësaj radhe prinë me ankesat më të mëdha në dy ministri që udhëheqin nga partneri në koalicion.

Dua të them se me aq pompozitet është thënë para bashkëqeverisjes që do të hymë në një Qeveri me duar të pastra, me një Qeveri të pa korruptuar. Unë them se kjo nuk është Qeveri me duar të pastra, këtu nuk flitet për pa korrupsion, unë them flitet për korrupsion dhe flitet me duar jo të pastra. Sepse, po të ishin duar të pastra, me të vërtetë nuk do të lëvizet, nuk do të luani me ndjenjat e njerëzve ashtu sikurse e përmendi edhe profesori i nderuar.

Pra, është shqetësuese për mua që gjithë këto ankesa që kanë ardhur nga këto dy parti kjo po dihet që secili kandidat që i vjen shansi të hyjë në Qeveri, jo vetëm se po hyn në një qeverisje të keqe, por po bëhet më keq edhe po ia jep argatin më të madh keqqeverisjes. Në këtë rast, nuk është një shembull i mirë pra, as për ne si deputetë, por as për opinionin në përgjithësi, nuk duhet asnjëherë të kënaqemi me këto. U përmendën edhe disa shqetësime të tjera, pra mos të harroj thashë, besimin më të madh që e kam pasur vetëm pse ka qenë femër, zonja Mimoza Kusari – Lila, por i ka bërë shkeljet më të mëdha. Nuk po dua të ndalem në detale, megjithatë janë përmendur, shumë shqetësuese janë edhe vendimet e gjykatave që anëtarët e Këshillit na kanë raportuar neve si Komision, që janë vendime të laramanishme, disa gjykata i marrin vendimet si i përfillin vendimet e Këshillit e disa jo, kjo me të vërtetë është shqetësuese për vetë Këshillin, duke ditur që vendimet e Këshillit janë të formës së prerë.

Andaj, kryetar e kam përmendur edhe vitin e kaluar, po e përmend edhe tash, po vjen në pikëpyetje nganjëherë a të ekzistojë Këshilli. apo jo? Edhe një shqetësim tjetër që me të vërtetë nuk është në interes të funksionimit të drejt të Këshillit dhe duke e ditur se ankesat e shërbyesve civilë vijnë pikërisht në këtë Këshill, janë edhe pagat e ulëta për kryetarin dhe anëtarët e Këshillit, janë shumë të ulëta dhe jo përkatëse për punën dhe statusin që e kanë ata. Aq më shumë kur kihet parasysh se kjo bazë e pagës është më ulët se paga bazë e secilit bord ose agjenci të pavarur, të themeluar nga Kuvendi i Kosovës, më e ulët se paga e udhëheqësve të lartë në Shërbimin Civil, më e ulët se vetë administrata e Këshillit. Pra, me të vërtetë nuk di se si duhet, si nuk e kanë besimin ndoshta edhe vetë i përmendi

edhe anëtar i “Vetëvendosjes” për t’u ankuar, do të thotë, ia humbin shpresën edhe njerëzve tjerë që ndoshta kanë për t’u ankuar dhe kur e shohin që nuk ekzekutohen vendimet, kjo për ne është një shqetësim shumë i madh.

Pra, edhe njëherë unë kisha dashur që në raportin e ardhshëm të mos kemi asnjë vendim të pa ekzekutuar. Pra, duhet bashkarish të punojmë që këto vendime të ekzekutohen. Falemnderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re deputeti Jeton Svirca e ka fjalën.

JETON SVIRCA: Falemnderit, kryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2011. Ne gjykojmë se fjalimi i deputetit nga radhët e LDK-së ishte jashtë teme dhe zoti Pacolli s’ka asgjë të bëjë me këtë raport.

Prandaj, ftoj që në diskutimet tona të jemi më korrekt dhe të flasim për materien e raportit. Koalicioni për Kosovë të Re, në këtë rast, ne që jemi prezentë do ta votojmë raportin. Ju falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të SLS-së deputeti Milivoje Stojanović e ka fjalën.

MILIVOJE STOJANOVIĆ: Hvala, predsedavajući!

Poslanička grupa SLS će podržati izveštaj Nezavisnog Nadzora Saveta za Civilnu Službu Kosova, za 2011.godinu. Istovremeno podržavamo i kritički odnos pojedinih prethodnih govornika prema ovom izveštaju. Hvala!

KRYETARI: Falemnderit! “6+” nuk janë këtu, fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Falemnderit, kryetar!

Edhe pse s’jemi as 40 në sallë po vazhdojmë me seancë. Janë tri momente që dua t’i cek te raporti vjetor i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, momenti i parë që ende kemi problem me autoritetin e këtij Këshilli dhe këto probleme konsistojnë se ende konstatohen mjaft raste kur vendimet e këtij Këshilli nuk respektohen, nuk zbatohen dhe atë në dy segmente. Nuk zbatohen as nga pushteti gjyqësor, por jo radhë edhe nga vetë pushteti ekzekutiv.

Derisa nuk kemi një gjykatë administrative, çfarë e kanë disa vende, atëherë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, është autoritet që monitoron funksionimin e Shërbimit Civil dhe ky autoritet i këtij Këshilli buron edhe nga Kushtetuta e cila jep statusin e Agjencisë së Pavarur, por edhe nga Ligji për Shërbimin Civil. Është krejt e pafalshme që një institucion i themeluar me Kushtetutë të mos respektohet nga dy degët e pushtetit dhe vendimet e saja të vihen në diskutim derisa ligji i ka dhënë karakterin e detyrueshëm këtyre vendimeve.

Momenti i dytë, raporti konstaton se vazhdon trendi i shkeljeve në Shërbimin Civil dhe këto shkelje janë të niveleve të ndryshme, nga punësimet jo ligjore e deri te gradimet dhe

avancimet në pozita të larta në Administratën Publike, filluar nga pozita e drejtorit e deri te pozitat menaxheriale në Administratën Publike dhe këto shkelje janë të përhapura dhe vazhdojnë me të njëjtin trend.

Një moment tjetër i rëndësishëm është që puna e këtij Këshilli tani duhet pak të profilizohet dhe specializohet, sepse ky Këshill nuk monitoron 75.000 shërbyes civilë, por ky ka të bëjë kryesisht tani me 20.000 shërbyes civilë sa do të jenë me hyrjen në fuqi të akteve nënligjore, të cilat zbatojnë Ligjin për Shërbimin Civil. Thjesht, unë angazhohem që vendimet e këtij Këshilli të merren me respekt dhe Parlamenti është ai që duhet ta mbrojë autoritetin e këtij Këshilli, sepse Parlamenti edhe e ka themeluar, por Parlamentit edhe i përgjigjet dhe të mos lejojë abuzimin kushtetues të autoritetit legal dhe kushtetues që ka ky Këshill. Është krejt e pafalshme që vendimet e këtij Këshilli nganjëherë nënçmohen apo nuk zbatohen dhe kjo sikur i hap derën shkeljeve që bëhen në Shërbimin Civil, u përmendën këtu disa raste dhe gjitha këto raste regjistrohen dhe gjitha këto raste na vijnë neve si vërejtje serioze në Raportin e Progresit, ka pesë vjet. Ka 5 vjet, Administrata Publike është gjetja në të cilën konstatohen më së paku përparime, për shkak të mungesës së disiplinës së funksionimit të Shërbimit Civil.

Për këtë arsye unë angazhohem që edhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës të jetë shumë më aktiv dhe më transparent në denoncimin e rasteve kur vendimet e këtij këshilli abuzohen apo nuk respektohen, në mënyrë që derisa ekziston edhe ai duhet të ekzistojë, sepse është kategori kushtetuese dhe ligjore ai të funksionojë me autoritetin e duhur kushtetues dhe ligjor. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Debati nuk e kërkon numrin e caktuar të deputetëve, mund të zhvillohet edhe në këtë formë që është duke u zhvilluar dhe kjo nuk duhet të jetë shqetësim, shqetësim për të gjithë e sidomos për neve që edhe i drejtojmë seancat, vërtet është ka na vjen pak keq para opinionit me papërgjegjësinë e deputetëve në prezencën e tyre në seancat parlamentare.

Kjo është një vërtetë e madhe. Edhe një çështje dua të them sa i përket, Kuvendi si Kuvend nuk mund ta ruajë autoritetin e asnjë Komisioni të Këshillit të Pavarur, derisa nuk janë të interesuar ta ruajnë autoritetin e institucionit njerëzit që i drejtojnë ato institucione. Le të vendosim institucionet e pavarura njerëz që kanë integritet dhe ata ta ruajnë integritetin e institucioneve. Parlamenti s'mund ta ruajë.

Vazhdojmë debatin. Deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Falemnderit, kryetar!

Unë pas fjalës së profesor Arsim Bajramit nuk kam çka të shtoj edhe në aspektin e trajtimit juridik edhe atë politik, të trajtimet e këtij raporti, por Kuvendi i Republikës së Kosovës, Komisioni Funkcional u pa që i ka vërejtur me vëmendje dhe me përkushtim të metat, të cilat kanë të bëjnë me Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, unë vetëm ju uroj për guximin profesional anëtarëve të këtij Këshilli, dhe të cilët pa ndikim politik i respektojnë vendimet, lëshojnë vendime, të cilat janë në përputhshmëri me ligjin.

Pra, mbetet ta bëjnë punën e tyre Komisioni dhe Kuvendi në raport edhe me këtë institucion të formuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që shërbyesit civil të trajtohen, pa ndikime politike, ashtu siç e thotë vetë ligji. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Adem Grabovci e ka kërkuar fjalën, kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

ADEM GRABOVCI: Falemnderit, kryetar!

Vërtet ne nuk është mirë që të flasim në emra të përveçëm, është shumë e vërtetë se vendimet e këtij institucioni nuk kanë hasur në mirëkuptim, apo nuk janë respektuar nga disa institucione. Dhe, unë mendoj që duhet ne si Parlament që të insistojmë që vendimet e këtij institucioni të respektohen dhe të kërkojmë nga institucionet përkatëse që vërtet njerëzit, të cilët është konstatuar se janë larguar nga puna pa të drejtë, që ka shkelje procedurale, ata duhet të rikthehen në vendet e tyre të punës. Falemnderit!

KRYETARI: Nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar i Kuvendit!

Kolegë të nderuar,

Kishim dëgjuar gjatë përgatitjes të kësaj seance sidomos të kësaj pike që ka shumëçka të thuhet, bile unë s'dua të përmend emra, por njëfarë intimiteti një grup deputetësh kanë qenë shumë të motivuar të flasin me argumente, unë ata edhe s'po i shoh tash, kështu që s'mbetet fort t'ju besoj tjera herë, por është çështje e tyre.

Megjithatë, unë kam dëgjuar këtu 2-3 diskutime shumë interesante, shumë të sakta të cilat do t'i flitsha edhe vetë me pikë e me presë dhe po e përjashtoj Eqremi, sepse e kam të partisë edhe i bie që po pajtohem me të pse është për të, por unë po shkoj tutje. Konstatimi i zonjës Izmaqi është shqetësues dhe është shumë i vërtetë. Fjalimi i zotit Arsim Bajramit është konstruktiv, i studiuar dhe shumë i vërtetë, në çdo pikë, unë shënova katër pikat, të gjitha qëndrojnë. Unë po vazhdoj këtu, sepse këta të dytë, natyrisht i përkasin shumicës që është në pushtet dhe nuk iu bie që të shkojnë përtej konstatimeve shumë parimore që në të vërtetë do të derivojnë edhe kërkesa tjera.

Unë po them që duhet nisemi nga titulli, nëse është organ kushtetues dhe e ka emrin "Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës", ky duhet të jetë i pavarur dhe kushdo që përpiket t'ia marrë pavarësinë, ai e shkel ligjin dhe e shkel Kushtetutën, qoftë në nivel të Qeverisë qendrore, qoftë më ulët se kjo. Sepse, është një organ i cili këqyr ato të padrejta, shkelje, që bëhen te shërbyesit civilë, të cilët për kah natyra po them, sepse të kulluar nga implikimet politike si pikëpamje s'ka gati në Kosovë, por për kah natyra e punës duhet të jenë jo politikë dhe të jenë profesionistë nëse tentojnë të krijojnë administratë të vërtetë të shtetit. Kjo nuk po ndodh edhe për shkakun, sepse sado që quhen institucione të pavarura e janë një mori sosh që i emëron Kuvendi, po i zgjedh Qeveria, atëherë mënyra e propozimit dhe e zgjedhjes tyre ata i bën që në krye të herës të varur, sepse janë të shpallur të pavarur nga ekzekutivi, por meqë ekzekutivi i propozon, atëherë vetvetiu janë të varura në fillim dhe bëhen edhe të pavarura në fund. Pse bëhen në fund? Në fund, bëhen më të varur për shkak të teknologjisë...

Nuk është problemi themelor a kanë pikëpamje më të profilizuar apo politike këta njerëz, problemi më i thellë është, a janë profesionistë? Sepse, një njeri që është profesionist dhe vendoset në vendin ku është i zoti, është shumë më lehtë ta ruajë integritetin edhe është shumë më pak i manipulueshëm. Nuk ka teknologji më efikase të manipulimit se sa po e zëmë ta bëjnë shef të aviacionit një njeri që di të ecën veç nëpër tokë, as s'e njeh aeroplanin, ose të kundërtën.

Kjo ka të bëjë me pozitat zgjedhëse. Pse po them? Sepse, njëri prej këtyre raporteve është ky, por gjitha janë raportet të atyre që i quajmë “organe të pavarura”. Po, po shihet që po bëhen përditë e më të varura dhe pikërisht këto organe mbasandaj nuk po janë të zotë t'i mbrojnë as njerëzit e tyre. Ju thoni qysh është përzier politika? Unë nuk duhet t'ia përmend emrin një institucioni të tillë të pavarur, por ndiej nevojë ta them sot këtu. Janë dy njerëz që janë implikuar në një mënyrë në atë Institut, të cilët i njoh dhe i respektoj të dytë. Njëri i profesionit, njëri i jo profesionit. Është hequr ai i profesionit, i është ofruar një tjetër që s'është i profesionit dhe ka qenë kaq me integritet ky i dyti që ka thënë: “Ngadalë, bre se nëse hiqet ai i profesionit, unë s'mund ta marr se s'jam”. Dhe, kjo ka ndodhur në, nuk është gjithherë kështu, nuk ndodh gjithherë kështu. Kësaj radhe ka ndodhur, unë emrat s'i jap, po ju e dini, dikush e di, dikush s'e di.

Pra, duhet, nuk është problemi a ka një afinitet politik një njeri, problemi është, a është i zoti ta kryejë punën dhe prej kësaj mbasandaj rrëshqasim tek ata që quhen “shërbëtorë të zakonshëm civilë”. Kjo është rrezik i madh, sepse ndërrohen qeveritë, ndërrohen garniturat, demokracia e ka këtë problem. Mos u ndërroftë sivjet, ndërrohet mbas dy vjetëve, pse është demokraci? Atëherë, po të fillojmë kështu me afinitetet partiake të nxjerrim dhe të fusim njerëz, kurrë nuk ndërtojmë administratë të vërtetë, të paanshme, profesionale dhe vendi që nuk e ndërton këtë nuk ka perspektivë. Dhe, ju e dini ai Raport i Progresit të cilin s'kemi shteg pa e studiuar përditë, ne na sheh për të madhe përditë që kemi problem me administratën për profesionalizëm dhe për politizim.

Natyrisht, unë edhe njëherë po them partiakët që bëjnë shërbime në parti e donë një punë diku, por mos të shiten aty ku s'kanë haber. Këtu është problemi i madh, se atëherë s'ke perspektivë as për partinë, as për shumicën, as për pakicën, as për qytetarët. Dhe, ky është problem i madh këtu, problem të cilin unë mendoj që duhet ta shikojmë përditë edhe Kuvendi edhe Qeveria edhe Avokati i Popullit dhe një ditë ne po mendojmë edhe Gjykata e Strasburgut, si instanca e fundit. Se ju e dini shtetet që janë atje i fitojnë situatat e veta edhe në Strasburg. Po shtetet kudo janë pak si të ngjashme, i jep drejtë gjykatës ai ekzekutivi s'e realizon, po ai shkon deri në fund dhe e fiton. Dhe, unë do ta ndërpres këtu këtë bisedë, sepse do ta rimarrë patjetër një ditë kur të jetë Qeveria këtu, patjetër, sepse, s'kemi ka ia mbajmë, por kjo nuk domethënë gjë ne jemi Kuvend dhe unë mendoj që ne duhet t'i themi të gjitha këto probleme qartë dhe t'i zbatojmë, sepse jemi në Kuvend. Falemnderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk kemi përveç Myzejenes, të lajmëruar për debat dhe po e përfundojmë këtë pikë të rendit të ditës, për ta vazhduar nesër në orën 10:00. Mirupafshim!

* * *

(Seanca plenare e vazhdoi punën më datë 25.5.2012)

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë, vazhdojmë seancën plenare! Mbrëmë i kemi kryer katër pika për debat, kemi katër votime. Votojmë për Raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave dhe Raportin e Këshillit të Pavarur të Mbikëqyrjes të Shërbimit Civil.

Mirë, merre fjalën. Fjalën e ka kryetarja e Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Falemnderit!

Që nga dita e parë e punës së këtij legjislacioni, kryetari i Kuvendit apo i pari i këtij Kuvendi e shkel Rregulloren e Punës neni 41, duke i lënë deputetët e paedukuar dhe njerëzit e krimit ekonomik të diskutojnë jashtë rendit të ditës.

Personi në fjalë është njeri i diskriminuar politikisht dhe njeri i kohës së kaluar. Nëse i pengon puna brenda Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe ministres, ia bëj me dije personit të diskriminuar që edhe në rrethin e vet dhe njeri i ulët politikisht se është ndalë më tallja nga kjo ministri. Nëse është i interesuar për zbatim të rregullave, le t'ia bëjë me dije këtij Kuvendi se si punon ai brenda LDK-së, ndërsa në prapaskenë punon me kryeministrin Thaçi. Ju falemnderit!

KRYETARI: Ju lutem, ju lutem! Nëse e kam shkelur dje rregullën 41, e shkela edhe sot. Mirë! Falemnderit!

Shkojmë me procedurën e votimit! Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

A ka pa kartelë? Se Ramizi s'qenka këtu, mirë! Me 49 vota për, 7 kundër, 1 abstenim, miratohet Raporti vjetor i Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2011.

Tani e votojmë Raportin vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, për vitin 2011. Votojmë tash!

Të pranishëm janë 73 deputetë. Me 64 vota për, 1 kundër, 1 abstenim. Kuvendi e miratoi Raportin vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, për vitin 2011.

Tani e votojmë Raportin vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, për vitin 2011. Votojmë, tash! Me 63 vota për, 2 kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Raportin vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, për vitin 2011.

Dhe, tani e votojmë Raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2011. Votojmë tash! Me 65 vota për, 3 kundër, 2 abstenime, Kuvendi e miratoi Raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2011.

E vazhdojmë debatin me pikën e radhës:

20. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2011

Raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2011, e ka shqyrtuar Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe ia ka rekomanduar Kuvendit për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Raportin vjetor Financiar të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2011, dhe ia ka rekomanduar Kuvendit për miratim. E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri, deputetin Zenun Pajaziti, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri në bazë të nenit 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e datës 16 e ka shqyrtuar Raportin vjetor të punës për vitin 2011 të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe e ka vendosur ta paraqesë në Kuvend me rekomandime për miratim.

Po ashtu, dëshiroj ta shfrytëzoj rastin që ky komision këtë vit e ka sjellë një raport të detajuar. Ka pasur po ashtu një debat shumë konstruktiv brenda Kuvendit për të gjitha angazhimet që i ka pasur ky komision. Janë trajtuar edhe çështje që kanë të bëjnë me të ndryshme: me licencat, me veprimtaritë e kompanive të ndryshme në këtë fushë, me çështjet që lidhen me ambientin dhe mund të thuhet se ka pasur një dakordim të plotë nga komisioni që të aprovohet ky raport.

Prandaj, po e përsëris dhe në emër të komisionit, ia rekomandoj Kuvendit për aprovim këtë raport. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Safete, në emër të komisionit e ke fjalën.

SAFETE HADERGJONAJ: Falemnderit, zoti kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më datën 8 maj 2012, e shqyrtoi Raportin vjetor financiar të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2011 dhe ka vlerësuar se në raport janë prezantuar sipas ligjit të hyrat e realizuara nga veprimtaria e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, që janë të hyra për Buxhetin e Kosovës, si dhe shpenzimet në mënyrë të detajuar sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike.

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale ka inkasuar të hyra në vlerë 7.840.764 euro, çka vërehet se ka një performansë dukshëm më të mirë se sa në vitet paraprake. Gjatë shqyrtimit të raportit janë ftuar përfaqësuesit të këtij komisioni dhe në vërejtjet që i ka bërë Komisioni për Buxhet dhe Financa për obligimet e papaguara që janë në vlerë prej 2.321.805 euro nga kompanitë e licencuara, nga KPMM-ja obligime këto të pakryera

nga taksat administrative, renta minerare dhe gjoba administrative, përfaqësuesit e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale njoftuan se në pajtim me ligjin janë ndërmarrë masa përkatëse ndaj kompanive që nuk i kanë kryer obligimet financiare.

Kompanive u është mundësuar që ta bëjnë programimin për shlyerjen e borxheve dhe kjo, sipas tyre, ka dhënë rezultate në inkasimin e borxheve. Si rezultat i kësaj mase që ka ndërmarrë komisioni është arritur të inkasojnë diku mbi 3.000.000 euro të hyra, pikërisht në saje të ashpërsimit të masave, duke mos i lejuar kompanitë që të bëjnë aktivitet apo ta kryejnë aktivitetin e tyre pa i kryer obligimet financiare. Kurse, kompanive, të cilat u janë nënshtruar proceseve të falimentimit, u është pezulluar licenca sipas tyre, janë bërë kallëzime penale, në mënyrë që të kryhen obligimet, domethënë janë marrë masa ligjore, në mënyrë që gjithçka të reflektojë në kuadër të funksionimit të plotë.

Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa ishte që të vazhdohet edhe më tutje me ndërmarrjen e masave edhe sanksioneve, të cilat janë të parapara me ligjet në fuqi, në mënyrë që kompanitë vërtetë t'i kryejnë obligimet e tyre dhe të pasojnë sanksione ndaj atyre, të cilat nuk i kanë kryer.

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, në shtojcën 4 e ka paraqitur edhe listën e të gjitha kompanive, të cilat nuk i kanë kryer obligimet e tyre. Nga kjo listë vërehet se ka kompani, siç është ndërmarrja private “Shat Mani”, që ka obligime 187.919 euro, mandej kompania “Albons” që ka obligime diku 95.000 euro, “Getoari” shpk, që ka obligime 102.775 euro, dhe kompani të tjera, të cilat nuk i kanë paguar obligimet. Prandaj, rekomandimi ishte që vërtet të zbatohen ligjet në fuqi që obligimet të jenë të pagueshme.

Raporti, po ashtu, përmban të dhëna për planifikimin e buxhetit dhe krahasimet me realizimin e shpenzimeve, si dhe krahasimet me vitet paraprake. Nga 1.497.564 euro, sa kanë qenë të planifikuara për këtë komision të pavarur, janë shpenzuar 1.279.208 euro, çka do të thotë se është realizuar ajo çka është planifikuar, 85.42%.

Meqenëse, raporti i përmbush obligimet të cilat i parasheh ligji edhe për Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe Ligji për menaxhimin e financave publike, komisioni njëzëri e ka miratuar raportin financiar të këtij komisioni dhe ia rekomandon Kuvendit për miratim.

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të komisionit, a? Mirë! Në emër të Partisë Demokratike kush e do fjalën? Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Falemnderit, kryetar!

Mendoj që do ta jap një aprovim të shkurtër sa i përket Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, jo vetëm për raportin, por edhe për punën e kësaj agjencie.

Ky raport, që këtë vit vjen shumë i detajuar për aktivitetin e këtij komisioni paraqet, po ashtu, edhe një fazë të rëndësishme të konsolidimit të kësaj agjencie, tashmë më të konsoliduarat dhe me më shumë përvojë në punën e saj. Ne e kemi trajtuar me vëmendje krejt këtë raport. Ajo çka vlen të theksohet është që, përveç tjerash, ka mundësi që janë

pjekur kushtet, po ashtu edhe në bazë të kërkesave edhe më të mëdha që paraqiten, si nevojë e shfrytëzimit të resurseve të vendit tonë edhe për energjinë që krejt Ligji për minierat dhe mineralet të rishikohet.

Ne e mbështetim po ashtu edhe në fazën e mëtutjeshme edhe angazhimin e këtij komisioni bashkë me edhe me iniciativën edhe të Qeverisë, edhe të deputetëve, që të punojmë edhe në ndryshime eventuale të ligjit. Për sa i përket raportit, duhet të thuhet se ky komision e ka pasur edhe një sfidë të veçantë gjatë vitit që shkoi, për shkak se Qeveria ka marrë masa të veçanta për ndalimin e shfrytëzimit, sidomos të zhavorreve të lumenjve, ka pasur sfida po ashtu në marrjen e licencave dhe në ruajtjen e ambientit dhe, në anën tjetër, po ashtu ka zbatuar politikat e reja në sektorin mineral, të paraqitura me strategjinë zhvillimore të këtij sektori.

Ne si Parti Demokratike e japim mbështetjen tonë dhe, po ashtu, kërkojmë edhe nga institucionet e drejtësisë t'i dalin në mbrojtje dhe mbështetje këtij institucioni sa i përket zbatimit të ligjit atje ku paraqitet nevoja në terren dhe po ashtu shpresojmë që ndryshimet eventuale në ligj do të kenë mundësi të hapin edhe mundësi konkurruese sa u përket edhe investimeve tjera në fushën e energjisë edhe shfrytëzimin e pasurive nëntokësore. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Lidhjes Demokratike, deputetja Teuta Sahatqija e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA. Falemnderit, kryetar!

Raportimi për Komisionin e Pavarur të Mineraleve dhe Minierave ka qenë një raportim i mbajtur më 16 maj dhe ka qenë i përcjellë me shumë pyetje dhe komente nga deputetët.

Deputetët e LDK-së e kanë shqyrtuar raportin e KPMM-së dhe në vazhdim do të jenë vërejtjet, sugjerimet dhe rekomandimet tona. Nga raporti shihet angazhimi serioz dhe sistematik i KPMM-së për eliminimin e operatorëve ilegal. Është e vlefshme të ceket se në këtë aspekt ndihmë të konsiderueshme kanë dhënë edhe shoqatat e operatorëve të licencuar. KPMM-ja ka pasur veprim të intensifikuar të inspektoratit, kanë shqiptuar gjoba dhe ka konfiskuar makineritë e operatorëve ilegalë, duke i kthyer shumë nga ata në operatorë legalë.

Kjo ka rezultuar që të hyrat që edhe janë prezantuar në këtë raport të jenë shumë më të mëdha se në vitet paraprake, gjë që është për t'u përshëndetur. Kërkesa për aplikimin e masave të sigurisë ka rezultuar në numër më të vogël të lëndimeve se në vitet paraprake dhe fatmirësisht në asnjë me rezultat fatal, gjë që është gjithashtu për t'u përshëndetur. Janë miratuar një numër i madh i udhëzimeve administrative dhe rregulloreve, të cilat kanë rregulluar fusha të ndryshme. Projekti i plansheteve një ndaj 25.000 e shndërron Kosovën në vendin me të dhëna në nivel të lartë studimor, gjë që do të ndikojë në joshjen e investimeve gjeologjike. Strategjia minerare, e cila ka munguar deri në përpilimin e këtij raporti ka sjellë pengesa dhe me aprovimin e strategjisë minerare gjatë këtij viti mendojmë që puna e KPMM-së do të lehtësohet. Në ueb-faqe janë licencat dhe listat që

tregojnë transparencën e këtij komisioni. Në raport financiar shihet se vetëm 10% e shërbimeve këshillëdhënëse janë shfrytëzuar, po ashtu edhe subvencioni.

Shpjegimi nga zyrtarët ishte se ata kanë marrë shërbime këshilluese falas dhe nuk kanë dashur ta shfrytëzojnë buxhetin e KPMM-së për këtë, gjë e cila nuk është qasje e zakonshme ndaj buxhetit nga shumica e agjencive. Mendojmë se raporti i ardhshëm mbi rezervat duhet të jetë më i detajuar mbi tejkalimet e rezervave të planifikuara dhe të shpjegohet efekti i saj. Në përgjithësi, është një raport i mirë dhe ne si grup parlamentar do ta miratojmë, do ta votojmë “për”.

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, kryetari i grupit, deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Falemnderit, kryetar!

Siç u përmend, raporti i cili ka ardhur në komision për t’u shqyrtuar dhe raportimi gojor nga përfaqësuesit e Komisionit për Miniera dhe Minerale janë, kisha për t’i thënë dy gjëra të ndryshme, meqenëse ka pasur plotësime të shumë informatave që janë dhënë gojarisht nga përfaqësuesit. Informata të cilat kanë munguar në raport dhe një prej vërejtjeve që ka qenë, e përgjithshme, në kohën kur është diskutuar në komision, jo nga të gjithë deputetët, por ka qenë nga disa deputetë edhe nga shoqëria civile, që e mbikëqyrë komisionin tonë, ka qenë vërejtja pikërisht në atë që raporti në disa aspekte nuk jep informata të bollshme për ato që i raporton, edhe për punën, në përgjithësi, të komisionit. Dhe, rrjedhimisht, komisioni pastaj i ka dërguar këto me shkrim te komisioni ynë, domethënë Komisionit për Miniera dhe Minerale. Nuk e di nëse e kanë marrë deputetët tjerë, por mendoj që do të ishte mirë t’u shpërndahen këto përgjigje shtesë që i ka dhënë komisioni për shkak se vërtet janë plotësuese për raportin në disa aspekte shumë të rëndësishme të tij.

Për sa i përket raportit, si të tillë, janë këtu disa çështje, të cilat ne edhe i kemi ngritur edhe do t’i ngre tash. Pra, disa u përmendën veçanërisht në angazhimet e Komisionit Kundër Operuesve Ilegalë, të cilët vazhdojnë të jenë një problem i madh në shfrytëzimin e resurseve të Kosovës, por një çështje shumë me rëndësi janë po ashtu edhe licencat e lëshuara, qoftë për hulumtim, qoftë për shfrytëzim, sepse ekziston një shpërputhje goxha e madhe ndërmjet licencave që lëshohen nga komisioni për çdo vit dhe pastaj të hyrave në Buxhetin e Republikës së Kosovës nga rentat minerare. Pra, këtu mund ta shohim që kemi shumë licenca për hulumtim dhe shfrytëzim që janë lëshuar për mineralet e ndryshme dhe resurset e ndryshme minerale, ndërkohë që në Buxhetin e Kosovës për çdo vit rentat minerare ose të hyrat nga rentat minerare raportohen të jenë zero dhe kjo shpërputhje mendoj që duhet të adresohet nga Kuvendi, meqenëse nuk është e logjikshme që të shfrytëzohen resurset minerare të Kosovës dhe të mos të paguhet renta minerare, meqë renta minerare është e obligueshme për to. Çështjen do ta diskutojmë më vonë, për shkak se kemi pikë të rendit të ditës.

Po ashtu, një gjë brengosëse për Lëvizjen “Vetëvendosje” janë edhe kompanitë, të cilave u lëshohen licenca, po shihet që është një lëvizje goxha e shpejtë drejt lejimit të shfrytëzimit të kapaciteteve minerare dhe resurseve minerare të Kosovës nga sektori

privat dhe kjo mendoj që në këtë formë mund ta dëmtojë goxha shumë sektorin minerar, aq më shumë kur nuk kemi ne si shtet as strategji minerare dhe rrjedhimisht domethënë nuk kemi strategji minerare, pra një këndvështrim goxha strategjik afatgjatë për atë se çka do të bëjmë me sektorin tonë minerarë. Dhe, në anën tjetër, kur nuk kemi mbikëqyrje mbi rentat minerare sa t'i mbledhim si shtet, e lëshojmë kaq shumë licenca për sektorin privat, atëherë kjo do të rezultojë në shfrytëzimin e resurseve minerare të Kosovës, pra pasurisë nëntokësore të Kosovës nga kompanitë private pa kurrfarë përfitimi për shtetin e Kosovës, gjë që natyrisht nuk do të duhej të ndodhte. Dhe, ne jemi absolutisht kundër kësaj që po ndodh.

Për çështje tjera mendojmë që raporti është goxha mirë i përpiluar dhe rrjedhimisht ne do ta votojmë raportin si të tillë, meqenëse është raportim për punën e komisionit, mirëpo këto janë vërejtjet që për mendimin tonë duhet të shqyrtohen nga Kuvendi, meqë janë çështje shumë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik, por edhe strategjik të Kosovës. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të AAK-së, deputeti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Falemnderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar raportin dhe duke u bazuar se është një raport që tregon rritje të efikasitetit dhe angazhimit dhe menaxhimit më të mirë, konsiderojmë se ky raport duhet të aprovohet, me gjithë vërejtjet që u dhanë edhe nga parafolësit, për të mos i përsëritur, edhe lidhur me operatorët ilegalë edhe me licencat që po lëshohen edhe me veprimet, të cilat mund ta dëmtojnë veprimin edhe të komisionit, por edhe në përgjithësi të interesave të shtetit. Konsiderojmë se ky raport, me përpilimin që është bërë, duhet të aprovohet. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja e grupit, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Falemnderit!

Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar Raportin e Punës të Komisionit të Pavarur të Minierave dhe Mineraleve. Duke marrë parasysh se ky raportim i kësaj agjencie, i cili përgjigjet edhe në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, mund të thuhet se është një ndër agjencitë më profesionale në punën e saj që punon.

Në rast se e marrim çështjen e raportimit në bazë të Ligjit të minierave dhe mineraleve, atëherë shohim se raporti i punës së KPMM-së është në viza-vijë me ligjin. Dhe risia, kësaj radhe e këtij raporti, është puna e Inspektoratit të Minierave, ku shihen mjaft mirë rezultatet, të cilat i arrijnë KPMM-ja, në bazë të punës së Inspektoratit. Në rast se i marrim të hyrat e KPMM-së, zonja Safete e theksoi mjaft mirë shihet se kjo është agjenci e pavarur, e cila mund të sjellë edhe shumë të mira në Buxhetin e Kosovës.

Duke e analizuar gjithë materialin e KPMM-së, mund të themi se kjo agjenci e zbaton ligjin, e zbaton Kushtetutën. Dhe, Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah edhe në anën profesionale. Ju falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të SLS-së, deputetja Biserka Kostiq, e ka fjalën.

BISERKA KOSTIĆ: Zahvaljujem predsedniče!

I Parlamentarna Grupa Samostalna Liberalne Stranke razmatrala godišnji izveštaj nezavisne Komisije za rudnike i minerale. Grupa će podržati usvajanje istog. Zahvaljujem!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, deputetja Duda Balje.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Parlamentarna grupa “6+” podržace Godišnji izveštaj nezavisne Komisije za rudnike i minerale i glasaće za njega, uz molbu da se obrati veće pažnje na očuvanje prirode i regulisanje stepena njene eksploatacije. Zahvaljujem!

KRYETARI: Falemnderit! Kemi përfunduar me grupet parlamentare. Fjalën e ka deputeti Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Falemnderit, zoti kryetar!

Përsëndetje për ju dhe zëvendësministrin, ministrat, kolegë deputetë,

Çështja e parë që do të doja ta ngre është se raportimet e tilla pa një auditim të performansës janë të mangëta në çfarëdo vlerësimi që japim. Në veçanti, agjencitë si kjo nuk janë shumë të rëndësishme, krahasuar me sukseset apo pasojat që mund të dalin nga puna profesionale apo mospuna, që janë shumë të mëdha se mjetet e shpenzuara në raport me buxhetin që ne ua ndajmë.

Vlerësimet e mia do të bazohen në këtë raport, që e ka hartuar vetë ky institucion dhe nga ky raport del se gjatë vitit 2011 ka pasur 935 inspektime. Prej tyre del se 138 inspektime kanë qenë ilegale, që kanë konstatuar se janë veprime ilegale, ndërsa 642 janë legale, numri është shumë i madh dhe në raport ka qenë mirë të prezantohet, se cilat janë këto, përkatësisht veprime ilegale që operojnë në Kosovë.

Gjatë vitit 2011 janë shqyrtuar gjithsej 434 kërkesa. Del se në këto kërkesa janë inspektuar edhe kompanitë nga viti paraprak, por nuk prezanton se cili është numri i bartur nga viti në vit.

Çështje tjetër që dua ta ngri këtu është se raporti flet për disa hulumtime në regionin e Gjilanit, por nuk i sqaron se cilat janë objektivat e atyre hulumtimeve dhe cilat janë rezultatet e tyre.

Një veprim i mirë i kësaj agjencie është trajtimi i mbeturinave të KEK-ut në vendosjen e galerive të Trepçës, është për t’u përsëndetur dhe inkurajuar që kjo të vazhdojë.

Kur jemi te KEK-u, në raport thuhet se KEK-i nuk ka leje pune as për shirita, as për hirin ku e vendos atë. Prandaj, është mirë ose ka qenë mirë që të sqarohet pse mungojnë ato dhe çfarë dëmsh sjellin ato, mungesa e lejes sigurisht se i atakon edhe prona private dhe vendbanime të caktuara, derisa nuk u është dhënë leja, dhe pse lejohet të veprohet në atë mënyrë.

Pastaj, raporti flet për inspektimet në miniera nëntokësore e mbitokësore, e numri i tyre mbitokësore është shumë i madh. Nuk e di, besoj që deri sa të vijë te leja ata duhet ta kenë edhe lejen e Ministrisë së Ambientit, sepse këtu kemi të bëjmë kryesisht me gurëthyes, që nganjëherë në disa lokacione po e ndytin ambientin jashtë çdo kriteri.

Në fund kisha për të thënë se kur flet raporti për gjobat, tregon se numri i shqiptimit të gjobave shprehur në financa është një milion e 371 mijë e 299 euro. Por te inkasimi flet se i ka vetëm 166 mijë e 354 euro, që është shumë i ulët. Këtu do të duhet të shqyrtohet se a është numri i madh i gjobave të shprehura, apo mungojnë mekanizmat e inkasimit të atyre gjobave, të cilat ai i aplikon.

Dhe, krejt në fund, po e lidhi prapë me performansën, mungesën e performansës të këtij raporti, e për këtë mendoj se shkaqet janë edhe te Zyra e Auditorit Gjeneral, të cilit i mungojnë kapacitetet e veta të pjesës audituese për performansë, sepse vitin e kaluar ka pasur të planifikuara 5, i ka hartuar 4, ndërkaq 3 nuk i ka sjellë. E ka sjellë vetëm një, nën justifikimin se i mungojnë profilet e dijës së ekspertëve të kësaj natyre.

Pra, po t'i bëhej një performansë këtij raporti, do të dalë në sipërfaqe se vërtet performansa e këtij sa ka qenë performansë pozitive. Ta marrim për shembull, në një aktivitet që ka qenë i shprehur më herët, edhe këtu në Kuvend i shtruar se rëra merret nën pretekstin e hulumtimit, të studimit dhe ai përdoret për biznese. Një auditim i performansës, këto gjëra do t'i hedhë në sipërfaqe dhe ne do të shohim realisht performansën e këtij institucioni. Falemnderit!

KRYETARI: Nuk kemi të paraqitur. Atëherë votojmë!

Të pranishëm e kemi 70 deputetë, se katër dolën për të pirë kafe.

Lus deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se me 65 vota për, një kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2011.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

- Shqyrtimi i Propozimit të Qeverisë së Kosovës lidhur me "Listën për Rentat Minerare"

Propozimin e Qeverisë së Kosovës lidhur me "Listën për Rentat Minerare", e ka shqyrtuar Komisioni Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, dhe ia ka rekomanduar Kuvendit për miratim.

E ftoj kryetarin e Komisionit, deputetin Zenun Pajaziti, për arsyetimin e Raportit vjetor financiar.

ZENUN PAJAZITI: Falemnderit, zoti kryetar!

Komisioni për Zhvillim ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në mbledhjen e mbajtur më datën 8 maj, në bazë të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit dhe në pajtim me nenin 50 të Ligjit për minierat dhe mineralet e ka shqyrtuar listën për Rentat Minerare të

propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me vendimin e datës 22, dhe ka vendosur unanimitisht që Kuvendit t’ia paraqesë rekomandimin për aprovim.

Dëshiroj po ashtu të ju sqaroj si komision, para se ta trajtojmë këtë listë, kemi vendosur që ta bëjmë një dëgjim me të gjitha palët e interesuar, me të gjitha kompanitë dhe institucionet e ndryshme, të cilat kanë interes për ta trajtuar këtë listë. E kemi mbajtur një takim, pas të cilit kemi vendos t’u japim edhe dhënë një afat shtesë të gjitha palëve të interesuara nëse dëshirojnë të bëjnë propozime konkrete, edhe pse debati ka qenë mjaft i gjatë, me informacione shtesë edhe nga Qeveria, edhe nga Komisioni për Miniera dhe Minerale, ndërkaq ka rezultuar që nuk kemi pasur ndonjë propozim, dhe pas sqarimeve që sidomos kanë ardhur nga institucionet përkatëse, nuk kemi pasur ndonjë propozim konkret nga kompanitë e ndryshme dhe institucionet, prandaj komisioni në fund e ka miratuar dhe përfundimisht e kemi sjellë këtu, me rekomandimin për aprovim.

Dëshiroj, zoti kryetar, ta shfrytëzoj rastin, po ashtu, edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike ta prezantoj pëlqimin tonë për këtë listë dhe të ju kërkojmë deputetëve për miratim. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Lidhjes Demokratike, deputetja Teuta Sahatqija e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Falemnderit, kryetar! Ne e kemi pranuar listën me rentat minerare dhe në dëgjimin publik që kemi pasur ka qenë një diskutim i gjatë me shumë përfaqësuese nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, KPMM, KEK, “Ferronikeli”, “Trepça”, “Shar-Cemi”, shoqata “Zhavorri”, ku i kemi dëgjuar vërejtjet, kërkesat dhe sugjerimet e tyre.

Deri më tash, renta për qymyr ka qenë 0,27 euro, ndërsa me propozimin e Qeverisë kjo shumë rritet në 3 euro për ton, apo në 5% të vlerës së valorizuar të nevojshme për prodhimin e një megavati të energjisë elektrike e cila vlerësohet në 60 euro, ndonëse sot përfitimin e një megavati shpenzohet deri në 80 euro.

Nga “Ferronikeli” ka pasur kërkesa për ulje apo për kthimin e rentës së nikelit, e cila ishte 1.5%, kur është privatizuar, ndërsa sot propozohet 4.5%. Arsyetimi ishte se në Maqedoni është 1.5, e në Greqi 1%. Por, arsyetimi nga KPMM-ja ishte se 1.5 në materien e terur është e njëjtë si 4.5, që është tash e propozuar për xehen jo të terur.

Prandaj, nuk do të jetë në dëm për blerësin. Por, nuk ishin vetëm këta që kërkuan ulje të rentave, pasi edhe nga “Trepça” dhe “Shar-Cemi” e kërkuan të njëjtën. Shoqata “Zhavorri” kërkoi uljen e rentën për kompani, të cilat duhen ta rirregullojnë ambientin e dëmtuar.

Nga “Ferronikeli” e kuptuam se në kohën e privatizimit ishin edhe dy xeherore në përdorim, si ajo e Çikatovës dhe e Gllavicës, ku prodhoheshin 60.000 tonë për muaj, me mbi 60 të punësuar, të cilët sot nuk janë aty.

Sot, për shkak të mungesës së rentabilitetit, u tha se 70-75% të xehes importohet dhe nxirren **vetëm 20 mijë tonë** për muaj.

Një e dhënë, jo e këndshme, ishte kur dëgjuam se “Ferronikeli” nuk e përdor linjtin e Kosovës, që nga tetori i vitit 2011, për shkak të pengesave të shumta. Dhe kërkesa e tyre prej 10.000 tonëve për muaj nuk mund të plotësohet nga KEK-u dhe ndërmarrja “Kosova-Thëngjilli”, për shkak të problemeve të inkasimit ndërmjet KEK-ut dhe “Kosova-Thëngjilli”.

Është totalisht absurd arsyetimi që Kosova, e cila fle mbi thëngjill dhe në oborrin e vetin e ka një mal me thëngjill, nuk mund të shesë thëngjill, sepse dy kompani të pazonja, të paafta për punë, për ç’gjë janë krijuar, nuk janë në gjendje ta shesin thëngjillin nga KEK-u në “Ferronikel”. Dhe, “Ferronikeli” është i detyruar të importojë thëngjill në Kosovë!

Kjo e tregon edhe njëherë paaftësinë kolosale të menaxhimit të ndërmarrjes më të madhe të Kosovës, e cila është shndërruar në bunar, në pus pa fund për Buxhetin e Kosovës.

Grupi Parlamentar i LDK-së kërkon një qasje shumë serioze në udhëheqjen e ndërmarrjeve, evitim të problemeve të evidentuara. Dhe, sa i përket raportit, ne e përkrahim, por duke e përcjellë me shumë kujdes efektin e rentave të reja në punën e ndërmarrjeve. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, kryetari i grupit, deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Falemnderit, kryetar!

Lista e rentave minerare, e cila na është dorëzuar, prapë lëngon nga kjo, si të them, përmbysje shumë e dëmshme në rendin e gjërave, që duhet të ndodhin në një sektor të caktuar.

E përmenda edhe gjatë raportit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, e edhe tash. Ne po marrim vendime për sektorin minerar, për të cilin të gjithë pajtohemi se është sektori më i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik të vendit, pa e pasur një strategji dhe pa e pasur një vizion të qartë, një plan të qartë shtetëror për atë se ku duam të shkojmë me këtë sektor, kah duam të avancojmë me këtë sektor dhe çfarë të mirash presim ne si shoqëri nga ky sektor? Për shkak se vetë fakti se i kemi resurset minerare, kjo nuk do të thotë që ne do të përfitojmë nga to. Pra, varet prej politikave që i aplikojmë në këtë sektor, se a do të përfitojmë ne si shoqëri dhe si shtet, apo do të jemi pre e eksploatimit të resurseve tona, për përfitim të tjerëve.

Janë disa strategji, natyrisht, dhe mënyra të përlllogaritjes së taniemave apo rentës minerare, të cilat mund të aplikohen dhe të cilat, secila prej tyre e ka efektin dhe qëllimin e ndryshëm.

Pra, në disa raste ka taniemë zero, e cila aplikohet në zero, qoftë përqindje, qoftë vlerë të fiksuar, e kjo bëhet në ata sektorë të shfrytëzimit të minierave apo mineraleve të

ndryshme, ku shteti ka për qëllim të zhvillohet. Pra, kur shteti ka për qëllim të ketë edhe investime të reja, edhe teknologji të reja, në mënyrë që të zhvillohet një sektor i caktuar.

Ose, është strategjia e dytë, e cila përdoret për çështje tjera dhe e cila e fikson rentën minerare, apo tantienën me sasinë e mineralit të nxjerrë. Kjo mund të përdoret shumë thjesht, për shembull, në rastin tonë konkret, në Kosovë, po që se është në synim të Qeverisë, të zvogëlohet numri i gurëthyesve që operojnë në territorin e Kosovës, duke vendosur natyrisht një tantienë më të lartë për ato, në mënyrë që të dekurajohen që të funksionojnë në këtë sektor.

Strategjia e tretë, e cila përdoret goxha shumë, veçanërisht kohëve të fundit, është përqindja e të hyrave, që realizohet në treg e një minerali të caktuar, i cili eksploatohet nga një vend. Dhe, me këtë strategji, e cila mbështetet, ose metodë, në vlerën neto, që kthehet nga shkriticja, mund të arrihen edhe përfitime të mira për buxhetin e vendit, pra për të mirën e përgjithshme, por edhe të kontrollohet dhe të racionalizohet në njëfarë mënyre eksploatimi apo shfrytëzimi i resurseve minerale.

Dhe, strategjia e katërt, ndoshta ajo më e avancuara, është ajo që si bazë kalkulative e merr profitin e kompanisë minerare, pra profitin neto të kompanisë minerare, dhe kjo është e aplikueshme, se mund të aplikohet në ato raste, kur Qeveria, përkatësisht institucionet shtetërore bëjnë marrëveshje minerare për shfrytëzim dhe zhvillim të ndonjë aktiviteti minerar, i cili është në interes për shtetin, por edhe për aksionarët tjerë, po që se bëhet edhe nëpërmjet kapitalit privat.

Siç mund të vërehet nga lista, e cila na është dorëzuar, as ministria e as komisioni në këtë drejtim nuk duket se e kanë kapacitetin profesional dhe shkencor që të merren seriozisht dhe në mënyrë të përgjithshme me këtë çështje, ngase pothuajse të gjithë anëtarët e Bordit të KPMM-së dhe të zyrave ministrore janë përzgjedhur me preferenca politike, natyrisht, e jo siç shkruan në Ligjin për miniera dhe minerale dhe siç do të duhej në bazë të kompetencave profesionale.

Pra, nga e gjithë kjo del se më e arsyeshme do të ishte ndoshta që KPMM-ja dhe ministria ta angazhojnë ndonjë institucion shkencor, ta zëmë Universitetin e Prishtinës, që do ta shtronte një koncept profesional dhe të realizueshëm të tantiemave në Kosovë, i cili do të duhej të ishte natyrisht në përputhje me strategjinë minerare të Kosovës, e pastaj të vijmë në përfundim se çfarë tantiemash, çfarë përqindje, çfarë strategjie për sektorë të ndryshëm do të përdorim në resurset minerare.

Lista për rentat minerare, e cila na është dhënë në këtë formë, e sidomos për metale me ngjyra dhe xehe komplekse të tyre, faktikisht nuk paraqet asgjë. Mund të interpretohet në disa mënyra, sepse mungon shpjegimi i mënyrës së llogaritjes së rentës minerare dhe praktikisht është e paaplikueshme. Për shembull: për “Trepçën” janë dhënë rentat minerare për metalet e plumbit, zinkut, argjendit, arit, kadmiumit, bizmutit, dhe për xehe të plumbit dhe të zinkut. Nëse llogaritet përbërja e metaleve në xehe dhe çmimi në bursë, renta minerare është 23 euro për ton xeheje, ose 25% e vlerës së xehes, gjë që është absurd.

Xehja e plumbit dhe zinkut nuk ka çmim në bursën e metaleve dhe nuk është dhënë formula e përlllogaritjes së rentës minerare, pra shkalla e shfrytëzimit, shpenzimet metalurgjike, penalizimet, nëse aplikohen, mënyra e formimit të çmimit, e kështu me radhë. Edhe për metalet tjera vlerësimet janë përafërsisht të njëjta.

Ky propozim, lista për renta minerare është në kundërshtim edhe me Ligjin për minierat dhe mineralet, sepse me nenin 50 të këtij ligji, në paragrafin 1, shkruan që propozim-lista në fjalë, lista e rentave minerare, do t'i përcaktojë në hollësi formulat që duhen shfrytëzuar për llogaritjen e shumës së rentave minerare, ndërkohë që në listën në të cilën është dorëzuar nuk është e përcaktuar kjo formulë në hollësi, por vetëm jepen rentat minerare, si përqindje apo shumë fikse, që do t'u aplikohen, faktikisht, mineraleve të ndryshme.

Prandaj, Lëvizja “Vetëvendosje” e ka të pamundur ta votojë një listë të këtillë, për shkak të të gjitha këtyre arsyeve që i përmenda. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të AAK-së, deputeti Xhevdet Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Falemnderit, i nderuar zoti kryetar,

Unë nuk do të shtoj më shumë se sa anëtarët e Komisionit të Zhvillimit Ekonomik, të cilët i elaboruan disa probleme, por në të vërtetë është shqetësuese edhe për grupin e Aleancës dhe të gjithë deputetët, që të importojmë thëngjill në vend se të eksportojmë, ndërsa dihet që Kosova është më e pasura me linjit në Evropën Juglindore.

Mirëpo, këto rekomandime nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik besoj se duhet të gjejnë zbatim dhe Qeveria duhet të jetë e gatshme, dhe shumë shpejt, ta implementojë, jo vetëm strategjinë për miniera dhe minerale, por edhe strategjinë e zhvillimit ekonomik dhe shumë strategji të tjera, me qëllim të rritjes së buxhetit dhe të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Falemnderit!

Koalicioni për Kosovën e Re e ka shqyrtuar rekomandimin e Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe vendimin e Qeverisë për listat për renta minerare, që direkt bazohet në Ligjin për miniera dhe minerale dhe e shohim shumë të udhës, meqë e kemi diskutuar edhe në Komision Parlamentar, ngase u fol edhe nga parafolësit se është çështja e importit të thëngjillit.

Mirëpo, mbetet esencë e vetë korporatës që ligji të zbatohet në këtë rast dhe të mos e marrim mallin e dikujt tjetër, ndërsa mallin tonë ta lëmë të flejë. Këtu, në listën minerare është, unë prapëseprapë do ta bëj me dije edhe për opinionin edhe për deputetët, lista minerare, grupi i lëndës minerare përfshin mineraret energjetike dhe duke marrë parasysh se Kosova po e përgatit projektin për ndërtimin e termocentralit “Kosova e Re”, çështja e një tonelate, çështja e tonelatës për thëngjill, nga operatori i ri energjetik do t'i kushtojë

Kosovës apo qytetarit të saj do t'i kushtojë një kilovat energji elektrike shumë më shtrenjtë që të mund ta përballojnë qytetarët e Kosovës. Dhe, prapë shpreh shqetësimin tim se prapë do të kemi subvencione për KEK-un, pavarësisht se kush do të jetë operatori i ri, i cili do ta ndërtojë termocentralin "Kosova e Re" dhe kush do të jetë operatori i ri i privatizimit të Distribucionit dhe Furnizimit.

Edhe një herë, Koalicioni për Kosovë të Re i jep përkrahje listës së rentave minerare, duke i favorizuar prodhuesit, të cilët e marrin lëndën e parë nga Kosova, mirëpo me një kusht, që në ndërtimin e Termocentralit "Kosova e Re" vetë Qeveria është aksionare, që të caktojë ta operatori i ri ekonomik çështjen e prodhimit të energjisë për qytetarët e Kosovës çfarë çmimi do të ketë. Ndërsa, në rast se operatori i ri ekonomik del në eksport të energjisë elektrike me çmime tjera, atëherë do të ndodhë një diskriminim total për qytetarët e Kosovës. Ju falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të SLS-së? Nuk ka të paraqitur. Në emër të Grupit Parlamentar "6+", deputetja Duda Balje e ka fjalën.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Podržaćemo predlog vlade Kosova za rentu za minerale, uz molbu da se obrati pažnja vezano za cenu feronikla. Feronikal, predložen od strane vlade sa cenom od 3 eura, treba obratiti pažnju, jer nas očekuje privatizacija proizvodnje energije, a sa ovako skupim inputima i output, odnosno energija će biti skuplja.

A nismo naravno ni za dosadašnju cenu od 0,27 centi, jer smatramo da je to jeftino rasipanje sopstvenog bogatstva. Pa bi možda neko srednje rešenje bilo krajnje potrebno. Hvala vam!

KRYETARI: Falemnderit deputete! Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Falemnderit, kryetar!

Kjo është një temë e huaj, e panjohur për mua dhe nuk dua as të bëhem oponencë e Qeverisë, sepse nuk mund t'i vlerësoj çmimet që i ka vendosur aty, por dua t'ia bëj një preferencë. Dua t'ia bëj një preferencë nga vërejtjet që i dëgjova. Nuk mund të jem indiferent nga ato që dëgjuam nga zonja Sahatqija dhe në rast se vërtetë Qeveria gjen diçka të vërtetë aty, kisha thënë që menaxhmentin e ndërmarrjes përkatëse, që është kompetente për t'u marrë me atë problematikë, që e shtroi zonja Sahatqija, ta shikojë dhe të merret me menaxhmentin e asaj ndërmarrjeje, sepse është çështje vërtet provokuese dhe sfiduese.

Dhe, ne, edhe nëse krenohemi për diçka, krenohemi sigurisht për atë pasuri. Dhe, tash kur na del një fakt se kjo xehe vjen nga jashtë, vërtet s'mund të jesh indiferent. Dhe, besoj që edhe Qeveria nuk do të jetë indiferente dhe do të merret me menaxhimin dhe menaxhmentin e ndërmarrjes përkatëse, që është kompetente për atë fushë, për këtë xehe. Falemnderit!

KRYETARI: Replikë, deputetja Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Mendoj që nuk quhet replikë, por po më vjen mirë që kjo çështje u hap.

Në fillim të diskutimit tim, e thashë që kemi qenë në debat në një dëgjim publik, ku kanë qenë pjesëmarrës edhe përfaqësues të KEK-ut, edhe të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe arsyetimi i tyre, një arsyetim teknik, i cili thotë se “Kosova-Thëngjilli” nuk i ka paguar KEK-ut, prandaj KEK-u nuk e lejon të nxjerrë thëngjill, e tjera, janë arsye time banale, të cilat tregojnë një paaftësi të menaxhimit, se po të kishte qenë ndërmarrje private e ta ketë aty një mal thëngjill, e të mos mund ta shesë, ai do të kishte falimentuar.

Po më vjen mirë që është hapur kjo çështje dhe shpresoj që të gjendet zgjidhja dhe që të mos blejmë thëngjill për ta importuar në Kosovë.

KRYETARI: Zenun, po ta jap fjalën, por deputetët diskutojnë një herë për një çështje. Mos ta shkeli Rregulloren, sepse pastaj marr vërejtje.

(Ndërhyrje)

Urdhëro! Për replikë, është paraqitur deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Kryetar! Si kryetar i Komisionit dëshiroj ta bëj një sqarim.

Ajo që po bëjmë ne sot, e kemi para vetes një listë që është renta që e propozon Qeveria dhe ka edhe shumë çështje tjera që ne mund t’i diskutojmë, sikur që është funksionimi i kësaj ndërmarrjeje që ka kompetenca për shitjen e thëngjillit dhe mendoj se ne e kemi shtruar në komision këtë çështje të veçantë. Bile unë, personalisht, kam kërkuar edhe nga ministri që me urgjencë ta trajtojë, sepse ka qenë edhe kërkesë e kompanive, të cilën e kemi pasur në dëgjim. Qeveria është zotuar se do ta trajtojë edhe me institucionet tjera përkatëse sa më shpejt, ndërsa kjo që po e bëjmë sot është renta dhe unë ju ftoj që ne, për ta rregulluar ose për ta vënë në baza ligjore këtë problematikë, duhet mbështetur dhe legjitimuar këtë listë.

Ndërsa, çështjet tjera mbeten në institucionet e Ekzekutivit t’i realizojë. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Të lajmëruar për diskutim nuk kemi. Të pranishëm i kemi 67 deputetë. Lus deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Me 40 vota për, 7 kundër dhe 8 abstenime, Kuvendi e miratoi propozimin e Qeverisë së Kosovës lidhur me listën për rentat minerare.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

- Shqyrtimi i propozimit të Institutit Gjyqësor të Kosovës për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

Komisioni për Legjislacion, në pajtim me nenin 3 të Ligjit për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe të dispozitave të Rregullores së Punës, e ka shqyrtuar propozimin e institucioneve përkatëse për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe ia ka rekomanduar Kuvendit për miratim.

Propozimet e institucioneve përkatëse, së bashku me dokumentacionin dhe rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL, u janë shpërndarë deputetëve.

Fjalën e ka nënkryetari i Komisionit FunkSIONAL, deputeti Arben Gashi, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

ARBEN GASHI: Falemnderit, kryetar!

Komisioni e ka shqyrtuar këtë çështje dhe ka konkluduar se procedura është respektuar dhe personat që janë propozuar si anëtarë të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor i plotësojnë kriteret ligjore dhe i rekomandon seancës ta trajtojë. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Falemnderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i jep përkrahje rekomandimit të Komisionit të Ligjeve dhe i propozon seancës plenare që ta votojë listën e propozuar.

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Po ashtu, edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah këtë listë, e cila është konform Ligjit për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës. Prandaj, ne e përkrahim dhe do të votojmë për. Ju falemnderit!

KRYETARI: Në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, fjalën e ka kryetari i Grupit, Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Falemnderit, kryetar.

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do ta përkrahë këtë listë për Institutin Gjyqësor. Falemnderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Suzan Novobërdaliu e ka fjalën.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Falemnderit, kryetar!

Edhe Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah këtë listë të propozuar.

KRYETARI: Falemnderit! Aleanca, a do të flisni, se ju kapërceva? Fjalën e ka deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: E përkrahim, pasi na kapërceve!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Në emër të “6+”, fjalën e ka deputetja Duda Balje.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

I Parlamentarna Grupa “6+” podržava predlog Sudskog Instituta Kosova o imenovanju članova Upravnog Odbora Sudskog Instituta Kosova. Hvala!

KRYETARI: Të paraqitur tjerë nuk kemi, prandaj votojmë.

Të pranishëm janë 62 deputetë.

Lus deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

Me 57 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi listën për anëtarët e Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës me mandat dyvjeçar, si në vijim:

- Fejzullah Hasani, Gjykata Supreme e Kosovës;
- Nebojsa Boriçiq, Gjykata Supreme e Kosovës;
- Laura Pula, prokurore publike e Kosovës;
- Osman Ismaili, Fakulteti Juridik;
- Rexhep Murati, Shoqata e Juristëve të Kosovës;
- Idain Smajli, Shoqata e Prokurorëve të Kosovës;
- Ramë Gashi, Oda e Avokatëve të Kosovës, dhe
- Ymer Hoxha, Shoqata e Gjyqtarëve të Kosovës.

Vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës

Komisioni për zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka mbikëqyrur zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe ia ka paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime.

E ftoj kryetarin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputetin Zenun Pajaziti, që ta arsyetojë raportin, me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: Falemnderit kryetar!

Të nderuar deputetë,

Zoti ministër,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në vazhden e aktiviteteve, edhe për monitorimin e zbatimit të ligjit, e ka përfunduar procesin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Dëshiroj të theksoj se ky institucion, kjo agjenci është relativisht e re dhe ende ka probleme në konsolidim, duke filluar prej atyre teknike, mungesës së hapësirës së mjaftueshme të anëtarëve, tash të Bordit, e tjerë.

Dëshiroj fillimisht, po ashtu, t'i falënderoj anëtarët e komisionit, të cilët kanë qenë në grup punues, në krye me zotin Lutfi Zharku, i cili sot nuk është këtu. Ky grup e ka bërë një punë jashtëzakonisht të mirë, i ka kontaktuar, përveç këtij komisioni, të gjitha institucionet tjera të ndryshme, që janë relevante për të marrë informacione në përputhje me atë nëse është nxjerrja e informatave në përputhje me atë se sa është zbatuar ky ligj dhe ka arritur t'i nxjerrë disa rekomandime, të cilat unë sot po i lexoj.

1. Qeveria të përfshijë në plotësim-ndryshimin e strategjisë legislative për vitin 2012 ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës;
2. Qeveria, Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë t'i nxjerrë aktet nënligjore në afatin prej 3 muajsh nga miratimi i këtyre rekomandimeve;
3. Autoriteti i konkurrencës së Kosovës, në kuadër të kompetencave të tij, t'i nxjerrë aktet nënligjore në fushën e rregullimi të konkurrencës në afat prej 3 muajsh nga miratimi i këtyre rekomandimeve;
4. Autoriteti i konkurrencës i Kosovës, në përputhje me Statutin e miratuar nga Kuvendi, t'i nxjerrë aktet nënligjore për rregullimin e brendshëm të tij në afat prej 3 muajsh nga miratimi i këtyre rekomandimeve, dhe
5. Autoriteti i konkurrencës i Kosovës të përkrahet me veprime konkrete nga Kuvendi i Kosovës në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe administrative.

Pra, këto janë rekomandimet që i ka nxjerrë grupi punues, i ka mbështetur në tërësi komisioni dhe i kemi sjellë këtu me kërkesë për t'u miratuar.

Dëshiroj, zoti kryetar, ta shfrytëzoj rastin edhe në emër të Grupi Parlamentar të Partisë Demokratike t'i mbështes këto rekomandime të komisionit. Ju falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Falemnderit, kryetar!

Në kuadër të kompetencave të veta, komisioni e ka bërë mbikëqyrjen e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, duke bërë vizita, takime dhe dëgjim publik.

Në kuadër të punës së komisionit, e kemi ftuar edhe ministren e Tregtisë dhe Industrisë për raportim, për sfidat e Raportit të Progresit dhe të Ligjit për konkurrencës, por ishte shumë interesante përgjigjja e saj se Autoriteti i konkurrencës nuk është pjesë e kompetencave të MTI-së dhe se MTI-ja ka shërbyer vetëm si mbështetëse e saj për raportim në Kuvend, gjë që nuk qëndron me ministritë dhe me agjencitë tjera.

Por, këtu dëshiroj ta bëj një digresion. Mendoj se emri i ministres po përmendet dy herë gjatë kësaj seance. Mendoj se dje, kur u përmend gjinia, kjo nuk ishte në rregull, nuk do të duhej që aftësitë apo paaftësitë të ndërliken me gjininë, por të ndërliken me punën.

Prandaj, unë këtu nuk po flas si gjini, por po flas për punën e Ministrisë dhe mendoj se ajo do të duhej të ishte edhe rregull.

MTI-ja dhe Qeveria nuk e kanë nxjerrë asnjë akt nënligjor në afat të caktuar me ligj lidhur me autoritetin e konkurrencës, gjë e cila ka shkaktuar mungesë të efikasitetit të këtij autoriteti.

Statuti i AKK-së ka ardhur në Kuvend me një vonesë të konsiderueshme. AKK-ja është themeluar më 2012, ende nuk ka staf të kompletuar, ndonëse së voni kanë marrë personel. Personeli nuk është i specializuar për lëmin që e mbulon.

Neni 5, 6, 11 dhe 14 i këtij ligji kanë mungesa përkufizimesh dhe nuk janë të definuar qartë, sidomos për definimin e pozitës dominuese në treg.

Neni 16.3 është në konflikt me ligjin për shoqëritë tregtare, meqë nuk definohet koncerni dhe nuk njihet koncepti i bashkimit të pjesëve të ndërmarrjeve si subjekte të veçanta.

Ka edhe nene tjera, të cilat për shkak të paqartësisë ndikojnë në mosefikasitetin e këtij autoriteti dhe në këtë mënyrë në dëm të shtetit dhe të qytetarit të Kosovës.

Grupi punues ka dalë me rekomandime, të cilat i përmendi edhe kryetari i komisionit dhe Grupi Parlamentar i LDK-së i përkrah këto rekomandime për përmirësimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe të performansës së kësaj agjencie. Ju falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit deputete! Në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, kryetari i Grupit, Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Falemnderit kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” i përkrah këto rekomandime. Edhe gjatë monitorimit është vërejtur se janë dy probleme thelbësore që i ka kjo agjenci, pra disa mundësi të mëdha të keqkuptimit të ligjit, pra të mosdefinimit të qartë të disa çështjeve në ligj, që ngërthehen në rekomandimin 1 të komisionit, pra që ta plotësojë dhe ndryshojë Ligjin për konkurrencën dhe çështjet tjera janë raporti i Agjencisë për Mbrojtjen e Konkurrencës me institucionet tjera të Kosovës. Pra, është vërejtur që jo gjithëherë institucionet tjera janë të gatshme ta përkrahin dhe ndihmojnë aq sa duhet këtë agjenci, ndërkohë që për rëndësinë e kësaj strukture mendoj se është e tepërt të flitet dhe të gjithë pajtohem që duhet ta kemi një agjenci më të fortë për ta mbrojtur konkurrencën në treg.

Kështu, këto rekomandime, konsiderojmë ne, por edhe si komision kemi konsideruar, janë të mjaftueshme për ta përmirësuar sadopak gjendjen dhe rrethanat në të cilat funksionon kjo agjenci. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Grupit të Aleancës, fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Falemnderit, i nderuari zoti kryetar!

Edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës i përkrah rekomandimet që i ka dhënë grupi punues i Komisionit për Zhvillimin Ekonomik dhe mund të them se kjo agjenci, e formuar në vitin 2008, ende nuk është funksionale dhe ende nuk është e specializuar për punët që duhet t'i kryejë. Dhe, e kishte një thënie shumë të mirë edhe vetë agjencia, se nuk po e kuptojnë vetë fjalën konkurrencë, prandaj nuk e di si do t'ua shpjegojnë tjerëve. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja e Grupit Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Falemnderit!

Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar raportin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe, duke marrë parasysh se edhe zonja Sahatqija e theksoi çështjen e raportimit të ministres së Tregtisë dhe Industrisë brenda Komisionit Parlamentar, të gjitha rekomandimeve që janë bërë nga Komisioni Parlamentar duhet t'u jepet një sqarim, ndoshta edhe nga vetë Ekzekutivi, se kush është ai i cili duhet ta hartojë një Ligj për mbrojtjen e konkurrencës dhe në këtë ligj të plotësuar dhe të ndryshuar të jepet kompetenca apo të sqarohet më mirë çështja e Komisionit Kosovar të Konkurrencës, jo vetëm me fjalë, por duke i ndihmuar për arsye se edhe në Kushtetutë shkruan se Kosova është për ekonomi të lirë të tregut.

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re i përkrah rekomandimet e Komisionit Parlamentar dhe e përshëndet punën e deputetëve për miratimin e këtyre rekomandimeve. Ju falemnderit!

KRYETARI: Në emër të SLS-së? Nuk ka. Në emër të "6+"? Nuk ka. Pasi nuk ka të paraqitur tjerë për diskutim, votojmë.

Të pranishëm janë 62 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Me 60 vota për, asnjë kundër dhe 1 abstenim, Kuvendi e miratoi Raportin me rekomandime të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Mirupafshim në mbledhjen e radhës!

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë e Kuvendit të Kosovës